

85H-32

M 27

GAQO MANI

DY
MËSUESET

TREGIME

8SH-32
M 27

GAQO MANI

5

D Y MESUESET

T regime

~~45668~~ 1994

LIOTEKA E SHTETËS
DURRASIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DY MËSUESET

Dielli dukej si një disk i zjarrtë dhe po kapërxente malin e po zhdukej pas tij. Rrezet e fundit të kuqërremta e të vakta herë humbnin nëpër degët e pemëve, herë dilnin. Drita e fundit po ja linte vandin qetësisë, e cila dukej sikur zbriste nga prozhmet, përzjehej me frushullimën e degëve e të petaleve e derdhej butë, në dhomën e Vjollcës.

Nga fusha vinte zhurma e një motori dhe një re pluhuri të verdhë ngrihej mengalalë. Atje punonte maqina shirëse, atje ishte Alekoja, i shoqi dhe fëmijët, nxënësit e saj, çamarokët e fshatit.

Atë ditë Vjollca s'kish dalë në fushë, siç e kish bërë zakon ato dy javët e fundit, mbasi kishin ardhur ustallarët për të meremetuar shkollën dhe s'kish si t'i linte vetëm. Arësimtarët e tjerë qenë nisur me pushime nëpër vendet e tyre. Vetëm Vjollca kish mbetur në fshat. Ajo qe sistemuar me kohë atje.

Duke pasur mendjen te fusha e te fëmijët, iu kujtua ajo letra e fundit që kish marrë nga Drita, një shoqja e saj, mësuese në një fshat tjetër. Ajo letër i kish lënë mbresë, kishte shumë fraza të errëta, të linte një tok dyshime dhe nuk kuptohej se çfarë donte të thoshtë. Me të vërtetë Vjollcës nuk i vinte mirë që shoqja e saj të kish rënë aq poshtë moralisht. Ajo e njihte mirë Dritën, ja dinte karakterin dhe tekat, por nuk besonte kurrë që Drita të arrinte deri sa ta quante marrëzi sistemin e saj në fshat.

Vjollca, duke bluar gjith këto mendime në kokë, u largua nga dritarja, ku kish një copë herë që po rrinte, kur dikush trokiti në portë.

— Urdhëroni — thirri.

— Këtu banon mësuesja? — u dëgjua një zë.

Vjollca shtangu. Ai zë që kish ardhur nga hajati iu duk shumë i njohur dhe rendi e gëzuar. Qe Drita. Shoqet iu hodhën në qafë njëra-tjetrës dhe u puthën me mall.

— Pse s'më lajmërove, Dritë?

— Më mirë papritur.

— Sa mirë bëre, oi sa do të gëzohet Alekoja! Edhe mbrëmë të kishim në gojë, edhe tani para një minute ty të kisha në mendje.

— Më kish marrë malli shumë, Vjollcë... Erdha që këto pushime t'i gëzojmë e t'i shfrytëzoj vetëm përvete, pa menduar aspak për punë dhe aq më pak përfshatin.

— Kaq shumë je lodhur? — pyeti Vjollca me dyshim.

— Më shumë jam mërzitur, s'kam as shoqe as shok që të më ecë muhabeti. Nuk e di po s'kuptohem me asnji!

— C'po flet kështu, Dritë!... Më parë ti më shkruaje ndryshe. Në mos gaboj, më shkruaje për atë mësuesin e matematikës, Janin, që të pëlqente aq shumë.

— Të shkruara e të harruara Edhe ai si Drini. Këta mësonjësit e matematikës qenkan të gjithë njësoj, na marrin për ekuacione e duan të na zgjidhin deri në fund! Sa qesharake!

— Këtë të fundit nuk e njoh, sa për Drinin ka genë djalë i mirë, të donte me gjithë mend.

— S'ka rëndësi pérderisa unë s'pata menduar kurrë për të. Burrat paskan huqe të çuditshme, bie fjala si Jani që unë s'e duroj dot! A e di ç'më thosh kur binim në bisedë: «Veshja s'lot ndonjë rol në persona-

litetin e njeriut. Ajo duhet t'i përshtatet ambientit, të jetë e thjeshtë. Kërkesat e njeriut po ashtu, s'duhet të kapërxejnë cakun, pra edhe ato duhet t'i përshtaten kushteve. Mësuesi duhet të shkrihet me masén, se ashtu do të na kuptojnë më mirë nxënësit» e sa e sa të tjera të këtij lloji.

Ja, pra, na del një masovik e na tregon rrrethanat e caqet, pa llogaritur se mua s'më duhen aspak, e pa gjykuar fare se një përshtatje e tillë do të thotë privim i dëshirave dhe ndjenjave. Po a mund të kthehesh ti në një fshatare pas asaj kulture që ke marrë? A mund të vishesh e të mendosh si një që s'di ç'do me thënë qytetërim, pikërisht atëhere kur je në lule të rinisë e kur në shpirt të vlojnë një mijë dëshira dhe ëndrra të bukura? Nuk e di në flas qartë.

— Ti flet shumë qartë, po ndofta unë s'të kuptoj. Mbështetje edhe unë jam kthyer në një fshatarë kokëtrashë — ja ktheu Vjollca me shpoti.

Drita e pa në sy me dyshim dhe shtrembëroi buzët. Të dyja heshtën dhe hetuan njëra-tjetrën, sikur në fytyrë apo në sy të kishin të shkruara mendimet apo ndjenjat.

— Leri ato tanë, po tregomë si shkon me këtë jetën e re. Jam kureshtare të di çdo gjë e sa më shumë. Je e kënaqur?

— Si të duket ty? — ja ktheu Vjollca duke e shikuar thellë në sy.

— Ku di unë si të them... Ky veprim yti më habit! —

— Pse, çfarë ka për t'u habitur këtu?

Tjetra sheshoi flokët e shtoi:

— Të paktën për mua këto vendimet e tua qenë sa të papritura aq edhe të jashtëzakonshme;

— Edhe në letër kështu shkruaje.

— S'desha t'i shkruaja se e dija që do të më zemëroheshe.

— Kush të tha se jam zemëruar?

— Mendoj unë, sidoqoftë s'duhej t'i shkruaja. Çdo

gjë që mendohet nuk hidhet në letër. Po Alekoja e lexoi letrën?

— Ja lexova unë!

— S'bëre mirë. Kushedi si do të mendojë për mua.

— Mos u bëj merak. Ai qeshi me zë e më tha të tē shkruaja një letër të gjatë me shpjegime, por tani erdhe vetë... Ti po e shikon sa mirë jemi sistemuar këtu: shtëpinë e kemi të re, me mobilje të reja, kemi dritë elektrike, sobë kuzhine; këtë muaj do të blejmë radio. Alekoja është shumë merakli, do t'i ketë të gjitha që shtëpia jonë të mos dallohet fare nga ato të qytetit.

— Megjithatë jashtë mureve është fshat e do të mbetet gjithmonë fshat.

— E shikoj — qeshi Vjollca — fshati të qenka neveritur, ndërsa unë kam shtënë dashuri me këtë luginë, e dua dhe s'mendoj të shkëputem që këtej.

— Mendimet e njerëzve ndërrojnë si muajt e vittit, prandaj mos u zoto.

— Por jo të të gjithë njerëzve.

— Jam e bindur, do të vijë një ditë që të të pushtojë mërzia. E parandjej se ajo do të jetë një ditë dimri, kur ti s'do të guxosh të nxjerrësh kokën jashtë.

— Gabohesh.

— ...?

— E kam provuar edhe dimrin. Oh, ti s'e di se ç'pamje të mrekullueshme merr kjo luginë në dimër, fantastike mund të them, aq, sa e ndjej veten të frymëzuar për t'iu thurur vargje heroizmave të këtyre njerëzve të fshatit të ri. Shiko, Dritë, — ndeu dorën në dritare. — Vetëm gjashtëmbëdhjetë muaj punë është bërë këtu. C'do të bëhet pas pesë vjetësh? A mund ta imagjinosh? Ja, unë përfytyroj një qendër të madhe bujqësore e ndofta edhe ndonjë fabrikë për të përpunuar frutat e bulmetin. Kështu kanë lindur qytetet, Drita, kështu përtërihetjeta.

— Pra ti qenke e kënaqur?

— Jam e lumtur!

— Je akoma në «muajin e mjaltit»...
— Kështu do të jem gjithmonë. Njësoj si unë mendon edhe Alekoja.
— Ai propozoi i pari?
— Unë. Ai qe i gatshëm!
— Ndofta nga dashuria që ka për ty.
— Jo vëtëm për mua, por edhe për të renë. Ai do të vinte edhe pa mua.
— Nuk e di si e pritën prindët e tu këtë vendim.
— E pëlqyen dhe më lavdëruan!
— Po ata të Alekos?
— Oh, ai s'ka prindër — shtoi me zë të paktë Vjollca.

— S'ka?!

— Është rritur në shtëpinë e fëmijës!

Bëfas biseda u pre. As Vjollca s'kish qejf të fliste për Alekon, as Drita s'deshi të dëgjonte për jetën e atij jetimi, që s'i kish njohur përkëdheljet prindore.

Por Alekoja kishte dashuri të madhe për njerëzit, megjithëse s'kish njerëz. Ai që s'kish pasur nënë e baba, tani qe bërë pjesëtar i një familjeje të madhe ndërtonjësisht, në atë skaj malor, ku vëtëm para gjashtëmbëdhjetë muajve s'të zinte syri veç murriza e dëllinja, e ku tani, si për çudi, kish hedhur shtat, si një filiz, fshati i ri e i padëgjuar. Ai tani kish grua, nënë, baba, motra e vëllezër. Atij i zienin në kokë mendime të larmishme për jetën e re, i ngjalleshin dëshira, i përtëriheshin forcat.

Alekoja e frymëzonte Vjollcën dhe i ushqente në shpirt ndjenjat më të bukura sa herë që i fliste për tokat e reja e për traktorin e tij. Edhe Vjollca e gjëzonte atë kur i fliste për përparimin e nxënësve. S'ish fjala, vëtëm për fëmijët, por edhe për të rriturit, që s'kishin menduar kurrë të uleshin në bankat e shkolles e të lexonin me drithë elektrike, duke iu bindur një vajze fare të re, siç qe Vjollca.

* * *

Ja, aty mbi komodinë është fotografia e Alekos. Drita nuk e njeh atë, s'e ka parë kurrë, por si fytyrë i pëlqen. Ata sytë e ndritshëm e të gjallë, vetullat kaleshe, hunda e derdhur si qiri dhe ajo mjekra e gjërë e tregojnë një burrë të shtruar e me vullnet të fortë.

Pas një pshërëtime të thellë, pëshpëriti:

— Jetim dhe shofer!

— Dhe është aq i mirë, dhe e dua aq shumë sa nuk kisha menduar kurrë që të duhej burri kështu.

— Më vjen qudi me ty, Vjollcë. Unë s'vendos dot, lëkundem shumë, ndërroj mendje. E keqja më e madhe është se mua më hyjnë shpejt në zemër dhe po aq shpejt më dalin këta burrat.

— Po çfarë kërkon ti, ndonjë mbinjeri? S'më pëlqen fare kështu. Drini qe i mefshtë, ky është masovik...

— Me këtë nuk kuptohem, Vjollcë, ky është si njeri prej hekuri, pa ndjenja!

— Po ai të dashuronte.

— Ajo qe një dashuri e ftohtë, si akull, që më largonte vetveti deri sa mu zvordh fare. S'ke ç'bën kur s'ta ndjell zemra.

— Ndërsa unë them se ti s'e ke ndjerë gëzimin e asaj dashurie, s'e ke ushqyer, s'i je kushtuar. Kjo ka ardhur ndofta se ti e ke gjykuar jo thellë shpirtin e tij, ti s'ke pasur frymëzime as të papritura. Në raste të tillë ndikon shumë edhe vetë ambienti e rrethanat.

— Edhe ti si ai «ambienti, rrethanat».

— Kështu është. Në qoftë se e dua kaq shumë Alekon, kjo s'do të thotë se tek unë ka shtënë rrënëjë dashuria e verbër, as vetëm ai si Aleko, por edhe puna e tij, mundi i tij, idetë e tij, romantika e fshatit të ri, gjithshka që më rrethon, të gjitha këto e ushqejnë dashurinë, e frymëzojnë dhe e mbajnë gjallë.

— Je bërë romantike; sa po më pëlqen, Vjollcë!

— Tërëjeta jonë këtu ashtu është. Prandaj edhe

ti kérko rrugët që të duhen dhe përqafoji, që të përtëriresh, të të kthehet gëzimi, ndryshe do të të plaken ndjenjat.

— Ndofta ke të drejtë, por unë s'mundem të bëj atë që bëre ti, s'kam fuqi të mendoj pér asgjë, jam si një i dehur që s'e gjen dot portën e shtëpisë. Kam një turbullirë të madhe, që më errëson paprerë. S'e shpje- goj dot c'po ngjet me mua; sidoqoftë ti po më ndri- çon, po më zgjon. Dhe pse të mos të ta them, Vjollcë?...

— Çfarë?

— Kjo vepra jote qenka diçka e thellë... një marrëzi që më entuziazmon!

— Marrëzi e quan?

— Edhe pse e quaj ashtu ndofta do të doja të isha në vendin tënd. Të kam zili, të betohem. Ti je e lumtur, të besoj, e shpreh fytyra jote e shikoj në syt e tu.

— Edhe ti do të jesh e lumtur. Krijoje vetë, e ke në dorë. Pajtohu me Janin deri sa s'është vonë.

— Ç'thua ashtu, Vjollcë? Po si mundet? Është vonë, tepër vonë. Ç'kuptim do të kishte?... Unë s'dua mëshirë.

— Nuk thashë ashtu, por ti duhet të gjesh rrugën tënde.

— Ashtu siç e gjete ti, Vjollcë?!

— Pse jo, edhe ashtu. A s'është një shembull pér ty?

— Është, por nuk e di a duhet ta përqafoj një gjë të tillë; edhe dua edhe s'dua, por ti duhet të më kup- tosh, Vjollcë, me Janin ka marrë fund çdo gjë, sepse ai është një tip, që as ndryshon dhe as përkulet. Ai më do, është e vërtetë, por s'e kuptoj përsë më do. Mos kujto se të gjithë burrat janë si Alekoja yt. Ti pate fat, Vjollcë, por edhe ai pati fat të madh.

— Pse, se qe shofer dhe jetim?

— Dhe pa farefis.

— Edhe kjo është një arësy që më bën ta dua aq shumë. Dëgjo, Dritë, s'kisha menduar ndonjëherë të martohesha kaq shpejt, por, si të thuash, vijnë ca çaste

të çuditshme, ndofta këto ndodhin rrallë në jetë, por kur vijnë janë vendimtare. Dhe atëhere përse ta shtysh?

— Por unë s'mund të bindem me një të parë, Vjollcë, as me një bisedë.

— Është e drejtë, por kur të mbushet mendja, kur ke besim në vete dhe tek i zgjedhuri... Të paktën unë s'e vura kurrë në dyshim dhe as u pendova që ja dhashë fjalën. Mua atëhere më dukej se e njihja thellë atë dhe ashtu doli, ashtu siç e shpresoja.

— Kjo është një rastësi.

— Edhe ashtu mund të jetë, por ti të paktën ke një vit me të. Unë kam bindjen se ju e njihni shumë njéri-tjetrin, deri në hollësi, prandaj të insistosh më duket e kotë.

— Nuk mundem, mbase nuk di si duhet ta dua atë njeri.

— Unë e shikoj se ti s'e ke shkulur nga zemra.

— Sikur të qe ashtu, e dashur Vjollcë, do të ishte ndryshe.

— Pra ti mendon se njeriu s'duhet të nxitohet ashtu siç bëra unë, kurse unë jam e kënaqur nga vepra ime. Më mjaftoi një udhëtim me të që t'ja kuptoja mendimet e dëshirat. E di, Dritë, s'dija ç'punë bënte, s'ja dija as emrin, vetëm kisha simpati për atë njeri. Ajo më lindi që në shikimin e parë, dhe ashtu siç ndodh shpesh me njerëzit e panjohur, që të pëlqen të të dalin në rrugë, ashtu më ndodhi edhe mua. Dhe e solli rasti të udhëtoja me të. M'u duk se edhe atij i pëlqeu prania ime. Kjo ndodhi kur u nisa për në detyrë.

— Ishe vetëm, Vjollcë.

— Vetëm, arësimtarët e tjerë ishin nisur dy ditë më parë, se ashtu ndodhi një mosmarrëveshje.

— Sikur ta kishit kurdisur vetë.

— Ashtu vërtet, sidqoftë unë u nisa pa ditur se ku binte fshati. Ai ma tha që në fillim se maqina nuk arrinte deri atje dhe duhej të zbrisja në stabilimentin e sharrave. Që andej duhej të bëja njëzet minuta udhë më

këmbë deri në fshat. S'kisha ç'të bëja. U shqetësova pak për atë rrugën e panjohur, por edhe dëshiroja të sosja sa më parë që të filloja nga detyra.

Nuk e di a ke qenë e tronditur ti, Dritë, kur u nise për në detyrë, por unë kam qenë shumë. S'dija sì do ta filloja mësimin e parë, çfarë toni duhej t'i jepja zërit, a do të më kuptionin nxënësit, a do të më pëlqenin, si do ishte fshati, çfarë njerëz do të ishin fshatarët...

— Të gjithë këtë përshtypje kemi pasur, madje mua më vinte frikë nga gjithë ato të panjohura.

— Edhe unë pata frikë, Dritë, por nuk e humba kurrë besimin në vete.

Vjollca heshti, pa orën dhe doli në dritare. Ishte errur dhe fusha nuk dukej më, ndërsa zhurma e motorit vinte valë-valë si edhe më parë.

— Vonohet Alekoja? — pyeti Drita.

— Zakonisht në këtë orë kthehet, por sonte kush-edi ç'punë do t'i ketë dalë. Tani, që është koha e të shirave, punojnë papushim. E dëgjon zhurmën e motorit?... Është traktori i tij! Po ku e gjeti sonte që kemi mysafirë... Duhet t'i dërgoj fjalë me ndonjë.

— Jo, Vjollcë, mos e hiq nga puna, po eja tregomë si filloi «romani».

— Filloi më heshtje. Gati një orë s'folëm fare. Unë qeshë myllur në vetvete. Peisazhi, detyra dhe njëriu që kisha pranë, të gjitha ishin gjëra të reja për mua. Ai pinte cigare e unë, e ngjeshur në qoshe të kabinës, vështroja përparrë dhe te një copë pasqyrë, që qe vendosur në xhamin e kabinës. Në pasqyrë shihja një pjesë të ballit dhe një vetull kaleshe të shoferit. Duke vështruar atë pjesë të fytyrës, sepse dëshiroja t'ja shihja gjithë fytyrën. Më në fund ai foli:

— Është rrugë e keqe kjo, po na shkatërron maqinat.

— Kini të drejtë — i thashë.

— Po në dimër është edhe më keq të kalosh këtej.

— E marr me mend sa vështirë e kini.

— Ashtu është, ka vështirësi të mëdha ky zanati

ynë; megjithëse lodhem, shpeshherë flemë në maqinë, hamë ku mundim ose s'hamë fare tërë ditën, me një fjalë edhe pse bëjmë jetë të çrregullt e të lodhshme, s'na bën përshtypje, jemi mësuar.

— E megjithatë bëni një punë aq të dobishme.

— Mjerisht disa e quajnë të dorës së fundit dhe ka raste kur na përcmojnë edhe si njerëz.

— S'besoj.

— Po, po — ktheu kokën ai.

Atë çast ja pashë fytyrën aq pranë sa m'u bë sikur më shpoi me vështrimin e tij.

— Dua t'ju pyes — shtoi. — Çfarë përshtypje kini ju për shoferët?

E pashë veten ngushtë. S'kisha një ide të saktë dhe s'iua përgjegja në çast. E vështroja vëngër dhe s'dija ç'ti thosha. Edhe ai më vështronte dhe nga ato shikimekuuptoja shumë. Dhe pse gjuha e tij s'fliste, sytë e tij shprehnin, dëshironin, kërkonin. Ai njeri po më tërhiqte. Kur fliste e më vështronte, më vinte turp ta vështroja në sy; kur pushonte, dëshiroja të fillonte nga e para. Diçka më shqetësonte. Pas gjysmë ore do të zbrisja, do ta falënderoja dhe aq.

Kur midis nesh qe arrijtur një farë afrimi, po i vinte fundi udhëtimit. Sidoqoftë duhej t'i përgjigjesha dhe i thashë:

— Ka raste kur njeriu s'e zgjidh dot. Si t'ju them... ju bëni një punë sa të dobishme aq edhe të vështirë, pjesën më të madhe të kohës e kaloni në udhëtim, larg shtëpisë e familjes...

Ai mori frymë thellë dhe pshëritiu. M'u duk sikur iu rrudhën vetullat.

— Sa për familjen time... unë jam pa familje, jam fare i vetëm! — tha me gjysmë zëri.

— I vetëm!

— Jam jetim!

Qe një çast i dhimbshëm që më tronditi e më mallëngjeu pa masë. Përnjëherësh më shkoi mendja te nëna, babai, vëllezërit e farefisi.

— Po farefis kini?

— Asnjë, jam fare i vetëm, siç më shikoni!

Fjalët e fundit më ranë si plumb në zemër dhe u pendova që kisha bërë atë pyetje të pamatur. Fytyra më digjte nga që më ish përflakur.

— Të vjen keq që jam jetim?

— Më falni, s'desha t'ju prekja.

— Edhe ju më falni që ju dëshpërova...

Kur hoqa sytë nga ai, pashë përpara një shesh me drurë e maqina. Dy kasolle druri, të lyera me qumësht gëlgereje, zbardhnin si dy lëvozhga veze. Kishim arri-tur në stabilimentin e sharrave dhe as e kisha kuptuar fare.

Kur zbrita nga maqina, isha e hutuar; vështroja rreth e rrotull pa qëllim. Ajri i freskët i përzier me erën e ashklave e të tallashit ma shkrifte trupin pas asaj mpirjeje. Tej, mbi majat e pishave, dielli sitte rrëzët e vakta dhe të kuqërrrema. Tek vështroja ato rrëze, kuptoja se diçka kish ndodhur midis nesh. Ai njeri i panjohur më kish ngjallur interes të veçantë, dhe, pa dashur apo pa e kuptuar, e shikoja veten të lidhur pas tij. Isha e gjëzuar që isha takuar, më vinte keq që do të ndaheshim. Ai kish lënë gjurmë në shpirtin tim e më kish zgjuar ndjenjën e dashurisë.

— Po të kish rrugë, do t'ju shpija deri në vend — tha.

— Falem nderit edhe me kaq.

— Megjithatë do t'ju shoqëroj! Kam kohë të lirë deri sa të ngarkohen ato tri maqinat që kanë ardhur para meje.

Dhe papritur që të shfaqja pëlqimin tim, ma mori valixhen nga dora dhe u nisëm.

Ai më nxori në një ullishte që gjarpëronte në buzën e një pylli. Ishte një shteg i bukur malor. Ndofta se s'kisha kaluar kurrë në shtigje të tillë, po më pëlqente aq tepër. Ajo copë rrugë që një diçka e veçantë për ne të qytetit, sepse dredhonte nëpër bukuritë malore: nëpër

prozhmet, përrenjtë, lirishtet e shullëret. Anës së saj rritheshin manaferra, dredhëza, dëllinja, trandafile të egër e lloj-lloj kaçubesh. Një botë e panjohur na rethonte. Jo shumë larg dëgjoja një cicërimë. Qëndrova dhe dëgjova atë ligjërim. Shoferi qe ulur pranë një burimi dhe kish ndezur cigaret. Ai më vështronte vjedhurazi.

— Sa bukur që është këtu — tha ai me një ton të gëzueshëm.

Unë sodisja dhe mendoja. Një ndjenjë e paprovuar ndonjëherë po ma mbushte zemrën. Ai m'i kish trazuar ndjenjat e vashërisë. Isha dashruar pas tij!

Pas një heshtjeje që zgjati disa minuta, ai ktheu fytyrën nga unë. Qe zbardhur e sytë i shkëlqenin. Kish një shqetësim të brendshëm, që i spikatte në buzëqeshjen e lehtë, e cila po ja mbushte fytyrën dalëngadalë.

— U njohem në rrugë, por me emër nuk njihemi...

— Kini të drejtë — i thashë, — as mua s'më shkoi ndër mend t'ju pyesja.

Dhe u njohem.

— Kështu, Vjollcë, u bëmë miq. Nuk do të më harrosh? — më tha ai.

— Kurre!

— As unë!

U pamë drejt në sy. Më dukej sikur më dridhej zemra. Ai uli sytë, e përcolla e pëshpëriti:

— Vjollcë!

Sa shumë kish ndryshuar zëri i tij. Nga shprehja e fytyrës diçka kuptova.

— Vjollcë... — përsëriti ai më me ngadalë.

— Çfarë!

— Mund të të them një fjalë?

— Vetëm një.

— Po.

— Thuaje.

— Ma jep fjalën se s'do të më zemërohesh.

— Ta jap.

Dhe më tha se më donte, kjo qe e gjitha — shtoi Vjollca.

— Ky është një roman i vërtetë — bërtiti Drita e trondititur. Më mallëngjeve, Vjollcë, m'i zgjove ndjenjat, të falem nderit. Ç'kam bërë unë deri tan? Asgjë. Jam treguar një formaliste e asgjë më tepër. Veç detyrës që e kam përbushur thjesht, s'kam treguar asnjë interesim për nxënësit. U ndava nga Jani që më deshi aq shumë. Së fundi kam bërë lutje për t'u transferuar në qytet! ...

— Ti ke bërë lutje? — hapi sytë Vjollca. — E harrove premtimin e njëzëshëm në mbrëmjen e lamtumirës?

— E harrova — belbëzoi Drita dhe mbuloi fytyrën me duar.

Pendesa e kish dërmuar aq tepër shpirtërisht, sa nuk e zotëronte dot veten. Prandaj më tepër se në atë çast, kurrë më parë s'kish pasur dëshirë që t'ja hapte zemrën Vjollcës. Këtë që deshi të bënte me Vjollcën, s'kish menduar kurrë ta bënte me Janin dhe një nga arësyet që ishin zemëruar që edhe kjo.

Asaj i dukej sikur i kishin mbetur këmbët në baltë, ndërsa mendjen e zemrën e kish gjekë, përmatanë atyre maleve, andej nga shtrihej qyteti me rrugët e asfaltuar, me parqet, me teatrat me njerëzit e edukuarë me modën. Zemra e saj nuk vërshonte më, as kish frymëzim. Ajo bënte një jetë të zbrazët e të varfër dhe i përgjantë një varke pa lundëtar, të cilën s'dihej se ku do ta flaknin dallgët.

Dhe ja tani, Drita në shtëpinë e Vjollcës, në një dhomë të pastër, komode e me dritë. Ajo qau shumë, derdhi lot në qetësi dhe e zbrazi zemrën e fryrë. Pas asaj dënese, pati një qetësi në shpirt e një mallëngjim të madh, që filloj t'ja zbutë zemrën e ndjenjat. Mengadalë ngriti kokën dhe i mbajti sytë e përkuqur në fytyrën e Vjollcës. E, duke e parë drejt në sy, filloj ta ndjejë

veten të shkëputur nga ajo vetmia torturonjëse. Në atë çast kishte vetëm një dëshirë të madhe e të zjarrtë, dëshirën që të shkëputet sa më parë nga ajo bota e saj e errët. I vetmi gjëzim i saj në atë çast s'ish tjetër veç të harronte sa më shpejt të shkuarën e të fillonte jetën rishtas. Ajo kish nevojë të qe e qetë, e gjuar dhe e lumtur siç qe Vjollca.

SHPATI I «MALLEKUAR»

Në peisazhin e trishtuar e të egër fë grykës me shkrepë e shkarëzime të kuqërrrema, syri të shquan një shpat të blertë e të butë. Një si oazë e harlisur ta zbut synë e të shtie në zemër një farë gjëzimi. Është njësoj sikur të jesh në mes të një shkretëtire apo të një dje rrine, e cila të rraskapit e të zhurit për një lot ujë, dhe papandehur bie në dhera të ndyllta e me bimësi jo shëse. Ashtru e ndjen veten edhe përpara shpatit.

Mes për mes grykës është një shteg ku udhiëtojnë druvarët e barinjtë. Andej zbresin katundarët e fshatrave të Devollit, andej rrahin ushtarët e Moravës. Megjithëse në grykë gurgullon një përrua, prapëseprapë etja të than buzët, sidomos në ato muajt e nxeh të kur uji s'arrin të kaptojë grykën, por thahet që rrugës se e pijnë dheu e gurët.

Në vjeshtë, kur fillojnë shirat, pamja ndërron krejt. Bëhet një shtjellje e çuditshme resh dhe avujsh, që ecin e përdridhen, ngrihen sipër e përplasen poshtë, sikur i shtyn ndonjë bateri e fuqishme ventilatorësh. Ajri i ftohtë dhe i lagët të qull si papandehur. Erërat fryjnë pa pushim e me tërbim të madh duke sjellë ca buçima të forta dhe vërvëllima të mprehta. Dhe, befas, vjen shiu i rrëmbyer. Atëherë fillojnë rrëketë, lëvizin gurët, lozin shkëmbinjtë. Të duket sikur ata shkëmbinjtë mësivë e kryepërpjetë, që janë mbi shpat, pjellin gurë e shfryjnë ujëra dhe i vërvitin tatëpjetë me një zhurmë të lemerishme. Dhe përroi thith, pështjell dhe i trazon

me ujët e turbullt. Kjo shakullimë poteresh dhe rrëbeshi, kjo shfryrje dhe rrëkëllimë e vrullshme, që ka mbjellë tmerrin te barinjtë dhe udhëtarët, ka pjellë e ka thurur, gojë pas goje, legjenda e pandehma të çuditshme.

Trengjnë së atje lart, te shkëmbinjtë, ndër ca guva që sot s'egzistojnë, qenkshin strehuar e paskshin rrojtur pa ngrënë e pa pirë një vit të tërë dy çupulina të ikura, e pasi kishin agjëruar gjatë, na ishin kthyer në xhinde. Këto gjoja i shikonin barinjtë përpara se të fillonte rrebeshi. Një herë tjeter kishin parë një gjë më të çuditshme: një valle të zjarrtë në mes të natës, kur ende s'kish dalë hëna. Vallja, pastaj, qe kthyer në një tym të bardhë dhe, sapo që kish dalë hëna, ish prishur. Një ditë dimri, kur disa gjuetarë u kishin zënë pusi ujqve, u kishin parë sytë atje te shkëmbinjtë një zjarr me flakë kaltëroshe. Zjarri qe tepër i madh dhe rrëth tij qe një trumbë e tërë vajzash flokëgjata. E çfarë s'ishin parë atje! Mjafton të hapje gojën se te shpati u pa kjo apo ajo që njerëzia ta besonin verbërisht e ta mbanin nëpër gojë.

Kështu u krijua bindja te njerëzit e paditur se ata shkëmbinj ishin streha e xhindeve dhe se shpati qe tokë e djajve. Si për t'i forcuar këto bindje, erdhën e të ndodhën dy ngjarje njëra pas tjetrës. Atëhere s'mbeti njeri pa i besuar «çuditë» e xhindeve.

Aty shtatëdhjetë apo tetëdhjetë vjet të shkuara, na paskëshin dalë ca barinj muhaxhirë e na paskëshin lëshuar dhentë, megjithëse burräria e fshatit u kishin thënë se ai dhe s'mban gjë të gjallë. Ata jo vetëm që s'jau vunë veshin fjalëve të tyre, por na ngritën edhe vathat e kasollet, mu në rrëzë të shpatit. Por dheu vërtet s'i mbajti dhe një ditë u bë gjëma. Erdhi shiu si lumë, erdhën ujëra të rrëmbyera dhe i përlanë bagëtitë, vathat e kasollet me gjithë njerëz. Po atë mot, më të dalë të vjeshtës së dytë, befas ja kish plasur dimri. Një dimër i madh që rrëfehet edhe sot e kësaj dite. Bora erdhi para kohe e me tufan. Në dimër

me tē vërtetë nuk kalohet në grykë, sepse erërat janë tē furishme e tē përherershme. Ato e mbledhin borën nga shpatet, e përplasin dhe e ngjeshin në përrua dhe i japid tjetër relief tokës; zhdukët përroi, humb shtegu, s'njihen rrëzomat. Syri tē sheh vetëm një bardhë-sirë tē pamatur si shkretëtirë, tē heshtur si varr e tē shkëlqyeshme si xham. Kur bie dielli, mund t'i shikosh fare qartë si notojnë në erë kristalet e shumë-llojshme tē borës e si marrin nuanca nga rrezet e dieillit. Dhe atë dimër gjeti vdekjen druvare i varfër, plaku Shine. Ja, atje te këmbët e shpatit është varri i tij.

Plaku i gjorë mezi jetonte. Fëmijët i vdisnin fare tē mitur, ja merrte vdeka shumë shpejt e plaku, me gjithëse kish pjellë për mot, s'qe e thënë që t'ja zinte duart gruas me ndonjë vocërrak. S'kishte tokë i gjori, as gjë tē gjallë. Kish vetëm një kasolle kashte, një latoshkë e një tarkuzë tē dhirtë, që lidhët drutë. Piste dru në mal, bënte shkarpa e i ngarkonte në kurriz. Bënte dy orë udhë vajtje e dy orë ardhje, i ngarkuar sa për një anë gomari. Ashtu jetonte, shiste dru e shkarpa, po një ditë s'u kthye në shtëpi, se mbeti në borë, e mbyti tufani, vdiq! Në pranverë e gjetën kufomën ca zemërmirë dhe e kallën në dhe. Drurët që kish prerë ja ngulën përreth varrit dhe mbi kokë i vunë një gur shtufi. Atëhere u ndezën gojët e thanë: «E muarënhindet që ta bëjnë djall se ai s'qe njeri po lugat. E kish mallëkuar Zoti gjersa s'i rronin fëmija e gjersa s'bëri prokopi.»

Që atëhere ja vunë emrin «shpati i mallëkuar». Fort bukur e trilluan tē paditurit dhe hoxha e vulosi paq. Atë deshi edhe Ali Beu, zoti i fshatit, ta braktisnin shpatin, tē mos shkelte këmba e deles apo e dhisë, që beu tē mund tē vinte dorë. Dhe fët e fët vuri dorë, e futi në tapi bashkë me tërë malin përtej. Por beu dinak s'e mbolli atë tokë, as bagëtitë nuk i lëshoi.

Ja përsë ky shpat ja ka marrë mendjen Agimit, brigadierit tē gjësë së gjallë, i cili, pas aqve vjetësh, i

ngau grigjat në shpat pa jau vënë veshin profkave. Sa herë që ulet te varri i Shines, apo lart te shkëmbinjtë, rri e mendon gjatë.

I ka shkrepur që t'i vërvitet shpatit, t'ja kthejë dhenë qilizmë e të hedhë farën, ta shëmbë e ta shkallmojë nga themeli atë legjendë të marrë. Do t'jau heqë nga mendja fanaticëve atë budallallëk, që jau ka vyskur trunë. Do t'i çlrojë njerëzit nga paragjykimet, sepse s'është e udhës që të braktisin tokën nga «frika e xhindeve».

Sa herë që lexon gazeten, do të vrejë me interesim çeljen e tokave të reja. Ata njerëz, që u janë qepur maleve, i ngjallin entuziazëm dhe e frymëzojnë. Ja, në fshatin e tyre sikur s'po ecën kjo punë. Vërtet u çelën disa toka në fillim, por tani njerëzit kanë rënë në gjumë.

Shpeshë s'është biseduar për tokat e reja, por për çudi askush s'e ka përmendur shpatin «e mallëkuar». Sikur e kanë bërë me fjalë e kanë lidhur besë, duke shkelur bukë e kripë, që të mos e zënë në gojë. Dhe shpatin s'e kanë trazuar. Ndërsa Agimit, sa më tepër kalojnë ditët, aq më tepër i rritet dëshira dhe padurimi për të vënë dorë në atë tokë.

Një ditë i tha Likos, shokut të tij:

— A e di, bre Liko, se ky shpati më ka hyrë në zemër? Pa vështroje një herë e më thuaj: s'bën të mbillet?

— Çfarë o! — ja bëri Likoja.

— Ky shpati...

— I mallëkuari; e çë?

— S'bën të mbillet.

— Po le ta mbjellin në ua mban, se mos u ka zënë dorën njeri.

— Jo se ashtu, po a u bie ndër mend vallë?

— Oj, pse, vetëm ti paske sy në ballë, të tjerët prapa kokës i kanë?

— E po gjersa s'kujtohet njeri edhe ashtu mund

të jetë, se, kur të mësohen sytë me kashtë, s'e shquan dot traun.

— Mirë, o mirë, po kjo është punë për atë.

— Për cilën?

— Për kooperativën!

— Po ne s'jemi të kooperativës, o derdimen.

— E di, o byrazer, po punët janë të ndara. Ç'të duhen ty të mbjellat, ti ke punën tënde. Shiko nxirr qengja damazi e ruaji mos t'ju bjerë ujku...

— Dale, bre Liko, se s'është ashtu; sikur s'e ke mirë këtë mendje. Thua se punët qenkan të ndara. Po të qe ashtu, s'do të kishim kooperativë. Sot kanë ndërruar kohët, punët kanë marrë udhë të tjera, vendi po bën përpara, po bëhen çudira, ore. Po ky përparim s'u bë ashtu, vetveti, as ra nga qielli, u bë me djersën e të gjithëve, u bë se njerëzit u lidhën fort me njëri-tjetrin e më t'i vunë gjoksin punës.

— E po si thua ti, o byrazer?

— Të interesohemi për çdo gjë që kemi përreth e të mos presim të na thonë.

— Ti bëjmë punët dhallë, ë? Të nakatosemi me të gjitha që pastaj të na thonë «mos futni hundët në gra-zhdin e botës»!

— Po të jetë për të mirën e përgjithshme, le të thonë. Po kush do të thotë, ata mendjefyçkat e gojëtersët.

— Domethënë zotrote dashke të dalësh përpara pleqve, ë? Mirë po dëgjo këtu: njerëzia s'të qasen këtu; ky vend u ka sjellë të liga e s'ua mban ta trajnë se do ta ndjellin vetë tresllékun. Është i mallë-kuar ky. Ka xhinde!

— Ashtu thua edhe ti?

— ?!

— Këto janë profka e budallallëqe që i kanë pjellë mendjet e njerëzve të paditur, o Liko. Ahere shpiknin q'tiu vinte për voli, mjafton që ta mbanin gjallë fryshtë e paragjykimeve dhe idenë e ndëshkimit të Zotit. Po as

bagëtia s'u mbyt, as Shineja s'vdiq me urdhër të xhindeve. Le pastaj ato përrallat e tjera. Ore, u është futur në tru njerëzve kjo legjendë. Fort bukur e kanë trilluar, po beat ama, s'i bënte bef syri!

Agimi qeshi me zë të lartë, i hodhi dorën në qafë Likos e i shkundi kokën si t'ja sillte mendjen në vend se edhe ai po atë mjegull kish në kokë.

Agimi kishte rrahu shumë rrugë në jetë, kishte parë e dëgjuar shumë lloj njerëz, kishte udhëtar në-për udhë të gjata me autobus e me tren, kishte kapër-xyer detin nga Vlora në Sazan, kishte hyrë vullnetar në aksionet e rinisë e kishte mbaruar shtatëvjeçaren. Në ushtri mësoi zanatin e zdrukthëtarit dhe, kur u lirua që andej, bëri një kurs të ulët për zooteknik. Dëshirën për zooteknikën e kish pasur që në fëmini, gjithmonë i kish pëlqyer gjëja e gjallë. Tani punonte për të përmirësuar racën e dheneve.

Ai jeton maleve, atje ku kullozin grigjat. Përpipet me mish e me shpirt për rritjen e qengjave të racës dhe për të arritur rendimente të larta në prodhim. Kujdeset veçanërisht për kullotat, zgjedh barërat e ëmbla, ato që japid më tepër qumësht dhe yndyrë, dhe zbaton rregullat simbas librit apo «thorisë», siç ja quajnë barinjtë pleq. Mirëpo ai nuk kënaqet me punën e vet, përkundrazi do të ndihmojë në të gjithë aktivitetin e kooperativës, madje i pëlqen të derdhë djersë atje ku është më vështirë. Mendon seriozisht për çeljen e tokave të reja. Kjo e ka shtyrë vjetët e fundit, të ndjekë me kujdes vegjetacionin e livadheve e të djerrinave, barërat që rriten dhe vlerën ushqyese të tyre. Bile ka shkuar edhe më tej. Ka rëmihur dherat dhe ka vrejtur strukturën e tyre. Disa toka i kanë lënë përshtypje për sasinë e humusit që përbajnjë. Shpati «i mallëkuar» është shumë i pasur në humus. Të gjitha këto i ka hedhur në një fletore të cilën e mban me vete në trastën e bariut së bashku me udonjë libër, gazetë apo revistë. Punët e tij me kartëra nuk e çuditin më pak Likon se sa barinjtë e tjerë, prandaj ata kanë

respekt pér këtë djalë të ri, i cili po pérparon nga dita në ditë, duke mësuar shokët e duke mësuar prej tyre.

«Së pari duhen bindur njerëzit — mendon Agimi — e kjo punë duhet të fillojë që nga Likoja. Ndofta s'ka faj i shkreti, se truri i tij është tepër i ngushtë pér tē punuar mendime tē tilla. Po Likoja kështu mbeti, është ai i një vakti e një kohe, bari i shkujdesur, indiferent, i mbyllur në vetvete si kërmilli në guaskë e fjalëpakte. S'di ç'bëhet tej grigjës. s'lexon kurrë dhe rrallë shkon në mbledhje, vetëm në muajt e dimrit kur bagëtia dimërojnë në shtallat e ngrrohta.

«Sa punëtor është në punët e grigjës, aq përtac tregohet në punët e veta, e megjithëse unë i rri çekan mbi kokë, prapëseprapë me shumë zor bën pérpara. Ato qëka mësoi në tri klasë fillore, gati i ka harruar, në armë nuk e ißhirrën se ka një këmbë tē sakatuar dhe veç Korçës s'ka parë ndonjë qytet tjetër».

Vrulli që ka shpërthyer në tē katër anët e vendit e ka entuziazmuar Agimin, i kanë hedhur në gjak e në zemër idera tē kuximshme. Tek kujton njerëzit me tē cilët do tē bëjë «përbysjen», mendja sepse i qëndron pér një çast te Liria. Ajo është brigadiere e shpendëve dhe shquhet mbi shoqet. Kundër vuillnitit tē babait ajo shkoi në akcionin e rinisë në hekurudhë, mori pjesë në festivalin e këngës në rrëth dhe tanë së fundi është rrëgjistruar në shkollën e natës.

Duke u shkëputur nga këto mendime, Agimi e lidhi sërisht fjalën e këputur:

— Tokë e butë kjo, o Liko. Apo s'e thek djelli. S'do shumë punë; një qilizmë tē mirë, vijat kulluese, ca terraca dhe ec e hidh farën.

— Ore, e paske me gjith mend ti?

Agimit i rrahu gjaku nën lëkurë. Pamja e çuditshme që kish marrë fytyra e Likos edhe e ndillte edhe e largonte. Ajo kish një shprehje tē hutuar, habie dhe mosbesimi, që lind te njerëzit kur dëgjojnë çudira apo fjalë tē padëgjuara. Sytë e Likos, tē vëgjël e bojë kafe,

lëviznin pa pushim herë mbi Agimin herë mbi shpatin «e mallëkuar».

— E ta mbjellim patate! Do të marrim prodhim të bollshëm! Do t'jau shkulim frikën atyre që besojnë se kjo tokë sjell vetëm fatkeqësi.

— S'të vë kazmën njeri në atë dhe. Të gjithë do të jenë kundra.

— S'duhen shumë njerëz. Ne të rinisë jemi boll. Likoja kapsalliti sytë e s'foli më.

* * *

Ditët rodhën si ujët e kroit. Agimi kish bërë shokë me vete dhe, komunistë e të rinj, kishin rënë në një mendje. Në fshat zienin bisedat, haheshin njerëzit, disa bindeshin, disa zemëroheshin. Kish dalë fjala se Liria e kish mprehur fjalën me Fatimenë, një grua e thyer e terse. Alija kish bërë për vete ata të shtëpisë, kurse Petriti, Selamiu e të tjerë kishin bindur tërë mëhallën. Vetëm me Qazon, të jatin e Lirisë e me Nuren, që ishin gjitonë s'i kish ecur fjala askujt. Ata i kishin përzënë njerëzit.

Mbledhja u lajmërua tri ditë më parë. Njerëzit u njoftuan kokë më kokë. Agimi thirri edhe barinjtë.

Katundarët u mblodhën si zakonisht në shkollën e fshatit. Komunistë e të rinj ishin shpërndarë bankë për bankë, ishin shkrirë në masë. Agimi me disa të tjerë kishin zënë vend në bankat e para. Ishte entuziast, fytyra i kish marrë pamje të gëzuar e fliste pa pushim.

Në mur, përballë portës së hyrjes, dukej një parullë e madhe e sajuar me gërmë letre të bardhë. «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i bëjmë ato pjellore si dhe fushat». Anash, në njerin mur qe shkruar: «Të çelim toka të reja» dhe përballë tij: «Të luftojmë paragjykimet».

Fshatarët hynin trumba-trumba. Agimi vrente fyturat e tyre e përpiquej t'iu blente mendjen. Disa fy-

tyra i dukeshin tē gëzuara, tē tjera tē zymta. Kish nga ato që nuk shprehnin asgjë dhe dukeshin si tē përgjumura. Disa i hidhnin çapet me përtim, zinin vend në heshtje, dridhnin cigaret, mbushnin llullat e tymos-nin në getësi.

Mbledhjen e hapi kryetari, i cili, pasi foli për rëndësinë e problemit, shtoi:

— Këtë vit duhet tē çelim pesë hektarë tokë tē re. Tokën do ta çelim në mal, prandaj do tē na duhet punë. Do tē kemi vështirësi, do tē na duhen përpjekje, por do ta bëjmë.

Pastaj agronomi lexoi emrat e tokave, tē cilat parashikoheshin tē punoheshin. Kur përmendi shpatini «e mallékuar», Agimi rrrotulloi sytë mbi gjindjen. Pikkërisht në atë çast njerëzit lëvizën, hapën sytë dhe thithën cigaret që edhe pse kishin thënë tē mos pinin s'i kishin shuajtur akoma. Ishte një lëvizje e par-vetëdijshme. Tymrat erdhën e dolën shtëllunga-shtëllunga nga dhjetëra gojë, muarën përpjetë tavanin e u pështollën njëri me tjetrin duke sajuar një re tē dendur bojë qielli. Disa caste s'u ndje as zhurma e frymëmarrjeve, pastaj dalëngadalë e një nga një, si ato zogat kur dalin nga krahët e kloçkës e zënë tē çukasin tokën, edhe njerëzit zunë tē pëshpëritin e tē ngrenë zërin.

— Me leje! — u ngrit Qazua, i ati i Lirisë. Fytyra e bëshme bullafiqe i kish marrë zjarr. — E para e punës pesë hektarë janë si shumë, bre... e dyta kini vajtur e kini zgjedhur ca shullëre e rrëzoma ku s'të çapitet dhia e jo njeriu. Se sa për t'i vënë në kartë s'është ndonjë punë e madhe, o djema, trimëria është ahere, kur t'u vesh parmëndën...

— Pa t'i zëmë me radhë e t'i shoshitim një e nga një ndërhyri sekretari i organizatës së partisë. — Sa më shumë mendime aq më mirë.

Qazua krojti zverkun e vijoi:

— Ja, ta marrim që nga shpati... Përse e kini vënë atë, për numër? Apo doni tē na vejë puna bosh? Atë

shuajeni me vakt se s'është i prokopisur, s'ja kanë vënë
kot emrin «i mallékuar».

Agimi i shkeli synë Selamiut që kish pranë.

— Ashtu them edhe unë, — brofi Nurja, një burrë
thatim dhe i gjatë si hosten. — Është dhe shterpë, s'ka
farë që të zërë atje, pa, në doni të na i nxjerrë ujet mbi
dhe e të na i degdisë në përrua, është tjetër punë!

— I ke rënë më të, o Nure! — se kush foli.

— Ore shokë, u ngrit Fatimja, gruaja terse në punë
e terse në gojë. — Dashkeni ju të mbjellim shpatin «e
mallékuar». . . po pleqtë tanë pa mend të kokë paskan
qenë, ore, që as bagëtinë s'lëshonin atje? . . . Apo doni të
na i mbytë çupat e djemtë e të na i vrasë me gurë? Pa,
pastaj, rrëzomat s'e mbajnë farën, se janë si ky barku
im — e i ra barkut me dorë.

Aq deshën djemuria e ja dhanë gazit, përplassën
pëllëmbët e i hodhën romuze Fatimesë, e nxitën të vazh-
donte, por ajo qe ulur e po hahej me Alijen.

— E shkele, moj Fatime, na turpërove brigadën. . .

— Ti rri urtë, se je çupërlinë në këto punë.

— Doemos të vjen thartë të ta përflasin llafin, po
si s'the bardho njëherë, moj.

Liria dridhej nga marazi që i ati doli kundra i pari.
Një nyje i qe bërë në grykë dhe sikur i zinte frymën.
Ajo s'po e duronte dot atë heshtje dhe, sikur ta shtynte
njeri që prapa, sikur dikush t'i kish dhënë forcë e guxim,
çoi dorën e u ngrit. Përnjëherësh ftyra iu zbardh. Pa
të atin, sekretarin e organizatës dhe Agimin.

— Folë, Liri, — i dha zemër sekretari i organizatës.

Dhe ajo, pasi rrahu një çast kapakët e syve, tha:

— Deri tanë të gjithë folën kundra, unë do të flas
pro, se ashtu më duket më e drejtë, ashtu më mëson
partia. . . Siç duket, u dashkan vjete t'ua mbushësh ko-
kën disa njerëzve për ato gjëra, që janë të qarta si drita e
diellit. Po kështu s'bëhet, se turpi do të bjerë mbi ne.
Ata që ua kanë frikën xhindëvë, le të rrinë mënjanë, ne
të rinjtë do ta çajmë shpatin. . .

Dhjetëra sy ishin qepur mbi ftyrën e djersitur të

Lirisë, dhjetëra veshë dëgjonin për të parën herë zërin e saj të vendosur, që ngrihej kundra babait. Qazua, i kuqur prush deri në veshë, e kish humbur toruan fare e sikur s'i besohej që ajo që po fliste ish Liria, çupa e tij. Kjo isht enjë prishje e madhe, u habit, s'kish ndodhur ndonjëherë në fshat të ngrihej çupa kundër babait në sytë e botës.

— Do ta çajmë ne, të rintjtë — shtoi ajo — që t'iu tregojmë të gjithëve se përrallat që kanë kurdisur parësia dhe hoxhallarët nuk pinë ujë më!

— Të lumtë, Liri! — bërtiti Selamiu — dhë, duke përplasur duart e duke i mëshuar zërit, tha:

— Unë dal i pari!

— Edhe unë.

— Shkruajmëni edhe mua.

Zëra të tjerë bërtisnin, përkrahnin Lirinë, dilnin vullnetarë.

— Qetësi, mos prishni radhën e fjalës — ndërhyri kryetari që mezi mbahej nga entuziazmi.

— Do të bëjnë mirë këta prapanikët — ja priti Alija — të na lenë rehat në punën tonë. Fundja s'kemi nevojë për ndihmën e tyre, as jau kemi frikën.

— Vëri fre gojës, çupë, s'na u bëre avukate ti, ka të tjerë përpara teje.

— Të gjithë janë njësoj, o Qazo!

— Si këmbët e dhisë, ë?

— Ti, Nure, mbaj gojën — ja ktheu Kenua — s'kemi ndër mend të bëjmë gjyq këtu.

Agimi pa sekretarin e partisë, që ja kish ngulur shikimin e po e vrente në bebe të syrit. Po atë çast pa edhe sytë e Lirisë, që qenë qepur mbi të. Në gojën e saj të vogël e të trëndafiltë lodoronte buzëqeshja. Të kuqtë ja kish mbuluar fytyrën dhe disa fije floku gështenjë, i kishin rënë mbi syrin e majtë sikur të donin t'ja errësonin shikimin. U panëëmbël një çast, pastaj, kur ajo i mbuloi sytë me qepallat e gjata, që i bënë hije mbi mollëzat e faqeve të kuqe si cipë molle, Agimi u ngrit:

— Unë kam propozuar që shpatin ta kthejmë në tekë buke. Ai s'është i «mallëkuar», siç e quani jū. Të mallëkuar janë ata që i kanë sjellë të këqia njerëzisë, prandaj duhet ta heqim nga goja këtë fjalë. Toka dhe djërsa janë burim i të mirave, motërë të kamjes dhe hasmë i skamjes. Sikur dherat të kishin gojë të flisnin, kushedi sa do të na gojosnin, se ato kanë aq nevojë për punën tonë sa ç'kemi ne për prodhimin e tyre. S'dua t'i tregoj babait arat, po edhe kështu, siç po flisni, ama, s'e kemi punën fare në vijë.

Përse të mos e mbjellim shpatin? Ç'janë ato mendje, xhanëm? Liria e tha mirë: «ne do ta çajmë», por do të çajmë tokën dhe mendjet e mykura të disavë këtu. Vërtet është mbytur vatha, edhe druvarti Shine në shpat ka vdekur, po çfarë, mos se ashtu deshi vërtet Allahu? Aspak! Kjo s'do mend, duket sheshit. Këtë legjendë e ka shpikur parësia, e ka vulosur hoxha dhe ju e keni ngrënë. Në «tokën e xhindeve» s'u dashkish hedhur fara dhe dhentë e fukarasë s'duhej të kullotnin se djajtë do të ngriheshin e t'i mbytnin. Pa shikoni... Atje paska djaj e lugetër, «Zot na ruaj!» Po pse Ali Beu s'u bë merak? Bukur e lojti kodoshi. Edhe ai s'e mbolli, as dhentë s'i la të kullotin, po në tapi e futi ama, atje gjuante shpeshë e shtronte gosti me thëllëza e pëllumba.

— Haké llaf po thua, o Agim — u dëgjua zëri i Malos, i më plakut të barinjve.

Gjindja që gjer në atë çast ish rrëmbyer nga fjalët e Agimit, ktheu sytë me habi nga Maloja, që ish ulur në radhët e fundit. Plaku s'e kish vënë re se gjithë ato sy po e përpinin. Edhe Malua, që s'ish dëgjuar kurrë, po e bënte fora.

Mbase në ato çaste, bariu i moçëm, po sillte ndër mend atë kohë të shkuar, kur qe hyzmeqar te Ali Beu. Kujtimet e largëta e të hidhura që s'donte t'ja kujtoje, erdhën e t'ja mbështollën kokën si me një rrëth hekuri të skuqur. Si në një vëgim iu shfaqën përpara syve ato kohëra, kur fshatin e urdhëronte beu. Atë-

here Maloja shërbente në konakët e tij dhe i kujtohet fort mirë ç'poshtësi e fëlliqësira gatuheshin atje. Në ato kuvënde luhej me fatin e njerëzve, atje niseshin e bitiseshin lloj-lloj kurthe e mynxyra. Që andej din-nin qahjallarët e dhjetarët me urdhëra e porosi të beut. Dhe Malua, i rreshkur nga pleqëria, por duke ndjerë zemrën të fortë, që i rrihte si kurrë ndonjë herë, pasi pikasi gjithë ato shikime, i dha trupit përpjete dhe vazhdoi:

— Beu, ore, i ka shpikur që të mos i prisheshin çerdhet e thëllëzave, e sojliu s'rronte dot pa gjah, pa donte të ushqehet me shpeshëri e me lepuj të egër që t'i zbardhej lëkura e t'i zbutej mishi. Na gënjeu zu-zari, ç'deshi bëri i paudhë, e ne, fukaraja, i rrnim me dorë në zemër e i bënim temena. Si zgjedhën e qeve na e kish hedhur kularin. Po s'qe e thënë të rronim si bagëtia se partia na hodhi krahun e na hapi sytë...

Siq shpërthen breshëri ditëve të verës, ashtu u ngritën zërat. Bankat kërcitën, njerëzit këcyen të ngac-muar, të zemëruar, të entuziazmuar.

Qazua kish mbetur gojëhapur dhe me sy të zgurdulluar. Nureja i shastisur, si atij që i ka shkrepur flaka e rrufesë mu përrpara, fërkonte sytë e mjekrën, që i drij-dhej fort.

Malua s'po bënte të ulej, por vështronët herë Agim-min herë ata të kryesisë, sikur të donte të merrte vesh në i kish thënë mirë ato fjalë apo jo.

Dalëngadalë zërat u ulën, poterja u zbut dhe sekretari i organizatës e mori fjalën:

— E dëgjuat, shokë? Këto që tha Malua janë shumë të vërteta. Se ç'kanë punuar bejlerët e agallarët për të na gënjer, ato s'rrëfehen, puna është të shkulim nga mendjet tona paragjykimet se na sjellin dëm dhe të bindemi për kotësinë e tyre. Kjo s'është punë e lehtë, sepse njeriu nuk ndryshon kaq shpejt. Mbeturinat i kanë rrënjet të thella si të lisit, të cilit edhe pse rrufeja ja ka prerë e gjymtuar degët, qëndron më këmbë deri sa ta qëllojë në trung e ta ndajë më dysh.

Edhe Likua, që gjë në atë çast s'kish ngritur kokën, sepse s'dinte me cilët qe, tanë që ngritur më bërryle e po lëpinte buzët, siç bënte sa herë që dëgjonte gjëra të padëgjuara.

— Në votë — thërrisinin njerëzit.

— Të gjithë jemi të një mendimi, të gjithë — ngriheshin dhjetëra zëra.

* * *

Rrezet e diellit binin pingul mbi grykë. Përroi rridhte me rrëmbim. Ujërat vetëtinin dhe stërkalat thërmoheshin në erë. Agimi, në krye të kolonës, me kazmë në sup ja kish marrë këngës. Buzët i dridheshin dhe sytë i shkëlqenin tek vështronë shpatin gjelbërosh. Të gjithë këndonin, por mbi të gjithë zërat shquhej zëri i Lirisë dhe i Likos, që ecnin pas Agimit. Kënga ngrihej lart e jehonte thekshëm në grykë. Ajo këngë po sillte jetën në shpatin e «mallëkuar».

Dhe kur kazmat u ngritën në erë, dhe kur dheu i zi dhe i vakët e pa dritën e diellit, një trumbë thëllëzash rrahu krahët e mori fluturim.

ATË E VRAU NDËRGJEGJIA

Pagatori u hodhi edhe një sy emrave në bordero dhe, pasi shënoi në një copë letër rrögën e furnitorit dhe të shoferit, filloi të numërojë paratë e mbetur. Të hollat, që kishin mbetur në sirtar, ishin dhjetëshe, pesëdhjetëshe e fare pak qindshe. Kish edhe lekë e gjysma leku që dilnin nga sirtari sa herë që shkonte dorën. E shtriu dorën thellë në sirtar dhe seç preku në një qoshe. Ju duk se gishtërinjtë i takuan në një si paketë. E nxori sirtarin jashtë dhe pa me habi një tufë të hollash të tjera të mbështjella me një rrip letre.

«U!... Po kjo? Nga doli kjo tufë?» I mori në dorë duke kapsallitur sytë dhe i peshoi. Mbeti gojëhapur një çast dhe një nerv i vogël mbi syrin e djathtë iu fry sakaq e i rrahu me një «tik-tak» të shpejtë. Ai nerv i vogël ngrinte krye sa herë që Nevrug Topi gjendej përrpara ndonjë të papriture të çuditshme. Edhe zemra filloi t'i rrihte fort, edhe fikthi i lëvizte poshtë e lart.

«Do të ketë ndonjë ngatërrsesë këtu» tha dhe filloi të numërojë të hollat. Ishin plot pesëdhjetë mijëshe. Duart iu drodhën, i ra ballit me pëllëmbë dhe lëshoi një fishkëllimë habie.

«Duhet bërë edhe një herë llogaria, pesëdhjetëmijë lekë... s'i thonë shaka!»

E filloj llogarinë nga e para. Mblodhi shumat e lekëve, numëroi të hollat e mbetur, kontrolloi dokumentat, por gjithshka ish në rregull si edhe më parë, s'lozta as gjysma e lekut. Një palë sumbulla djerse erdhën e

t'i veshën ballin e gjerë. Pëllëmba e bardhë dhe e butë, me të cilën fërkonte faqen ashtu kot, pa vetëdije, i dridhej fort. Buzët iu thanë sikur ta kishin kapur ethet. Lidhka me pesëdhjetë mijëshet e kish turbulluar e ja kish ngritur mendjen. Pesëdhjetë mijë lekë të tepërt... Sikur i kish pjellë sirtari, sikur i kish hedhur një dorë e padukshme apo sikur kishin rënë nga quelli.

«Mos po më punojnë ndonjë reng? Bah! Ç'flas unë, kush mund të lozë me një shumë të tillë, arkëtari? Po unë jam në rregull, dokumentat flasin vetë; unë firmo-va për treqind e njëzet e pesëmijë, kurse ay më paska dhënë pesëdhjetëmijë më shumë. Treqind e njëzet e pesë. Pa shiko. Kushedi si do t'i jetë fiksuar në kokë të gjorit. Po, po, dhe ai bëri vetëm një lëvizje të dorës e hodhi një lidhkë më tepër. As mua s'më ka rënë në sy. Kjo është e gjithë puna. Po unë tani ç'të bëj me këto lekë?»

Këto fjalët e fundit që i tha me zë të shtruar dhe fare të ulët, i suallën një të qeshur me zë të lartë sa që buçiti tërë dhoma, fytyra e verdhë iu përskuq dhe trupi iu ndez sikur i mori zjarr. Entuziazmi i papritur, që e pushtoi vetëtimthi, i jepte një magjepsje të quditshme. Befas brofi më këmbë.

Qe bërë me të holla, i kishin rënë në pjesë pa zgjatur dorën e pa bërë ndonjë lodër. Kot kish pritur llotarinë e obligacioneve të huas. Atëhere s'i kish qeshur fati, po më mirë se do të qe bërë bujë dhe gruaja do të kishte shtënë dorë, s'do t'ja linte në xhep Nevruzit se ja dinte huqin. Pastaj ç'fitim do të kishte? Do ta tregonin me gisht ndonjë javë si njeriun me «fat» dhe asgjë. Por atij s'i duhej të tregohej as të mbahej nëpër gojë, ai deshi ta kish xhepin plot e t'ja bënte qejfin vetes sa herë që t'i shkrepte. Ja tani ky çast kishte ardhur dhe veç tij askush tjetër nuk dintë gjë për këtë tufë të tepërt të hollash. As vetë arkëtari i bankës që ja kish dhënë me dorën e tij. Tani ai qe zot i plotë i këtyre të hollave e mund të bënte ç'të donte me to.

Mund tē shkontakte qē tē nesërmen, nē bankë e t'ja dorë-zonte arkëtarit, po tē donte i fuste nē xhep dhe kaq. Edhe sikur arkëtari t'ja vinte gishtin, ai s'do tē qe i detyruar pér asgjë, faktet s'egzistonin dhe as qē mund t'i provohoj. Pastaj atë ditë arkëtari kishte shpër-ndarë tē holla nē më shumë se tridhjetë veta.

I ngazëllyer dhe me shumë mendime tē «bukura», pagatori mbylli borderotë nē kasafortë, vuri tufën me tē holla nē xhepin e brendshëm tē xhaketës dhe doli duke fërshëllyer.

* * *

Që nē mëngjes u hap fjala si vetëtimë: Arkëtari i bankës së shtetit paskish humbur pesëdhjetëmijë lekë duke i paguar dikujt më tepër!

U pyetën tē gjithë ata qē kishin tërhequr tē holla, u kontrolluan llogaritë, por asgjë. Të gjithë ngritën supet me habi dhe disa s'e besuan. Një pjesë thanë se ajo ish profkë e arkëtarit, se ai s'ish nga ata qē tē gabojnë nē numërim, ndërsa ata, që ja njihnin nder-shmërinë, shfaqën keqardhje. Kështu arkëtari i gjo-rë u bë debitor karshi shtetit, u hoq menjëherë nga ajo punë dhe çështja u dha pér ndjekje.

Kaluan ditë e muaj. Nevruz Topi filloi ta zgjidhë gesenë. Tani qe i bindur se ajo punë qe mbyllur dhe s'kish asnjë kuptim që tē frikësohej apo tē dyshonte se mos e zbulonin. Të hollat i përkisnin plotësisht. Qe bërë i pasur! Tani s'do ta «privonte» veten, tekat do t'i kënaqte. Sa fort kish ëndërruar tē kish njëherë tē holla me bollëk, ta derdhte lekun nē tavolinë pa kursim dhe t'i bënte ndonjë peshqesh vetes me ndonjë send nga ato tē modës. Edhe ai kish dëshira si tē tjerët. Apo s'i kishin hije veshjet e mira! Dhe një tē thënë e një tē bërë.

Në çdo pesëmbëdhjetë ditësh do tē blente nga një gjë tē re. Më nē fund preu edhe një stofë pér kostum.

Muajin gusht e planifikoi të shkonte në plazh. Do të kërkonte pesëmbëdhjetë ditë pa të drejtë rrëuge dhe që i bindur se s'do t'ja kursernin. Kish nevojë, ish lodhur tepër, dhe po e ndjente se s'ish mirë edhe me nerva. Kjo «shpikje» i lindi kot, një ditë tek po kthehet në shtëpi i bërë çakërqejf. Mbase me këtë profkë do t'i hidhte hi syve atyre të ndërmarrjes ashtu edhe gruas, sepse në plazh do të shkonte fill i vetëm. Deshi të qe fare i lirë, larg andrallave të shtëpisë, të jetonte një muaj si zotni në hotel turizmi dhe të kujtonte vjetët e djalërisë.

«Deti, perëndimi i diellit e pejsazhi në bregdet më ringjallin ndjenjat e fjetura, më frymëzojnë dhe më entuziazmojnë dhe unë do ta ndjej edhe një herë veten djalë, të lirë - e të pavarur» mendonte.

Kur i tha gruas se mjekët i këshillonin pushim absolut në bregdet dhe se për atë arësy qe i shtrënguar të merrete edhe pesëmbëdhjetë ditë leje pa të drejtë rroge, Dritës, së shoqes, i ra si gur në zemër. S'e kish dëgjuar më parë të shoqin të ankohej për nervat. Prandaj u shqetësua pamashë dhe njëkohësisht sepse i lindi një farë dyshimi. Madje dyshimet i qenë shfaqur që kurse i shoqi kish nisur të bënte gjithato shpenzime, por ajo i kish ruajtur për vete ato dyshime. Ajo e dinte fuqinë e të shoqit, e dinte edhe sa lekë kishte në librezën e kursimit. Sikur të gjitha të hollat që ishin ruajtur në librezë të qenë prishur, s'do të sosnin për të blerë kostumin e jo edhe këpucët, këmishët etj. Pastaj shpenzimet e plazhit. Mos kish ndonjë burim të veçantë ky dhe ajo s'ja dinte?

Drita kishte rënë në mendime. S'dinte si të bënte: ta besonte se burri ishte vërtet i sëmurë? Kjo e papritur si edhe të rejat e fundit filluan t'ja forcojnë dyshimet dhe ta brejnë përbrenda.

«Qofsha e gënjer në këtë mendjen time, por seç po më bie erë. Edhe i sëmurë edhe i shtënë pas pijes. Po atëherë përsë s'i shpenzon të hollat për kurim?... :

Ndërkaq Nevruzi po preqatiste ç'i duheshin për

në plazh, por, sa më tepër afroheshin ditët e «bukura» të cilat i kish pritur me aq dëshirë, aq më tepër po ndjente një ndryshim në vete, sikur po binte në një gjendje shpirtërore të çuditshme, sikur nuk e ndjente veten aq entuziast si më parë. Kishte një shqetësim dhe herë pas here i vinin ca tronditje të pakuptueshme. Nervat që ja shpiku vetes kot së koti, tanë sikur po i acaroheshin me të vërtetë. Dhe ai filloi të frikësohet e të dyshojë. Në punën e zyrës kishte diçka që të binte në sy. Sjelljet e çuditshme, herë nervoze dhe herë të turbullta, nuk mund t'i përcaktoje e as t'i shpjegoje. Ky ndryshim i përnjëhershëm të bënte të besoje se ishte vërtet i sëmurë nga nervat.

Ideja se Nevruzi ishte i sëmurë zuri vend dhe kjo i ngatërroi penjët edhe më keq. Shokët e punës filuan ta këshillonin dhe bënë ndërhyrje për të shpejtuar kurimin. Por së shoqes sikur s'i bëhej të besonte.

Ajo është hetonte të shoqin çdo ditë, ja vinte re ndryshimin dhe i bënte përshtypje heshtja e atij burri. Nevruzi i zymtë, i turbullt dhe enigmatik, i dukej se s'qëndronte as në qìll as në dhe, i dukej se vuante nga një brengë e madhe, sikur i fshihte diçka dhe sikur u trëmbej bisedave të lira. Drita e kish vënë re se ai sikur s'kish guxim ta vështronte drejt në sy, sikur i shmangëj shikimeve të saj dhe kjo i bënte përshtypje. Prandaj ajo vendosi më në fund t'i kërkojë shpjegime, dhe këtë e bëri një natë, kur Nevruzi u kthyte vonë në shtëpi.

Ai ishte i dehur dhe mezi i hidhëtë këmbët. Te porta e mbyllur përplasi këmbën dhe dorezën mezi e gjjeti. Hyri brenda e, pasi tha me gjysmë zëri «mirëmbrëma», flaku xhaketën dhe hoqi këpucët pa i zgjedhur ripkat. Drita e vështronte me dëshpërim dhe zemërimi i që mbledhur shuk në gjoks. Sytë i qenë mbushur me lot dhe gjaku i që ndezur.

- Përsëri vonë dhe i dehur! — ja priti.
- Nuk jam i dehur, por jam i sëmurë!
- Më tepër je i dehur.

Ai rrrotulloi kokën, shtiu sytë mbi të shoqen e bel-bëzoi:

- Nuk jam i dehur!
- Ajo, që duket, s'ka nevojë të tregohet.
- E po mirë atëhere, folë, ke më?
- Kam shumë pér të thënë, po ha darkë njëherë.
- Nuk më hahet!
- Doemos, je i ngrënë e i pirë. Duket e paske bërë udhë të hash kafeneve, larg fëmijëve... Si s'të vjen turp, Nevruz!

Dritës i dridheshin buzët dhe shikimi i përlotshëm i syve të saj të mëdhenj e të zez qe ngulur thellë mbi të shoqin. Ajo kish një angushti në zemër e një dridhmë të lehtë që ja trondiste trupin. Shumë fjalë i zienin përbrenda, e paralajmëronin: «Nevruzi është prishur, ka rënë keq, po gremiset. Shpëtojeni!»

Nevruzi, i hutuar e me sy të çapëluar, vështronë dyshmenë. E kish humbur «burrerinë» dhe, si i zënë në lak, qëndronte i nemitur dhe i çakërdisur. Drita s'kish thënë kurrë ndonjëherë fjalë kaq thumbonjëse e kaq të forta. Ato fjalë i vërtiteshin si tryelë e nxeh të në veshë.

— C'është kjo punë kështu me ty? — vazhdoi ajo. A e di si je bëre?... S'di si të ta them. njeri i çuditshëm, i ftohtë si akull, i shkujdesur dhe gojëkyçur si një memec. Po ti je babai i tre fëmijëve. Ata kanë nevojë pér fjalën dhe kujdesin tënd. Pastaj, c'janë gjithë këto shpenzime që po bën? Habitëm, ti asgjë s'bëje pa më pyetur, kurse tanë.... Dua të di me c'të holla i ke blerë gjithë këto sende.

Ai u zverdh menjëherë, kafshoi buzët dhe hapi sytë jashtë masës, por një çast më vonë e mposhti tronditjen, qeshi me tallje e tha me mospërfillje:

- Dashke të të jap hesap pér kursimet e mia?
- Ato s'majaftojnë pér gjithë këto që ke blerë!
- Paske mbajtur llogari, ë? ... Po sikur në librezë të kenë mbetur edhe dyqind lekë, c'do të thuash?
- Ma jep librezën!

Nevruzi këtë s'e priste, por, duke mbajtur gjak-
ftohtësinë, futi dorën në xhep.

— S'e paskam me vete, ta sjell nesër.

— S'kam nevojë ta shikoj sepse jam e bindur që
në librezë nuk ka më shumë se shtatëmijë lekë. Këtë
e di edhe ti, prandaj lere librezën mënjanë dhe dë-
gjomë mua, gruan tënde. E mira jote është edhe e mira
ime dhe e fëmijëve. Ndofta ti s'e kupton siç nuk po e
kuptoj edhe unë këtë punën tënde. Po unë kam të
drejtë të mos të të kuptoj ty, se ti ke ndryshuar shumë,
je bërë tjetër njeri. Dhe unë vuaj nga kjo sjellja jote,
dyshoj në ty dhe s'të besoj më. Prandaj dua të di bu-
rimin e këtyre të hollave! Ku i gjen?... Sa fort dëshi-
roj që këto dyshime të jenë veç pjellë e mendjes sime,
por edhe sikur të jetë ashtu, unë shikoj një Nevruz tje-
të, të çuditshëm, enigmatik. S'ke qenë kështu ti.

Drita mbuloi fytyrën me duar se nuk u përmbajt
dot më.

Ajo e donte me gjithë shpirt burrin. Kishin lindur
e rritur tre fëmijë, ishin marrë vesh gjithmonë dhe
me dëshirë kishin ngritur një familje nga e cila mund
të merrje shembull.

«Dikur, qe shtënë aq tepër pas meje — mendonte
në ato çaste Drita — sa s'më vinte mirë. Sjelljet e tij
aq të lapardhosura dhe lajkat s'më kanë pëlqyer kurrë,
por ai qe molepsur atëhere ndofta nga ato romanet
sentimentale, dhe, me ato që bënte, kujtonte se ma zbu-
kuronte dashurinië, kurse ai ma zvirdhete. Ai e kuptionte
ndryshe dashurinë. Ç'budallallëqe! Por unë ja shkula nga
rrënjet ato mendime, ja flaka e ja dogja romanet e
marra; ja luftova ashpër këtë pilkë të dobët të karakterit
të tij dhe besova se e pastrova. Po ashtu, me po aq
forcë, ja luftova edhe egoizmin e shpirtin lakmitar.
Këto vese i urrej fort. Kam bërë shumë, jam përpjekur
me gjithë shpirt që ta bëj njeri dhe pata bindjen se u
shkund nga pluhuret e këqia. Por ai qenka molepsur
përsëri.

Ngriti kokën dhe fshiu lotët. Kish një përzierje

mendimesh, që shfaqej në sytë e saj. Ai e vështronte i hutuar.

— Thuajmë, ti po më gënjen, apo mua më gënjen mendja?

— Ti s'di ç'flet, moj grua.

— Më ndjell zemra të keqen, më thotë mendja se çështja e arkëtarit të bankës...

Nevruzi bëri një hap prapa e pati një tronditje të fortë. Nervi mbi syrin e djathëtë i këceu përpjatë e iu nxi, mendja iu kthjellua në çast e, duke zënë kokën me të dy duart e duke gulçuar, bërtiti:

— Mos folë më; mjaft, mjaft!

Zëri i tij i mbytur, i çjerrë e i kapitur doli si buçima e shurdhër e ndonjë gjëmimi të nëndheshëm. E ajo lëkundje e fortë ja shëmbi të gjitha planet, u bë një përbysje. Dhe Drita e mashtruar dhe e gënjer, e poshteruar dhe e turpëruar, e pa të shoqin fare lakuq.

Atë çast qau fëmija. Nëna u ngrit, edhe babai u ngrit, por ndërsa ajo bëri përpara, ai s'lojti nga vendi. Dhe, tek dëgjonte përkëdheljet e nënës e tek vështronte vogëlushin nga porta e lënë hapur, ndjeu ligështi në trup, djersë të ftohta në ballë dhe një dridhmë të fortë në kupat e gjunjëve.

* * *

Gjithë atë natë, Nevruzi s'vuri gjumë në sy. Kishte një zemërim të madh në vetvete që nuk e mposhtëtë dot. Drita s'hyri në dhomë, por fjeti pranë fëmijës. Mungesa e gruas e tërboi fare, por s'kish guxim që ta thërriste. Ai ndjente një nevojë që ta kishte gruan pranë, mbasë i duhej që t'ja tregontë të gjitha, apo të dëgjonte qortimet e saj. Nuk e zgjidhët dot përsë deshi që ta kish pranë. Përbysja, që ish bërë në ndërgjegjen e tij, e kish tronditur fort dhe shqetësimet e kishin bërë si të shkalluar. I dukej sikur diçka po

i shkallmohej përbrenda. E ndjente veten keq, i dukej sikur një dorë e padukshme i shtrëngonte fytin. Fjalët e Dritës e ndiqnin pas. E sa herë deshi që t'i zbonte ato fjalë aq herë i ktheheshin e i buçisnin në veshë.

Tani po e ndjente sa poshtë kishte rënë moralisht. Shpirti i tij qe i dërmuar, i handakosur. Po e brente ndërgjegjja. Vraga që kishte lënë vepra e keqe ishte e thellë. E në atë vragë vështronë tërë poshtësinë e veprës së fëlliqur, e urrente atë çast kur përvetësoi të hollat, e quante triumf të lakisë, dehje të trurit. Dhe sa shumë e kish duruar atë dehje.

Shqetësimet e ngisnin paprerë. Edhe errësira e dhomës i kallte shqetësimë dhe trazime. I vinte frikë. U grit nga shtrati e qëndroi më këmbë në mes të dhomës. Nuk ecte, por këmbët i hiqte zvarë. U shtri përsëri në shtrat, por atje e ndjeu veten më keq. I bëhej sikur e vështronin një palë sy të butë e lutës. Ata sy sikur ishin herë të arkëtarit të bankës herë të Dritës. I bëhej sikur ish atje në bankë përpara sportelit, e përsëri sytë e arkëtarit e të gruas si në një vegim.

— Nuk mundem më, po shkalloj — bërtiti.

U dëgjuan çape, porta krisi dhe këmisha e Dritës zbardhi te praku i derës.

— Ti bërtite ashtu?

— Dritë... ti je?

— Ç'ke, Nevruz?

— Eja këtu, eja se s'jam mirë, po loz nga mendtë!

* * *

Në zyrën e shefit të policisë hyri Nevruz Topi. Pamja e tij kishte ndryshuar krejt. Kish ca sy të përkusqur e të fryrë. Në fytyrë i kish rënë një ngjyrë e verdhë si e një të sëmuri që vuante nga dhëmbje të mëdha. Këmbët i merreshin dhe vështronë i hutuar.

— Urdhëroni, qytetar — tha shefi i policisë dhe i tregoi një karrigë përpëra tavolinës së shkrimit.

Nevruzi ngurroi një çast, pastaj u ul si në mëdyshje. Shefi po e ndiqte me sy njeriun e hutuar dhe po përpiquej të merrte me mend q'punë e kish sjellë. I zgjati kutinë e cigareve dhe, kur e pa se ju drodhën gishtërinjtë, mendoi:

«Ndonjë çështje me rëndësi.»

Vështrimi i Nevruzit mbeti i hutuar apo i ngirirë mbi kallamarin e bojës së shkrimit mbi tavolinë. Ajo dora e padukshme ende s'i ishte shqitur nga fytì dhe po e shtrëngonte edhe më fort. Nuk dinte si t'ja filloente, q'fjalë të thoshte të parën. Të gjitha i ngatrrorreshin, gjuha s'i punonte. Ngriti kokën me ngadalë. Balli i qe djersitur, mjekra i dridhej.

— Më quajnë Nevruz Topi, jam nëpunës i ndërmarrjes... Kam ardhur për një çështje me rëndësi, por s'di si ta nis, më falni jam shumë i shqetësuar.

— Mos jini i sëmurë?

— Jo, jo, s'jam i sëmurë, kam në trup një diçka më të keqe se çdo lloj sëmundje.

— Qetësohuni, qytetar.

— Erdha të flas hapur!... Erdha të sqaroj çështjen e arkëtarit të bankës. Ai s'ka faj, ai s'ka bërë asnë përvetësim ashtu siç mund të kenë menduar disa. Jam unë që përvetësova shumën e të hollave, e shfrytëzova pakujdesinë e tij!. Unë e bëra atë poshtërsi dhe tani erdha këtu.

— Vërtet, ju paskeni qenë?!

— Unë! U pendova, s'munda të fshihem më. Do të qe më mirë ta kisha bërë më parë, por siç e shikoni... Nuk e di si u ndodha, të hollat ma muarën mendjen, lakmia më pushtoi si me kthethra e më nënshtroi. S'mendova ku do të më shpinte ajo rrugë. Vetëm tani e vështroj greminën, mbas tre muaj e gjysmë.

Gjatë kësaj kohe kam bërë një jetë të shthurur dhe për të parën herë e pashë veten ashtu siç jam. Besomëni, më vjen ndotë nga vetja, por dua t'i tregoj

të gjitha, të gjitha. Mashtrova veten dhe u shtyra në llum. Përse? për hiçgjë. Çdo gjë e kam bërë me ndër-gjegje.

I pandehuri uli kokën dhe heshti. Ca pshëretima të thella i dilnin kohë pas kohe. Dukej sheshit se po e ndjente thellë turpin. Ngriti kokën lart dhe u përcuall.

— Sikur ta kisha bérë këtë punë më parë!...

— Do të kiske bérë mirë sikur ta kiske bérë këtë punë më parë, por sidoqoftë e bëre tani. Më mirë vonë se kurrë, thotë nji fjalë e urtë. Ky ishte një mësim i madh. Ky pendim duhet të të ndriçojë gjithmonë rru-gën tënde të ardhme dhe të të ndihmojë të përtërish ndërgjegjen. Por këtë do ta bësh me ndihmën e njerëzve, ata do të të shtrijnë dorën që të bëhesh i denjë.

I penduari vështronte me sy të ngrirë shefin dhe mendonte:

«Sa të mirë qënkan njerëzit!»

TORNITORJA

Më në fund edhe Mira u regjistrua në kursin për tornitore. Kjo ide lindi në organizatën e rinisë së ndërmarrjes dhe u bë vendim.

Vajza e pa veten ngushtë për dy arësy: e para sepse iniciativa e të rinxve që edhe vajzat të mësojnë profesionin e mekanikut s'i kish pëlqyer të atit dhe, e dyta, s'kish besim në vete që të arrinte ta përvetësonte këtë profesion.

Këto dyshime dhe jehona që do të bënte të nesërmen ai vendim, i kallën një farë frike dhe i vinte çudi si e bëri atë hap, që dha fjalën pa marrë aprovimin e të atit. E dinte se i ati qe tallur, kur kish dëgjuar të bëhej fjalë për këtë iniciativë. Ai kish thënë:

«S'kemi parë as kemi dëgjuar që gratë të bëhen maqiniste». E Mirës iu kujtuan ato fjalë dhe e shqetësuan më fort.

«Mos vallë babai do të thotë se po i shkoj kundra? Sigurisht s'do t'i pëlqejë fare dhe do të zemërohet, edhe do të shfryjë e do të bërtasë, siç e ka zakon...» mendonte.

Psherëtiu dhe rrahu qepallat e gjata. Ishte në mëdyshje, vriste mendjen si t'ja sillte fjalën që t'ja thosh babait ashtu, butë e tërthorazi. Ç'fjalë duhej të përdorte që të mos ja ndizte gjakun? Po sikur t'i vërvitej me ato fjalët e ashpra, a do të dinte të mbrohej? Po, ajo do të qëndronte e papërkulun. S'do ta shkelte fjalën e dhënë.

Jo shumë kohë më parë babai qe zemëruar me Mirën sepse një ditë ajo ja kish kthyer fjalën, kur i kish propozuar për fejesë. Zemërimi i tij kish arrijtur kulum, por vajza s'kish pranuar dhe ja kish thënë troq: «S'kam vendosur!»

Atë ditë ajo s'do ta harrojë kurrë, sepse baba Koli për të parën herë, nga ç'mbante mend Mira, e kish prishur gojën dhe e rëndoi vajzën me ca fjalë që s'shkruhen. Që atëherë ai është ftohur shumë dhe s'e shikon kurrë në sy. Por ai ashtu ka qenë edhe më parë, i vrazhdë e fjalëpaktë jo vetëm me të bijën por edhe me të shoqen, nënë Marinën.

Baba Koli do ta mbajë veten burrë si qëmoti, që fjala të mos i përfilitet dhe hieja e tij ta sundojë shtëpinë edhe kur ai të mos jetë aty. S'është për t'u habitur me atë njeri edhe pse gratë s'i peshon fare. Ç'rëndësi kanë ato, ç'mund të bëjnë më tepër se sa të gatujnë e të rritin fëmijë? Ashtu kanë bërë të gjitha e s'kanë humbur gjë. Sipas mendjes së tij ashtu, është nisur bota. Burri në vendin e vet dhe gruaja në të sajin. Kapërximi i këtij caku ka diçka që s'vete, që s'puqet, që s'hahet! Shpesh bluan me atë mendjen e tij të varfër e s'arrin të shikojë asgjë të re.

Këtë mendje ka baba Koli. Këtë ja dinë çupa dhe gruaja, ja dinë djemtë e shokët e punës, por e keqja është se këta të fundit s'ja venë veshin, s'përzihen në punët e tij, se e dinë që është e kotë të harxhosh frymën. Koli, si ajo mushka kokëshkretë, s'pranon këshillë as mendje. Ai mendon se deri sa është punëtor i shquar dhe zanatçi që s'e ka shokun, s'ka nevojë të mësojë nga të tjerët. Pas asaj që ndodhi atë ditë me të bijën, i kanë lindur në kokë lloj-lloj pandehmash. S'e tret dot kundërshtimin ai. Dhe kush ja ktheu fjalën pa? Vajza, Mira e tij, e fundmja e fëmijëve, ajo që i kish buzët ende me qumësht.

Ajo ngjarje qe një e papritur. Ai s'kish mundur t'ja mbushte mendjen. Pastaj, si mund ta bënte një gjë të tillë? S'i kish ndodhur ndonjëherë që t'i zgjidhte

punët e veta me të këmbyer mendime. Ato që thosh ai s'kish nevojë t'i gjykoje, sepse «fjalët e plakut janë si ujët e kulluar, që e pi pa merak», mendonte.

Por ai qe zemëruar edhe me gruan. Edhe ajo kish ngritur kokë, i kish dalë krah çupës dhe i kish thënë:

«Mbaj gojën, burrë, se s'të ka ndonjë faj çupa, as ka bërë ndonjë paudhësi që po e gojos kështu.»

Eh, ku kish arrijtur Koli! I kish vënë fre gruaja, po ai s'e duronte atë fre dhe hante mëgojzën me dhëmbë si ai mëzi i pastërvitur.

* * *

Mira u kthye në shtëpi si zakonisht para të atit. Nënës ja tha ç'kish vendosur dhe i kërkoi mendje në kish bërë mirë apo keq. Dhe nëna Marinë, që s'dinte kurrë t'ja thyente zemrën çupës, e mori përsipër t'ja thosh vetë të shoqit. Mira nuk deshi aspak.

— Unë vendosa, nënë — i tha ajo — përse të mos ja them vetë? E kam marrë parasysh... Le të thotë ç'të dojë, le të tallet, le të flasë. Tanimë u mësuam me romuzet e tij. Të falemnderit ty, që gjithmonë më përkrah. Do t'iu shkruaj edhe vëllezërve e jam e bindur se edhe ata do ta pëlqejnë këtë vendimin tim. Eh, sikur të ishin këtu, do t'i kishim krahë.

— Ata s'kanë mendjen e babait, janë tjetër soj, moj bijë.

Nëna Marinë fshiu një lot me cepin e mësallës dhe hodhi sytë nga fotografitë e djemvë, që ishin mbi oxhak. Pastaj shkoi pëllëmbën mbi xhamin e portretave, fshiu pluhurin dhe, e përgjëruar nga malli, pëshpëriti:

— Pëllumbat e nënës!

Sa dëshirë kish Mira në atë çast të kish ndonjë nga të vëllezërit. Ata e donin pa masë motrën e vëtme, por ishin larg. Vala e jetës i kish shpërndarë në qytete të ndryshme. Koçoja, i madhi, punonte në uzinën e plehrave në Fier prej pesë muajsh. Tirkë i kish

mbushur dy muaj në Bulqizë dhe Pavlloja qe ushtar. Familja qe ndarë më dysh. Tre andej e tre këtej.

Duke vështruar fotografitë e të vëllezërve, Mira e çoi mendjen larg, te ato qytete të panjohura, dhe pér disa çaste përfytyroi të vëllezrit. Ajo nuk lëshoi lot si nëna, se ishte më e mbajtur, por e ndjeu veten aq të përmalluar sa kurrë ndonjëherë.

Ashtu e kredhur në mendime, kujtoi atë ditë kur Tirka u bë shofer.

Nata po zbriste si me drojtje. Përtej xhamet të drifares dukeshin yjtë. Ata yj sikur dridheshin para syve të Mirës që i vështronte me vërejtje. Nga larg vinte një zhurmë e mybutur motori që bënte të dridheshin xhamet. Po ç'ish ajo rrapëllimë? Sa fort i ngjante uturimës së kamionit të Tirkës! Tamam ajo zhurmë qe. I kukohej mirë, kur pér të parën herë e pa Tirkën në timon. Ai, duke shkelur rregullat e qarkullimit, e kish sjellë maqinën mu përpara portës së shtëpisë që t'ja shihnin. I kish kërkuar së ëmës ca perde e ua kish vënë xhameve menjëherë. Ish merakli Tirka e donte që kabina e maqinës t'i shëmbëllente një dhome. Pastaj qe zhdukur shpejt, duke lënë prapa tymin e karburantit dhe uturimën e motorit.

Ja, edhe tani po ajo uturimë motori, po ajo «këngë». Mos ishte ndonjë si Tirka që po shkelte rregullat?... Apo mos ishte ai! Dhe Mira brofi, por maqina qe larguar e s'dëgjohej më.

Në atë çast hyri baba Koli. Mira i doli përpara si ngaherë dhe me buzë në gaz i tha:

— U regjistrova baba!

— Cfarë bëre?

— U regjistrova në kursin pér tornitore!

Ai, pa ngritur sytë, bëri dy hapa përpara. Fytyra e rrahuar nga dielli, që i kish marrë ngjyrën e bronxit, iu përkuq edhe më. Trupi i gjatë e i hajthëm sikur iu përkul. Plaku u step. Ishte ndezur.

— Po kë pyete?

— U muar vendim në organizatën e rinisë...

- Moj, përgjegju këtu ç'të them unë!
- Po ç'të keqe ka këtu, baba? Unë kam dëshirë, dua të mësoj zanat... Edhe unë kam të drejtë!
- Të drejtë, ë? Të qenka hapur goja; po ta dish se kjo punë s'është për ty. S'bëjnë tërë Mizat mjaltë.
- Po të kesh vullnet, mund të bësh çdo gjë. Ka plot shembuj, baba. Gazetat e revistat flasin gjithnjë.
- Ç'po më shastis, moj?
- Ke për të parë, baba, unë kam besim... Do të bëhem tornitore!

Mira e ndjeu vetën shumë të lehtesar me ato që i tha të atit. Donte të fliste edhe më, por ai u hoq mënjnë i inatosur dhe Mira e kuptoi se e mbylli me aq. Edhe shumë fjalë kish këmbyer, sepse më tepër s'liste ai. Pastaj mbyllej në vetvete dhe e trette kohën në heshtje, duke tymosur e duke numëruar tespijet. Ashtu i menduar dhe i mvrejtur, të dukej sikur kushedi ç'halle e kishin zënë. Kur binte në mendime edhe gratë s'happnin gojë, po zinin punët e dorës. Dhe shtëpia binte në heshtje. Që kur se kishin ikur djemtë, s'kish biseda as shakara në atë shtëpi, se plaku ish nemitur. Me ata të paktën këmbente ngadonjë fjalë, ndërsa me gratë s'i hahej fare muhabeti.

* * *

Atë natë baba Koli s'vuri gjumë në sy. Puna e vajzës e kish shqetesar fort. Ish pikë 'e vrer e s'u jepte dot udhë mendimeve. Ç'të bënte, ta hiqte nga puna? Ashtu do ta kish mendjen të fjetur. Po kjo ish-punë që s'bëhej. Të paktën të vendoste të martohej. Kjo do të qe puna më e pëlqyer dhe me burrin le të bënte ç'të donte. Por të tjera gjëra kish në mendje ai, të tjera çupa. Kolit i qe tiposur në kokë se Mira s'mund të bëhej kurrë maqiniste, ajo mund të bëhej fare kollaj nënë, sepse dhëndri ish gati dhe priste vetëm fjalën!

Kaluan ditë. Mira i ishte përveshur punës me mish e me shpirt. Ajo e tëra ishte lidhur ngushtë me maqinën

e «çuditshme» plot mekanizma, leva e rrota, të cilat, sa herë i prekte me dorë aq drithërima i përçonin në trup.

Në shtëpi ka ngritur një raft e po krijon bibliotekën përsionale. Sa gjë e çuditshme për atë shtëpi. Mira e ndjen veten të kënaqur, sepse i duket sikur ka plotësuar një boshllék të madh. Tani edhe ajo po thith ajrin e jetës së re, edhe ajo po mëson e përpiqet të bëhet diçka, të bëhet tornitore, që të pradhøjë detalet.

Sapo kthehet nga puna, ulet dhe studjon. Baba Koli e gjeti atë të ulur në tavolinën e bukës. Ish kredhur në libra dhe nuk e ndjeu fare të atin; veç kur ai u afrua, ajo brofi më këmbë e u bë lulëkuqe në fytyrë.

— Më fal, baba, s'të ndjeva fare.

— E shikoj, moj çupë, që po të ikin mendtë fare; se ç'të ka zënë me këto kartëra as unë s'e di!

— Dua ta mësoj mirë zanatin, baba.

— Moj, ç'po më përrallis ti, s'kemi dëgjuar që u mësoka zanati me libra... Nga na duallt ju kështu?

— Që të bëhesh tornitore, duhet dituri, baba, të dish të bësh edhe llogari, të njo'hesh vizatimet dhe figurat e sendeve të cilat dhe të dish t'i vizatosh.

— Po ç'do të bëhesh ti, moj çupë?

— Tornitore... Po ja se ti ndofta s'e kupton.

Dhe Mira i afrohet të atit me libër në dorë dhe i kallëzon. Ai, me sy të mjegulluar, vështron figurat e «pakuptueshme» dhe mbledh buzët.

U hëngërka hekuri me thikë! — pëshpëriti me vete. — S'më hyjnë në kokë këto llafe mua, s'i kam dëgjuar ndonjëherë. Mos kanë dalë tani këto?

Mira fërgëllon e gjëzuar. S'mbahet mend që i ati të ketë folur ndonjëherë barabar me çupën si këtë radhë. Prandaj nuk di si t'i gjëzohet butësisë dhe vëmendjes së papritur që po tregon ky burrë i vrashdë e fjalëpaktë. Çudi si është kjo kthesë! Nga kish ardhur ky ndryshim? Mos gjuha e çiltër dhe e rrjedhshme e vajzës e kish mposhtur mendjen e ngushtë të atij muratori të vjetër, që s'kish parë kurrë larg vetes? Apo mos pleqëria e

kish lodjur e ja kish zbutur zemrën? Kish disa ditë që Mira e kish vënë re këtë ndryshim, por këtë herë ajo ish bindur se babai kish bërë kthesë. Ai dukej tjetër njeri.

— Duhet të mësoj, baba; ti e di, unë s'kam ndonjë shkollë kushedi çfarë.

Plaku, i trullosur e gojëqepur, rrrotulloi shikimin mbi të bijën, tundi kokën si pa ndonjë qëllim e, pasi shkriftoi zérin, tha:

— Pse, xhanëm, s'të sos ajo shkollë ty? Se mos tët vëllezër kanë mësuar më shumë? Shtëpia jonë s'ka nxjerrë të mësuar. Dardha nén dardhë e njeriu sipas sojit. Mua gjene më duket si çudi që të bëhesh maginiste...

— Kam besim, baba, i kam të gjitha mundësitë, prandaj do të bëhem patjetër.

Ai, me një tok dyshime dhe i hutuar, vështron vëngër dhe kapërdihet.

Mirës iu kujtua se si babai atë ditë i kërkoi të fejohet, si ajo e kish kundërshtuar, si i kish bërtitur ai. Si pastaj natën vonë qe ngritur nga shtrati e qe gdhirë në dritare nga që s'e merrte gjumi. Padashur kish dëgjuar çflisnin në dhomën tjetër. Ish larguar nga porta që të mos dëgjonte, sepse i dukej sikur përgjonte, por edhe ashtu fjalët i vinin në vesh dhe e thernin në zemër.

— Është në mes të djemurisë e të burrave të botës — i thoshte nënë Marinës.

— Çupa është e vogël, burrë.

— E vogël s'është, po mbushja mendjen se mblesët po na trokasim në derë e s'bën t'ua shtyjmë llafin me sot me nesër.

Ç'llaf, ore, — kish këcyer ajo — ne s'kemi vendosur gjë.

— E po të vendosim, moj Marinë, ta martojmë sa pa i dalë ndonjë llaf.

— Ma hëngre shpirtin, o ditëzi... Po s'kemi çupë të tillë që t'iu tundë bishtin djemve. As eëma s'e ka

tundur, po ty të duken të gjithë të ligj. Po të qe asisoj, ore burrëziu, do të qe molepsur e do të qe shthurrur dynjaja, s'do të kish pritur zotrinë tënde që t'ja rrëfeje punët.

— Eh, moj gojësprijë, ç'do të ma marrësh më qafë çupën.

— Tashti më çudite, e vulose! Pse, ore, ti e dashke më shumë se unë?

— E po si thua ti, moj mendjesqojtur?

— Ta kam thënë: ajo sa hyri në zanat, do të bëhet zonjë e vetes që, kur të vejë te burri, të mos presë rrogën e tij. Paq e ka çupa. Ndërruan vaktet, burrë, jo si në të ritë tonë!

Ai qe xhindosur, e kish nëmür:

— Bosh, s'merrem vesh me gratë unë, se këto tē mbytin që i mbyttë djalli. Eh djemtë, atyre u qan hallin e merresh vesh.

Duke kujtuar atë ngjarje tē shkuar e duke parë sytë e babait që s'i kish parë kurrë drejtpërdrejt, habitet! «Vërtet paska ndryshuar!»

Shikimi i saj ka mbetur mbi babanë e pret çastin tē zërë fjalën që mbeti në mes, por ai ka rënë përsëri në atë heshtjen e tij.

Kësaj radhe, ai e kish dëgjuar me një farë interesimi tē bijën. Ashtu si Mira me tē edhe ai habitej me çupën, me fjalët e saj e me besimin që kish në vete.

Pikërisht pas kësaj bisede, ai kish filluar ta gjykontë çupën me mendje tē shtruar.

Ishte vetëm në dhomën e zjarrit. Qe errur, por ai s'e kish ndezur dritën. Dhe në gjysmerrësirën e dhomës, me sytë tē ngulur te rafti i librave, sillte në mend ngjarjet e kohëve tē fundit, mbledhjet që qenë bërë në kolektivin e tij për emancipimin e gruas, letrat e shumta që gratë, nga tē katër anët e vendit, kishin shkruar nëpër gazeta. I kishin lënë mbresë dhe disa nga fjalët që kishin thënë në mbledhje shokët e tij.

S'ishte gjë e pakët ajo që kish bërë Rasimi. Ai e kishte thënë copë, në sytë e të gjithëve:

«Edhe unë i kam kërkuar nuses së djalit pajë e peshqeshe pér nipërit e mbesat. Ata, nga ana e nuses qenë dorëhollë, por bënë si bënë dhe e rregulluan punën, hynë në borxh e s'u turpëruan. Ama sot e kuptoj gabimin, por ashtu qenë zakonet. Lëre se pas-kemi qënë budallenj!»

Sotua, ai dhenari i dikurshëm, që tani qe bërë su-vaxhi pér kokën e suvaxhiut, edhe ai e kish bërë fora e kish thënë:

«Unë e prisha llafin me komshiun. Po a e dini se edhe ai atë mendje kishte. Kështu, o shokë, e prishëm fejesën e fëmijëve që e kishim bërë që në djep.

Vetëm Koli s'kish hapur gojë. Edhe ai kish pér të thënë, ndofta më tepër se ata, por turfullonte e ckërmittë dhëmbët sepse i dukej sikur do të përmbysej bota.

Tani që po zgjohet nga ai «gjumi i rëndë», ndjen një zbrazëtirë në shpirt, një farë neverie pér atë krye-neçësinë e tij dhe pendesë pér ato fyerjet, që i ka bërë Mirës. Ndjen një dëshirë të vetme që ta ketë çupën aty, ta vështrojë e ta përkëdhelë si atëhere kur ajo i këcente në pëqi dhe e pushtonte me ato doçkat e vokëlë e të brishta.

Ç'është e vërteta, baba Koli ka pasur një dashuri të veçantë pér çupën, por atë dashuri s'ja shfaqi kurrë, dhe askush s'ja pikasi se e ruajti në vvetvete me fanatizëm. Me kalimin e kohës edhe dashuria pér të bijën u vyshk e u tulit, se ai s'e ushqeu më. Çupa rritej e ai ftohej e largohej préj saj.

«Çupa është si qelqi» mendonte. Dhe me atë që-ndrim të vrazhdë, besonte se do t'ja mbante «frerët» ngrehur deri sa ta nxirrte nga dera. Vetëm tani që mendja i ishte kthjelluar e kuptonte marrëzinë e tij. Por s'mund ta thërriste çupën se i vinte turp nga vetja. Ishte i dërmuar. Dalëngadalë po i përtëriheshin ndjenjat, po i zgjоhej dashuria.

— Nënë! — bërtiti Mira duke hapur tejpërtej të dy kanatet e portës, dhe iu hodh në qafë duke e mbuluar me të puthura.

— Dale, moj sorkadhe, dale, moj zogë, se m'i nduke faqet!

— Do të marr kategorinë, moj nënë!

— Çfarë, moj?

— Kategorinë.

— Dale, moj kërcure, se s'po të hyj në llaf unë korba.

Mira i tregon dhe i shpjegon gjer sa e trullos fare.

— Sa e gjëzuar jam, moj nënë. E unë budallaqja kisha frikë a do të mësoja dot. Më vinte turp të punoja midis djemve, edhe babai tallej; po tani?

— Yt atë, moj bijë, se si është bërë ka ca ditë.

— Ka ndryshuar shumë.

— Po shiko, e paske vënë re?... Po siç më ka rënë era, iu kishin folur në mbledhje.

— E di, e di dhe gjëzohem pa masë që e paska kuptuar.

Nëna e vështron me kërshëri, i kënaqet zemra e i bëhet mal. Ajo ja stolis shtëpinë me të gjithë ato bukuri, që vetëm syri e zemra e nënës di t'i shikojë e t'i ndjejë. Dhe tek e vështron dhe ja përgjon ato nishanet e vajzërisë, që i spikatin aq hijshëm, mendon se tani i ka ardhur koha për t'ja përbushur dëshirën edhe babait. Por ai mendim sësi e tronditi. Mira e vuri re dhe e pushtoi nënën:

— Ç'ke nënë, ç'mendon ashtu?

Nëna u kap ngushtë e s'diti t'ja fshehë mendimin. Sytë e Mirës e vështronin ngultas dhe në ata sy të kthjellët e plot drithë, nëna vështronte një botë të tërë, plot shprehje të ëmbla që i jepnin zemër e i ngjallnin dëshirën për të ditur diçka intime. Dhe i pëshpëriti:

— Tashi, moj bijë, duhet të gjëzosh edhe tët

atë dhe vëllezërit e tu. Edhe mua ma do zemra
të të shoh me burrë e të të gëzoj si nuse.

— Edhe ajo do të bëhet, por jo me mblesëri!

— Në e ke zgjedhur, moj bijë e nënës, e në të
është mbushur mendja, unë do të të puth në ballë.
Mira u drodh, uli kapakët e syve dhe pushtoi
nënën.

NË KODRAT E PRAPANIKUT

Vjeshta ka ardhur me shira të furishme. Fryni erë dhe bën ftohtë. Shkumbini është fryrë dhe turbulluar aq tepër sa, kur e vështron që sipër maleve, të duket si një re e murme dhe e dendur që ecën me përtim. Valët e ujit shkumëzojnë, përplasen pas shkëmbinjve, kthehen pas, ngrihen sipër si flatra e shuhën në ujë. Uji gërryen pa mëshirë copa dheu, të cilat, pasi qëndrojnë një çast mbi ujë, thërmohen shpejt e zhduken duke lënë një vragë të turbullt e të trashë llumi. Rrëketë sjellin me vete shkurre bushi, copa degësh e trungje të kalbur.

Lumi zhaurin dhe poterja e ujit herë vjen si një bubullimë apo gjëmim i largët, herë sikur shpërthen stuhia. E atje poshtë në grykë bëhet edhe më e thekshme jehona e kësaj rrapëllime.

Buzë lumi stuhia të than. Nata është e errët pus. Heshtja zotëron. Diku tej kollitet xha Suloja. Duket do ta ketë ndezur fshehurazi. S'rri dot pa duhan ai njeri, këtë e thotë edhe vetë: «Pa bukë bëj si bëj, pa duhan e kam zor!» E si plak që është s'mbetet kurrë pa duhan se të gjithë i japin. Si më i moqmë që është e kanë mbi krye e sipër.

Ai është burrë rrreth të pesëdhjetave, dhe më i vjetri në brigadë, por me këmbë aq të forta sa s'lodhet kurrë. Bari tërë jetën, i rritur maleve e pyjeve, ka fituar një shkathtësi që të habit. Edhe nga sytë si shkabë shikon; dëgjon dhe zhurmën më të lehtë edhe këmbët

e kuajve i dallon sakaq; i vë veshin tokës dhe ja pret aty pér aty: «Seç ndjej, o djema.»

Në çetë erdhi analfabet, si mijëra të tjerë, por tani ka filluar të shkruajë. «Ec e të matet agaj me mua tani-thotë. Një blok të vogël që ja ka falur Agroni e ka mbushur me fjalët: Parti, mëmëdhe, flamur, pushkë, liri e shumë të tjera. Mjafton të shkruajë. Kjo është një dëshirë e zjarrtë pér të. Vetëm emrin «aga» s'e ka shkruar. Këtë emër as që do t'ja kujtosh e ta dëgjojë e jo më ta shkruajë, e nëse ja kujton kush, shtrëngon dhëmbët e mbledh grushtin. Prej më shumë se tridhjetë vjet ka derdhur djersën pér të dhe në tërë ata vjet një fjalë të mirë s'e dëgjoi nga goja e tij.

«Kur u martova, gjoja më taksi dy milorë, por edhe ata m'i zuri në hesap. Gjithnjë i kisha borxh rezilit» — thosh kur e shponte ndonjeri.

Kur doli Reshitit me çetën e tij, xha Suloja u bë udhërrëfyesi i tyre, dhe agai, më ta marrë vesh, e përzuri. Atëhere i tha Reshitit:

«Shkruam edhe mua në defterin tënd, o vëlla.

E që atë ditë, xha Suloja qëndron në ballë të kolonave partizane, duke i udhëhequr nëpër ato shtigje e rripa që vetëm ai i di. Këtë natë ka zgjedhur vendin pér të hedhur këtë lumë të inatosur. Jep e merr me komandantin e me zbuluesit e zgjedh djemtë më të shëndoshë pér t'i hedhur të parët në lumë. Befas, në errësirën e thellë, spikati një dritë e largët. Pas pak një raketë jeshile u ngrit në qiellin e zi e ra thellë në perëndim nga ana e Labinotit. Gjermanët po jepnin sinjale. Komandanti dha parullën.

Qetësia po prishet. Po ndjehen çapitje këmbësh. Stuhia fërshëllen dhe ja, poshtë në lumë, u zhyt deri në brez xha Suloja. Pas tij ecën komandanti, Lia, Agroni, Stavri, Xhuzepeja, një kalabrez, që ka braktisur ushtrinë e këmishëzëzve, dhe të tjerë me radhë.

Uji është i ftohtë e të ther mishtë. Rryma e fortë të godet ashpër. Thellësia ndërron vende-vende, e zalli e tina e bën edhe më të vështirë këtë kapérkim. Parti-

zanët ecin ngadalë përballë rrymës e çajnë valët e egërsuara herë me kraharon, herë me bark e herë me gjunjë. Dhe ja, më në fund thellësia deri në grykë. Partizanët, të zënë dorë për dore, bëjnë një vijë të gjatë si një zinxhir prej mishi, që përleshet me këto valë tekanjoze e të rrepta. Komandanti u jep zemër njerëzve duke tundur grushtin në erë:

— Më shpejt, shokë!

Xha Suloja doli në stere, pas tij edhe komandanti e të tjerët.

— Hapni sytë, shokë, — tha komandanti.

Xha Suloja me Agronin bënë përpjetë përroit. Uji iu llokoçit nëpër këpucët, teshat u kullojnë, po askush s'e ndjen, se edhe shiu derdhet me rrëmbim mbi ta. Në errësirën e thellë s'mund të dallosh asgjë. Zbuluesit ecin pranë njëri-tjetrit duke gulçuar në të përpjetën thikë që s'ka të sosur. Kur dolëm në qafë, xha Suloja mbështeti veshin në tokën e lagur e të ftohtë; një copë herë përgjoi, pastaj ngriti kokën e pëshpëriti:

— Dëgjoj këmbë... do të janë të dytët pas ne.

Ashtu doli. Siluetat e të porsaardhurve rrëshqitën në qafë.

— Gjer këtu, o djema, vajti puna mirë. — Prishi heshtjen xha Suloja. — Tani do të rrahim anës së bregut e do të mbajmë krahun e djathë. Më të majtë janë rojet. Njërit do t'i kalojmë mu përpara hundës, andaj bëni sytë katër.

Bunkeri i nëndheshëm me gungë si samar breshke e me frengji si gojë bretkose, nëpër të cilën del tyta e një mitralozi, përgjon shtigjet e kodrat përreth. Ushtari, që është struktur brenda, ngul synë në frengjinë e ftohtë, por errësira e natës ja mund shikimin, shushurima e shiut edhe rëketë, që derdhen pa kursim, ja vështirësojnë dëgjimin e ai as shquan e as i ndjen capet e partizanëve njëqind hapa më lart. Kështu të gjithë partizanët, njëri pas tjetrit, kaluan si në rivistë përpara samarit të breshkës.

* * *

Ndërsa dita po zbon natën, kompania po zë vend në kodrat pranë Xibrakës e Labinotit, mbi rrugën automobilistike. Shiu ka pushuar, por të gjithë janë të qullur deri në kockë. Po bie mjegull. Përbri xhadesë dallgëzon Shkumbini e mbas tij ngrihet, si kon, një mal i gjelbërt i veshur në bush. Përballë duket kryet e një shkëmbi të bardhë, që zbret edhe ky thikë deri në xhade. Panoramë e rreptë, me gërxhe vezullonjëse, me mjegull të dendur e ajër të lagët. Thëllimi i mën-gjezit vjeshtak të pickon lëkurën. Bën ftohtë.

Partizanët rregullojnë pozicionet. Komandanti biseton me zbuluesit:

— Duhet të dimë q'bëjnë gjermanët atje poshtë. Zbuloni vendin, shtigjet. Kini kujdes mos bini në pritë. Armiku s'duhet të diktojë asgjë, ndryshe do të na hapë luftë i pari. Udhë të mbarë, shokë! Kthehuni shpejt!

Zbuluesit fluturuan dy mënjanë e dy të tjerët në anën tjetër. Xha Suloja dhe Agroni, një partizan i ri, me automatikë në duar, po i ngjiten atij shkëmbi të bardhë. Afër majës zunë të kacavirren. Shkëmbi i bardhë është rripa-rripa e i mprehtë. Një skifter u ngrit me rrëmbim nga shkëmbi. Zbuluesit u qepën pas gurit. Kishin mbrijtur në majë.

Poshtë shtrihet lugina. Copa mjegulle kanë mbetur pezull në ajër si pupla të përhime; fshati, xhadeja e lumi zbardhin. Lumi ndahet dysh në një vend e rripi i zalltë, që hyn si pykë në lumë, zbardh edhe ai. Buzës së ludit, në mes të rrepeve, vetëtinë xhamet e kamioneve, nxijnë autoblindat e tankset. Duken kuaj, karro e ushtarë. Ja edhe ura.

— Qenka ushtri e madhe.

— Paskan edhe tankse.

— Oj! pa vështro, more djalë, q'janë ata andej.

Një kolonë ushtarësh u duk në të përpjetën e përroit që të shpie në katundin Prapanik.

— S'duhet humbur kohë, xha Sulo. Po nisem!

— Nisu, bir, erë bëhu.

Xha Suloja ndoqi me sy Agronin.

«Duhet të arrijë përpara tyre, sa më parë që të jetë e mundur. Popo, sikur të mos arrij dot, do të goditen në befasi... do të dështojë tërë plani! Po pastaj? Si do t'iu dal përpara shokëve?... Do të kem ftyrë...»

Me këto mendime arrihti te shokët. I mbytur në djersë e duke fërgëlluar, njoftoi komandantin:

— Një skuadër partizanësh, me komandantin e saj në krye, u nis t'u presë udhën gjermanëve. — Agroni i tregon komandantit c'kish parë në lugine, sesi sapo skuadra mbriti në fshat, u nda në dy grupe. Një grup qëndroi në mbrojtje të fshatit dhe i dyti, me komandantin dhe Agronin, doli përpara në drejtim të përroit dhe zuri vend në ca lisnikë.

— Këtej po ngjiten? — pyeti komandanti.

— Po.

— Janë shumë?

— Nuk i numërova, por ishin majft.

* * *

Armiku kishte rënë në gjurmat e partizanëve dhe po merrte masa mbrojtëse. Autokolonat, që do të kalonin matanë, duhej të siguroheshin nga goditjet e parritura apo nga pritat e natës. Këtyre të fundit jau kishin frikën shumë, u ruheshin si djalli temjanit dhe ishin gati të sakrifikonin edhe ushtarë, mjafton që autokolonat të kalonin përtëj, të paprekura e të mbërrinin sa më parë në Tiranë.

Komanda partizane kishte informata, se kamionët ishin ngarkuar me armatime dhe municion dhe kish marrë urdhër të prerë që asnjë maqinë të mos dilte që nga lugina e Xibrakës.

Hanjharët po mpreheshin me nxitim, beteja po trokiste në derë, hija e vdekjes po u sillej mbi kokë

armiqve. Dhe ata e dinin se pushka do të kërciste e ashpër dhe tymi e flaka do të merrnin qiellin. Ashtu e kishin pësuar në Qaf Thanë, te ura e Pishkashit dhe te ura e Murashit. Dhe ishin po këta partizanë që iu kishin dhënë dërmën sa e sa herë dhe që tani po i ndiqnin këmba-këmbës, për t'i shfarosur një e nga një.

Në pozicionet po ndajnë ushqimin.

Komisari sapo është kthyer nga shtabi i batalionit. Edhe ai kallon ujë. Ka zhveshur setrën dhe po e shtrydh pranë zjarrit. Dy zbulues, Stavri me Xhuzezen, janë kthyer nga zbulimi e po bisedojnë me komisarin. Kanë zbuluar tre bunkerë të maskuar me degë dushku dhe një përrua, që zbret drejt e në xhade.

— Përroi ngjan si vijë e një llogoreje dhe është mjaft i thepisur — tregon Xhuzepeja.

— Kalohet?

— Pak vështirë, por mund të kalohet.

* * *

Është i çuditshëm ky Xhuzepeja. Njeri i dashur, i qeshur, zemërgjérë, i rreptë, i paepur e shpeshherë edhe i egër! Kur e kishin thirrur nën armë, për një fjalë ish përleshur me kapterin e zyrës ushtarake dhe ky i fundit e kish ndëshkuar duke e nisur fill e në Shqipëri. As i bëri tër veshi Xhuzepe, por kur e puthi e éma dhe të motrat, qau edhe vetë. Ende i kujton fjalët e s'ëmës:

«Sillu mirë, bir. Shqiptarët nuk janë të egër, siç i quajnë këtu, janë të varfër, por trima e bujarë. Jemi të një gjaku me ta, atje prehen kockat e stërgjyshëve tanë.»

E këto fjalë sikur i dëgjon sërisht, të émbla e të buta si vetë e éma, ndaj shpirti i tij zemërak u zbut e u përmallua.

Bariu plak s'hapi gojë, por hodhi sytë nga zjarri

e ngjeshi kapën, siç bënte sa herë që pregetitej përtë marrë udhë. Bisedës i dha fund komandanti, i cili urdhëroi të shuhet zjarri e secili të zërë vendin e vet.

Partizanët e kanë marrë veten; janë terur, ngrohur e kanë marrë nga një sy gjumë. Disa po pinë duhan,

Natë. Qielli është mbushur prush me yj. Bariu plak shtrëngon rripin e mbush xhepet me granata. Xhuzepeja dhe Stavri po radhisin nga pesë karikatorë në çantë kurse Lia, të cilin po e ndihmon edhe Agroni, po zbras xhepet e çantën nga gjithë sendet personale, e në vend të tyre po vë karikatorë të rëndë mitralozi. Edhe të tjerë po pregetiten. Asnjë fjalë s'dëgjohet, veç zhurmës metalike të armëve.

Dy skuadra muarën udhë.

— Udhë mbarë, shokë! — u dëgjua një zë.

— Faqebardhë — u dëgjua një tjetër.

Kolonën e udhëheq kundraxhiu, Stavri me Xhuze-pen.

«Lepuri... Luani» pasoi parulla.

Zhurma e çapeve dhe e gurëve po prish qetësinë e përroit të thatë. Atje ku është shumë pjerrët, rrrokullima e gurëve bën potere dhe jehon deri poshtë në lumë. E sa herë që gurët rrrokullisen poshtë, kolona ndal marshimin dhe vihet në lëvizje vetëm kur shuhet jehona. Tatëpjeta e përroit duket sikur s'ka të mbaruar. Dëgjohet shushurima e lumit. Kur kolona arriu buzë rrugës së automobilit, atje në luginen e Xibrakës ungrit një raketë jeshile, e cila, pasi bëri kurbën, ra e u shua në lumë. Partizanët ngrenë pritën.

Rruga, që shtrihet përpëra, del me një bërryl pas shkëmbit, bën një si «S», mandej zgjatet e drejtë. Ndonëse është natë, xhadeja zbardh, kurse mali në trajtë koni nxin si korb.

Heshtje. Të gjithë presin. Komandanti përpinqet të shquajë orën e, më më fund, pasi bën dritë me eshkë, mezi i dallon agrepët, që shënonin njëzet e një e tri-dhjetë e pesë.

Edhe një raketë e kuqe çau qiellin nga ana e Labinotit.

— Tani do të fillojnë — tha komandanti.

Xha Suloja ja kish vënë veshin tokës e po përgjonte.

— Zhurmë — pëshpëriti.

Shkuma e bardhë e valëve vezullon në lumë, udha shquhet edhe më. Ca yj sikur janë ulur fare poshtë e japidritë. Një zhurmë e thellë motorësh po e mbush dalëngadalë luginën. S'vonoj shumë dhe ja, pas bërryLit, u duk figura e zezë e një autoblinde. Pasuan fjalët:

— Hapni zjarr menjéherë pas mitralozit!... Mos lini të kalojë asnjë!

Autoblinda angullin si një qen i urtuar. Ja edhe kamionët.

— Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë — numëron Agroni.

Pas kamionit ecën një autoblindë tjetër. Vjen erë karburanti të djegur. Kolona po hyn në pritë. Partizanët kanë hequr sigurecat e armëve e po presin me gishtin në këmbëza.

— Zjarr!

Gjëma e krismave ushëton. Batareja e fuqishme e paralizon për një çast armikun. Në xhade po bëhet rrëmujë, Lia po ndërron karikatorin.

— Ha, ha — u bërtet ushtarëve.

Xha Suloja, gati më këmbë, iu dërgon fashistëve breshëri të gjata. «Opelat» kanë qëndruar ndërsa autoblindat po shtihen me tërbim. Edhe «kërri» i automatikëve armiq filloi i ashpër. Lufta u ndez. Të dy palët qëllojnë rëndë. Flaka mbulon kamionin e dytë e të pestë dhe ndriçon natën. Pastaj gjëmoi një plasje; edhe një e një e tretë. Në krahun e djathëtë autoblinda heshti.

— Në sulm, shokë! — thirri komandanti.

Krisma të rrepta e plasje bubullonjëse u ngriten lart në qiell. Ushtarët rezistojnë e klithin nga tmerri. Një zë i çjerrë bërtet:

— Partizan... Kaput partizan!

E xha Suloja e zbraz mbi të mashinkën. Gjermani

u lëkund, klithi edhe më fort e ra mbi bark. Opeli i fundit lufton egërsisht me Xhuzezen e Agronin, të cilët kanë bërë mjart përpëra, por gjermanët i sulmojnë dhe zbrasin mbi ta një dyzinë bomba. Toka, që u shkallmua e gurët, që fluturuan në erë, ranë me tërsëllëm mbi partizanët, gjëmimi i mbuloi krismat e sikur i përpjui me vete dhe një çast u bë një heshtje e shkurtër, që të bënte të besoje se gjithshka kish marë fund. Tymi i barotit ngrihet lart i hidhur e i zi, e toka e thërmuar e përgjakur dhe e nxeh të përhap erën e ngjethshme të mishit.

Nga shpërthimi Agroni e Xhuzepeja u futën në dhe e dolën që andej sakaq, të shqyter, të përzhitur, të nxirë e të hallakatur si mos më keq, e, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, iu qepën kamionit të fundit.

Flaka shpërthen, zgjat gjuhët lart, lëpin qiellin e bën dritë të madhe në rrugë e në lumë. Dhe në dritën e zjarrit duket rropatja e ushtarëve të fundit. Njëri rrëshqet më brinjë drejt lumit e tjeter gjerryen tokën me thonj, ngjishet pas saj e shket si gjarpër që të futet në errësirë. Por tani është tepër vonë. Agroni zbras dy breshëri të shkurtëra. Këto janë të shtënat e fundit.

Tani askush nuk zbras. Dëgjohet vetëm kërcëllitja e dërrasave që po i përpin zjarri.

Xhadeja llamburit. Era e gomave të djegura po e mbush ajrin. Në ujet e lumen pasqyrohet një grumbull karakatinash të cilave tymi u jep trajta të shumëlllojshme e të paqëndrueshme. Partizanët mbledhin armët e municionin, dikush numëron të vrarët, një tjetër mundohet të shkulë një gomë të padjegur për shoje opingash.

Fillon tërheqja. Në krye të kolonës ecin të plagosurit. Janë katër veta. Bariu plak, i ngarkuar rëndë me armë e municione, ecën pranë të plagosurve e u jep zemër.

Flaka poshtë po bëhet edhe më e furishme. Tymi i zi, më i zi se nata, shquhet në errësirë shtëllunga — shtëllunga. Partizanët ngjiten me duar e këmbë në të

përpjetën e përroit që të merr frymën. Disa çaste s'u dëgjua asnjë pëshpëritje se lodhja i kish hallakatur njërexit, kur në këtë heshtje ja shkrepri krisma e mortajës. Predhat filluan të pëlcasin larg, por, pak më vonë, sikur t'i hidhte njeri me dorë, zunë të pëlcasin pranë përroit.

— Më shpejt, shokë! — pasoi fjala.

Predhat bien si breshër. Shkrepat e malit po cotohen e tymi i athët të ze frymën.

Janka, infermierja e shkurtër, topolake e shumë e shkathët, ja filloi punës e, me ndihmën e Xhuzepe, brenda një gjysmë ore u pastroi e u lidhi plagët të plagosurve.

— Intendanti s'është kthyer? — pyeti njëri infermieren.

— Jo!

— Duket se s'do të kemi gjë për të ngrënë...

Qetësi e thellë. Partizanët flenë të ngjeshur pas njëri-tjetrit. Rojet përgjojnë pak më poshtë. Bën ftohtë.

Qielli ka marrë një ngjyrë plumbi të çelët. Frynerë e lehtë, e ftohtë dhe e lagët. Poshtë në luginë coparë të përhime zbresin me plogështi, ndërsa, thellë nga Dumreja, një copë qiell i kthjellët shkëlqen me një ngjyrë të kaltërt të bukur. Partizanët gërmojnë tokën, ngrenë gurë dhe e maskojnë me gjerdhe e bush. Dita ka hapur fare. Askush nuk flet. Të gjithë punojnë. Secili bën vendin përvete, bën llogoren e luftës që pritet të fillojë.

Armiku do rrugë e këtë e kërkon me çdo kusht. Ai s'mund të rrijë i blokuar në luginë, andaj do që ta shtjerë në dorë këtë kodër që ku të sigurojë krahët e qarkullimit nëpër xhade. Ajri dridhet nga fërshëllimat çjerrëse të predhave, që fluturojnë në qiell. Të gjithë zenë vende. Predhat e para plasën poshtë pozicioneve. U bë tym i madh. Lia zhvendosi mitralozin e zuri një vend të mirë. Por qitja shurdhonjëse s'të lë të ngresh kokën. Toka po lërohet. Ja edhe gjermanët. Janë hapur në formacion të gjerë e presin të pushojë qitja. Pas pak pushoi mortaja dhe në çast ushtarët armiq filluan

të ngjitin kodrën. Ecin me nxitim e bëjnë zik-zake të shkurtëra. Në vijën partizane, duket se s'ka njeri. As frymë s'ndjehet.

Ndonjëri gjelltitet, ngjesh kapën gjer në sytë e merr në shenjë. Por prapset shpejt e fshin djersën e ballit. Është me të vërtetë një pritje e çuditshme, e jashtë-zakonshme. E në këto çaste sa gjëra të shkojnë në mendje, ashtu, vetëtimthi, sa kujtime e sa dëshira... Por mbi të gjitha një dëshirë është e madhe: të fitosh! Arësyjeja punon me ngulm. Dikush bëhet gati të hapë zjarr, tjetri kafshon rripin e granadës por nuk e shkul.

Armiku është afruar mjaft. E ka ndërruar formacionin e ushtarët, të ndarë në grupe prej katër deri gjashtë vetash, përparojnë me kujdes, hiqen zvarrë e përgjojnë.

Janë shumë. Edhe një herë më tepër se partizanët. Ja, në krahun e majtë, gjashtë grupe, përpara tetë e nga e djathta katër. Kjo është vija e parë. Më poshtë sigurisht do të ketë edhe të tjere.

Xha Suloja kafshon buzët dhe vështron Agronin, i cili diçka po shkruan me nxitim; pastaj i qep sytë mbi ushtarët e përsëri kthehet nga Agroni; tund kokën e pështyn tokën me inat; më në fund ja pëlcet:

— Bre, po ç'është kjo e shkruar tanë... Ptu, more lanet djalë... Po a s'i sheh, bre, që po na futen në hundë?

Agroni shkrojti edhe një radhë dhe e mbylli blokun. Lia në anën tjetër i lutej komandantit:

— Urdhër, shoku komandant.

— Edhe pak, ki durim. Sa të afrohen edhe pak, që pastaj të mos ikin dot.

Gjermanët janë fare pranë. Në fytyrat e tyre duket egërsia e frika. Një oficer me parabel në dorë ecën në krye të grupit të qendrës. Është fare pranë, një pesëmbëdhjetë — njëzet metra. I gjatë e i hollë si një shkarpë e thatë, oficeri bëhet gati të qëllojë, por mitralozi i Lias buçiti me të madhe dhe e këputi si

më dysh. Menjëherë pas Lias, hapën zjarr që tē gjithë, gati nē një kohë. Pas oficerit ranë edhe nja katér tē tjerë.

— Hajde, hajde, o trima, — bërtet xha Suloja. Breshër plumbash hedhin gjermanët.

— *Mascalzoni... Assassini*¹⁾) — këlthet Xhuzepeja.

Armiku, i egërsuar, sulmon me bomba. Po bëhet potere e madhe, tym e flakë kudo e zëra që bërtasin. Në këtë kohë kundërmësyn krahu i djathtë. Komisari nē krye tē grupit tē tij përparon e merr pozicione tē reja.

Fillon sëriish artilleria e më tepër se dhjetë minuta shpërthejnë plasje shurdhonjëse. Dy partizanë tē plagosur i heqin zvarrë e i nxjerrin jashtë vijës së parë. Nga teshat e shqyera u duket mishi i përgjakur e i përzhitur. Dhe sa vështirë është tē heqësh tē plagosurit nën këtë zjarr tē rreptë, që shpérndan si breshër copa metali tē mprehta e përvëlonjëse. Ciflat fluturojnë nē erë e ta therin mishin egërsisht.

Armiku është i vendosur ta thyejë këtë qëndresë. Kodrën e Prapanikut kërkon ta shtjerë nē dorë me çdo kusht, tē ngrejë një kordon tē fortë mbrojtjeje, që tē sigurojë lëvizjen e autokolonave. Rrugë tjetër s'ka. Forcat gjermane duhej tē kapërxenin me doemos përtet, tē shkëputeshin nga lugina e Xibrakës, ku ishin gozduar keq e mos më keq, e tē shkonin nē ndihmë tē garnizonit tē Tiranës.

Prandaj lufta sa vente po bëhej edhe më e ashpër. Ushtarët armiq dilnin si kërpudhat, hidheshin përpara por s'çanin dot.

Tërë kompania partizane qëndronte burrärisht, ndonëse lufta po zgjatte dhe ishte harxhuar mjaft munication.

«Një fishek, një ushtar!»

Dhe Lia me Xhuzezen i ka vënë fre mitralozëve tē

1) Të poshtë... vrasës (It).

tyre. Sa pér xha Sulon, atij zor t'i humbë plumbi nё erё.

— Hajde, viran, hajde.

— Nё vend numёro.

— Pérpara shokё! — dëgjohet njё zё i pafuqi-shëm.

Thërret Stavri. Ѓshtë ngritur mё gjunjё e po shtie pa pushim. Mauzeri i dridhet nё dorë, vështron drejt nё njё pikё tё vetme e thërret: «pérpara»!

— Stavri — bërtet Xhuzepeja duke i hedhur njё sy tё shpejtё.

Ai, i përgjakur, zbraz fishekët e fundit, kthen sytë e venitur nga Xhuzepeja e buzëqesh. Diçka thotë, por zëri, qё po i ikën nga çasti nё çast, s'u jep kuptim fjalëve tё fundit.

— Stavri! — pёrsërit tjetri dhe i merr nё duar kokën qё e ka lëshuar mbi gurin e përgjakur tё pozicionit.

Stavri e pa nё sy, qeshi, por s'foli dot.

Gjak i ngrohtë i rrjedh si curil nga njё vrimë qё i ka shpuar plumbi nё mushkёri. Trupi, i lëshuar, po tendoset qetë pёrtokё dhe grahma e fundit i shpëton nga goja e përgjakur.

Plasje tё tjera shpérthejnё nё krahun e majtё. Dëgjohet zëri i komandantit:

— Pérpara, o sokola!

Xhuzepeja mësyn me bomba e shan me soj e sorrët herë nё italisht herë nё shqip. Gjaku i Stavrit e ka tёrbuar fare. Ai tanë as qё mbahet e hyn thellë nё vijët armike. Pas tij rend xha Suloja e Agroni, tё cilët edhe këta po qёllojnё si tё tёrbuar. Tërë vija partizane përparon. Gjermanët vihen nё pozita mbrojtëse. Disa mitralozë kuisin sё largu, tё tjerë bëjnё njё vijë zjarri tё pakapërxyeshme.

Mbrohen me dëshpërim dhe s'duan tё shqiten nё asnje mënyrë. Kolona tё tjera po hyjnё nё luftim.

Armiku u thye. Partizanët janë zotë tё kodrës

dhe inisiativa e mësymjes, tani, ka kaluar në dorën e tyre.

Nata po zurret ngadalë.

Shiu është trashur e të godet me tërsëllëm e si me fshikull turinjve. Errësira është aq e madhe se nuk shquhet asgjë, as toka, as qëlli, as malet e asgjë. Njerëzit janë struktur nëpër pozicionet e llogoret e kanë hedhur mbi kokë copa parashutash e mushama. Janë sajuar ca lloje çadraш pa formë e me lloj-lloj ngjyra, që e presin shiun dhe i ndalin rrugën erës. Çurkat e ujit, që rrjedhin nga pëlhura, dëgjohen vazhdimiшt. Nën to, të ftohit dhe lagështia është bërë e padurueshme. Kur flakërojnë vetëtimat e fuqishme, feksin ngjyrat e çadrave; pastaj, kur bubullimat i vërviten tokës sikur të duan ta çajnë më dysh, tendat dridhen dhe çurkat e ujit shkunden e derdhen me potere nëpër pellgje.

Asnjeri nuk e shquan shokun, vetëm e ndjen se e ka pranë apo i dëgjon zërin. Disa i ka mposhtur gjumi. Lia dhe Xhuzepeja i kanë vënë kurrizin njëritjetrit dhe kanë rënë në gjumë të thellë. Mbi gurët që kanë radhitur për shtrojë, kanë hedhur degë bushi. Xha Suloja është shtrirë pranë tyre, me këmbë mbledhur e me faqen në pëllëmbë. Kurse Agroni është zgjuar. Ai dëgjon frymëmarrjen e shokëve dhe gërhijet e lehta e lëviz pa pushim, mblidhet si top në qoshe të llogores, mbështet mjekrën në kupat e gjunjëve dhe myll sytë. Por është e kotë. Ai s'ka gjumë e kjo, ndofta, i vjen nga lodhja e madhe.

Beteja i buçet ende në veshë dhe ngjarjet e ditës i kalojnë me radhë përpara syve. Një çast u përpoq t'i zbojë të gjitha mendimet, t'i largojë të gjitha ngacmimet dhe, pasi shtrëngoi kapakët e syve, zuri të numërojë. Mbështet mështet e gjumi. Por kaluan minuta, orë dhe sytë e tij s'u myllën.

Ai nuk shkëputet dot nga ngjarjet e ditës. Ato i janë ngulur në kokë, sikur e pushtojnë me krahë dhe e shtrëngojnë fort. Përfytyrimet e betejës, të vdekurit, të plagosurit, sikur i përzjehen me përfytyrime të tjera,

të largëta, që s'kanë asnë lidhje me njëri-tjetrin. Nganjëherë i faniten shokët e shkollës, sikur qesh me ta, nganjëherë i duket sikur është në atë mbledhjen e fundit, në atë dhomën përdhese të Korçës së vjetër... Ja edhe trokëllima në xham dhe zëri që i lajmëronte:

— Ikni, djema... dikush na paska spiunuar!

Dhe Agroni, duke kapérxyer kopshte dhe avlli, ish degdisur tutje dhe kish shpëtar për një qime. Atë natë nuk ish kthyer në shtëpi, por kish marrë malin përpjete e ish gdhirë në Dardhë. Atëhere kumbullat apo kishin lidhur. Dhe tani gjendej këtu, në këtë gropën e gjyles, nën tendën e parashutës. Poshtë, gjermanët e mundur.

Agroni shtriu këmbët e mpira e gogësiti me zë.

— Ç'ke kështu, more bir. — foli xha Suloja nëpër gjumë.

— Smë ze gjumi.

— Mbyll sytë e fli. Gjumi të çlodh.

Por më kot u rropat, gjumi s'e mori që s'e mori. Pas tij edhe bariu zuri të shtrijë e të shpijë këmbët e krahët; pastaj drodhi cigaren e shkrepi masatin. Xixat e gurit shkëlqyen e feksën si vetëtima të largëta. Agroni vështron zjarrin e cigares dhe nëpër dritën e vogël që bën ky zjarr, shquan majat e gishtérinje të verdhë të plakut.

Ndaj të gdhirë mezi e mundi gjumi. Atëhere njerëzit zunë të lëviznin, të ngrinin kokën e të delnin jashtë llogoreve. Shiu kish pushuar dhe për çudi qelli ish pastruar e qëruar aq mirë sa s'kish qenë kurrë ndonjëherë në ata muajt e fundit.

Dielli dalngadalë po ngrihej lart, kurse armiku ende s'po lëvizte. Xha Suloja kish dalë jashtë pozicioni dhe po ngrohej në diell.

SHOKË LUFTE

Pirrua e di mirë që tetari është një njeri tepër i mbyllur, që nuk flet me cilindo e u ruhet shumë ushtarëve, por e di gjithashtu se sa fort e urren fashizmin e se lufta ja ka sjellë shpirtin majë hundës; e di se tetari e do me të vërtetë si një shok e mik e shoqëria me të i pëlqen. Sa herë që i kanë folur shoku-shokut me zemër të hapur janë kuptuar fare mirë. Qëkurse Pirrua nuk e thërrret më zoti tetar, as Paskale Vakaro, por shkurt Paskua, siç e quajnë të gjithë në kazermë, tetari e ndjen veten shumë pranë tjetrit, se atij s'i kanë pëlqyer kurrë epitetet. Kështu i thotë një ditë:

— Thirrmë Paskua, siç më thérresin të gjithë. Unë argat jam, bir e nip argati, që asnjëherë s'jam ngopur me bukë. Shiko duart e mia... Nuk janë duar argati këto?

Atë ditë të nxehjtë vere, ata lozni letra nën hijen e qershisë. Paskua, tepër i mërzitur, nuk i ngrinte sytë nga letrat, si të ishte përpire i téri nga kumari, por ai as kish lojtur ndonjëherë pér të fituar para, bile as dinte të lozte mirë, por me to kalonte kohën e justifikonte pak a shumë shoqërinë me Pirron. Por atë ditë, ndryshe nga herët e tjera, s'lozte fare, vetëm kur dëgjonte zhurmën e ndonjë aeroplani cikërmittë dhëmbët.

— C'ke kështu sot ti, Paskua? S'po më thua një fjalë!

— Shumë herë s'flas tërë ditën.... Më është bërë zakon.

— As me mua s'do tē flasësh?

— Me ty... jo, me njerëz si ty dua tē flas tērë ditën, por sot më dhëmb këtu — tregoi zemrën — e, ndofta, se dua tē flas aq shumë, s'them dot një fjalë. Lufta, lufta e mallëkuar, vëlla... E nëna ime e gjorë më pret. Harron e zeza nënë se biri i saj është në luftë...

— Mos ke marrë letër?

— Po. Por më mirë tē mos e kisha marrë. Nëna vuan tepër, tē gjithë vuajnë. Çdo gjë mungon, çdo gjë me racion, edhe shkrepSAT, ta marrë djalli!

— Ke tē drejtë, Paskua, edhe nëna ka tē drejtë.

— Po kjo është tragedji e tmerrshme tē cilën mje-risht shumë njerëz s'e kuptojnë. Ka sa tē duash tē tillë midis nesh ata... këmishëzestë. S'e kam ditur që në botë paska njerëz kaq idiotë. Ti s'më beson, por unë s'i shoh dot këta njerëz.

— Gjithmonë kështu ke qënë ti, Paskua?

— Gjithmonë! Babai vdiq i shkreti e mua më është mbushur mendja se vdekja i erdhi nga dëshpërimi. Ish pa punë e mendonte për ne. Atëherë Musolini bërtiste për tē ardhmen e Italisë së madhe...

— Të kuptoj, Paskua, ti vuan shpirtërisht.

— Fashizmi... lufta më mundojnë. Nëna vuan, motrat më presin. Jam i vetmi burrë në shtëpi pas vdekjes së tim vëllai. Ai la dy fëmijë. Nëna shkruan se djali i ngjet shumë t'et, megjithëse s'i ka mbushur ende tre vjet.

Futi dorën në xhep e nxori fotografinë:

— Im vëlla, vdiq në minierë!

— Për kapitalistët!!

— Po, për kapitalistët.

Disa minuta s'këmbyen fjalë.

Paskua është i mbushur me brenga si një fuçi me barut, që mund tē pëlcasë si një vullkan. Ky ushtar i gjorë, që një ditë e kishin bërë tetar, vetëm për hir tē gjashtë vjetve që i kishte mbushur në ushtri e që gjithmonë kish qenë gojëkyçur e i bindur me cilindo, më në fund ka gjetur një shok t'i hapë barkun.

— Më zien këtu — tregon gjoksin — e më bëhet sikur brenda kam një vullkan, që pret të shpërthejë. Kur flas e shfrehem e ndjej veten më mirë. Natën përpjektem në shtrat se s'më merr gjumi. Të gjithë flenë, kurse unë mendoj gjithë budallallëqet e botës deri sa gdhijet. Nganjëherë zgjoj Fuzonen, por ky seç murmurit e kthehet në anën tjetër.

— Sikur të ishe në front, Paskua, çdo të bëje?

— Eh... do t'a kisha flakur pushkën që ditën e parë.

— Partizanëve do t'i dorëzoheshe?

— Më parë se të tjerëve!

— Po ata janë njerëz të «egër»!

— Po, po, siç jemi të egër ne të dy.

Qeshën me zë.

— Sikur të ishin të gjithë ushtarët si ti...

— Si unë është Fuzonja, Xhakomoja!

— Ashtu, sot po m'a thua.

— E solli fjala.

Tetari ngriti kokën, pa syt e Pirros të ndritshëm e të qeshur e zemra i rrahu fort. Shikimi i shokut i çiltër e shponjës e gudulisi, ai diçka kuptoi nga bisedimi.

— Do të shkosh me partizanët?

— Dua — tha me rrëmbim tetari.

Pirrua zgjati dorën e shtrëngoi atë të Paskuas, që digjej. Në fytyrën iu duk ndryshe nga herët e tjera, më i çiltër, më i hequr e më i zeshkët. Hunda me samar e dhëmbët aq të bardhë, por pak të mëdhenj, ja bënë fytyrën më të butë. Një damar i tëmthave i fryrë tepër i rrihte e dukej sikur po ja ngjeshte tërë gjakun në kokë për ta ndezur edhe më. Ai e vështronë thellë në sy Pirron e thoshte:

— Unë e di që ti punon për partizanët!

— Unë jam si ti, Paskua, urrej fashizmin dhe luftoj kundër tij... Përse të ta fsheh?

— Jam gati të luftoj bashkë me ty — belbzëzi tjetri — e, po të duash, që tani dërgomë te partizanët!

Pirrua, duke rrrotulluar letrat nëpër duar, s'iua përgjegj menjëherë, por pasi ja nguli edhe njëherë atë shikimin e tij të ngrohtë, që të bën për vete aty për aty, tha me zë të ulët:

— Dëgjo, Paskua... Fashizmi mund të luftohet edhe në rrugë tjetër...

— C'do të thuash? Bjeri shkurt.

Këto fjalë i tha me zë të dredhur e ai damari i tëmthave i këceu edhe më.

— Duhet të bëjmë diçka.. si mund të mendojmë të sigurojmë municione... kemi nevojë të madhe për to!

Tetarit iu zbardh fytyra e zeshkët, lëshoi letrat në tavolinë e qeshi pa qejf.

— Kjo s'është e lehtë.

— E di.

— Nuk kam frikë, por nuk e di a do t'ja dal dot.

— Vetëm është vështirë.

Pirrua hodhi sytë reth e rrrotull sikur do të gjente diçka të humbur e, pasi u sigurua se askush nuk i përgjonte, shtoi:

— A mund t'i besojmë Fuzones?... Në ke besim tek ai...

— Është djalë me karakter, i guximshëm, por...

* * *

Në kazermë bie boria për darkë. Ushtarët, të vënë në rresht, me gaveta në dorë marrin ushqimin. Era e mishit të madh të zier mbush ajrin. Ca qen vijnë rrrotull kazanit, të tjerë ndjekin ushtarët nga pas. Po midis ushtarëve ka nga ata, që i duan qentë, ka edhe nga ata që i shkelmojnë. Ja, Fuzonja i do kafshët e njërin prej tyre e mban pas. Qeni është një bishtprerë me pulla të bardha, që ka aq shumë frikë kur gjëmon, sa s'di ku të futet. Por rreshter Fuzonja e do dhe e

ushqen si jo më mirë. Qeni lëpihet pas ushtarit, ja godet këmbët me atë copë bisht të fortë si dru e i lëpin duart. Paskua tallet me Fuzonen:

— A ke vënë re se qenit sikur po i rritet bishti?

Tjetri s'përgjigjet, po i hedh copa buke bishtprit dhe e vështron si e lëpin tokën. Tetari qesh dhe e ngacmon.

— C'ke me qenin tim, sa herë ta kam thënë se të duash kafshët s'është marrëzi por virtut? Mua s'më bën asnjë të keqe, përkundrazi më zbavit. Ti që nuk i do, as të afrohen as të bien më qafë. Po i hodhe një copë bukë, mirë, po e shkelmove, keq, shumë keq. Eh, Paskua, duaji kafshët se edhe ato kanë të drejtë të rrojnë.

— Atëhere fare mirë — ja priti tetari me atë tonin tallës — Do të bësh mirë ta mbash edhe në automobil, edhe në shtrat, e, po të duash, puthu me të.

— Të thashë, lere qenin e gjorë!

E me të mbaruar fjalën, i shkoi pranë, i fërkoi veshët e i tha:

— Nesër përsëri këtu!

Bishtpreri puliti veshët, tundi bishtin e vazhdoi të thërmojë kockën.

Altoparlanti buçiste nga lajmet e kuartierit të përgjithshëm. Kur u afrua Paskua me Fuzonen, spikeri përmendi legionin bavarez dhe atë të alpinëve, që sikur na paskëshin korru suksese të mëdha në këndje. Më në fund, pasi i erdhë rrötull, përmendi si të parëndshishme përparimet e Sovjetikëve.

— Këto lajme bien në kundërshtim njëra me tjestrën; hem legionet korrin suksese hem rusët! — tha Paskua.

Ai vështron Fuzonen, i cili duket se dëgjon me vëmendje. Por rrështeri është bërë nervoz dhe vetëm Paskua që e njeh mirë ia kupton shprehjen e gjallë të fytyrës, e cila pasqyron ndjenjat e tij në revoltë. Sytë e Fuzones të përhimtë e përgjysmë të mbyllur po tretin shikimin diku larg, në yjtë, që apo kanë zënë

të japin dritë; me një dorë shtrëngon dërrasën e stolit, sikur do të ngulë thonjtë në të. E Paskua, tek e vështron kështu, mendon.

Kur mbaruan lajmet, Paskua i hodhi krahun Fu-zones e të dy bënë një shëtitje në rrugën e gjerë jashtë kazermës.

— Shiko, Fuzone, ç'mbrëmje e bukur!

E tetari, duke shëtitur sytë nëpër hapësirë, ja mori:

Nëse larg, në dhe të huaj
Do të mbetem, o nën' e dashur,
Kujtimin tim ti ruaj!

Nëse vdes nga mallëngjimi
Për ty, e dashur, e villa e motër,
I madh do t'jet mundimi!

Rreshteri mbajti këmbët, tundi kokën dhe e kër-ënroi tjetrin:

— Do të më lesh rehat apo ke vendosur të më marrosësh me këto sentimentalizmat e tua të çmendura?!

Pastaj sikur të fliste me të ëmën, uli zërin e pëshpëriti:

— Oh, e shkreta nëna ime e dashur!

Një copë herë ecën në heshtje pa këmbyer fjalë. Rreshterit i rreh mendja te kujtimet e së ëmës. I bëhet sikur dëgjon zërin e saj të ëmbël e plot dhelka e atë kollën e thatë që ja bren fytin si krimbi dërrasën.

— E dëgjove?... gjithmonë fitojmë e gjithmonë të njëjtat fjalë — e ngacmoi tetari.

— Uf! S'mund t'i dëgjoj më, të gjithë flasin poshtërsira!

— E megjithatë ne luftojmë.

— Mjerë ne, mjerë Italia!

— Në Itali po luftojnë, Fuzone!

— Si?!

— Kanë ngritur pushkën kundër fashizmit. Nuk ke dëgjuar?

— Aq më bën!

— Kurse mua më entuziazmon, më thith si magnet ajo pushkë. Sikur të isha atje...

— E ç'do të bëje atje, o i shkreti djale, që u fishke pa martuar?

Pastaj sikur të vinte në vete, rrudhi ballin, e kapi tetarin për krahu dhe e pyeti:

— Po ti ku i di të gjitha këto?

— M'i kanë thënë.

— Është vonë, tepër vonë, Paskua. Po ata që mbeten në Afrikë, Rusi, këtu? Do të kthehen në jetë ata të mjerë?... Ndofta edhe ne do të mbetemi këtu. Ti e ke parashikuar me atë fantazinë tënde prej poeti. Hm!... thuajmë pra, a do të kthehen në jetë ata fatzez?

Rreshteri heshti, ndofta s'dinte ç'të thoshte më, ose s'kish fuqi të fliste më gjatë, ose e quante të kot të ngrinte zërin. Ngriti kokën e hodhi sytë larg. Ata sy, që duken të ftohtë e të kuq nga damarët e vegjël e të shumtë, u bënë të butë, të dashur e të njomë.

Tetari bashkoi duart prapa e ja priti:

— S'është vonë, më duket se është tamam koha dhe unë, për pjesën time, kam vendosur të jap një dorë... Më kupton?

Fuzonja hapi sytë; i dukej se po dëgjonte fjalë të çuditshme e të pakuptueshme:

— Çfarë?

— Do të luftoj kundër luftës e kundër fashizmit! Do të ndihmojë partizanët!

— ..!

— S'më kupton?

— Ikë, dreq, se ke filluar të tallesh! Apo mos do të më blesh mëndjen?

— Nuk tallem, Fuzone.

— E në ç'mënyrë?

— Do ta mendojmë! Ta zemë se këtë punë do ta bëjmë bashkë...

— Mos u gmende?

— Ke frikë?

Rreshteri, i prekur në sedër, ndjeu një të dredhur në trup. Tetari qenkish njeri i çuditshëm e kokëkrisur.

«Ky qenka djall, e unë e kam kujtuar si ushtarin më të ndrojtur. Mos kërkon të më futë në ndonjë labirint? Sidoqoftë, këtij i punoka truri ndryshe e unë s'kam guxim t'i them vetes se ai s'e ka keq» mendonte rreshteri.

Shkundi kokën sikur të donte të largonte ato mendime, që po e mundonin e iu duk vetja e vogël.

— Nuk kam frikë, Paskua, por kush na beson ne?

— Ne na besojnë, Fuzone.

Rreshteri, i pavendosur e i turbulluar, e ndjen veten të mpitë e të pleksur në një punë të rrezikshme. Një turbullirë ja pushtoi trurin e çakërdisur. E vështron veten përpara një udhëkryqjeje e s'di q'udhë të zgjedhë, s'di q'të thotë e s'di q'të bëjë, prandaj e dëgjon tetarin gjer në fund.

* * *

Ka kaluar mesi i natës. Në fjetore gumëzhijnë të gérhiturat. Fuzonja merr frymë me nxitim, kthen kokën nga shoku e i lëmon ballin me frymën e ngrohëtë, që i bie erë duhan. Në kohë ndjehen këmbë. Është patrulla, që pas pak humbi në errësirë.

— Pas mua, Fuzone.

Siluetat e tyre rrëshqasin pas mureve. Asnjë lëvizje, asnjë zhurmë. Aty pranë, disa fuçi hekuri lëshojnë erë benzинë e vaji të djegur, që përzjehet me erën e kuzhinës dhe atë të flitit, mbasi atë ditë kishin spërkatur edhe muret e godinave.

Ecin pas mureve e, pasi kthehen edhe në një

qoshe, gjenden para portës së shtallës së vjetër. Vjen përsëri zhurma e këmbëve, që godet kaldrëmin ritmikisht. Kalon roja e depove, bajneta e të cilët vezullon në majë.

— Ku jemi, Paskua?

— Atje ku duhet. Këtej duhet të jetë stiva me arka bosh, andej depoja e municionit.

Trualli i shtruar me tulla është akoma i butë, nga mbeturinat e vjetëra, megjithëse ka kohë që s'përdoret si shtallë. Nga dritaret me xhamë të thyera duken copa qielli, që vezullojnë nga drita e yjeve. Vjen era dërrasë e bojë vaji. Fuzonja ka qëndruar para portës së hyrjes, ndërsa Paskua kërkon portën tjetër. E gjen, mbështet pëllëmbën mbi dërrasë dhe e mban një çast mbi të. Fytyra i është qullur nga djersa e pështyma i është tharë në gojë. Shëtit dorën mbi portë e kap dorezën. Hekuri i saj i duket i ftohtë. I rëndon, kërcet por porta s'hapet. Atëhere nxjerr çelësin që e kish pre-gatitur me kohë e, pasi e fut në bravë dhe e kthen me kujdes, shtyn portën. Në fytyrë i përplaset era e arkave të municionit, era e dërrasave prej pishe të thatë. Paskua merr frymë thellë, Fuzonja jep shenjë se roja po ngjitej përsëri.

Zemra u godet me shpejtësi e para syve u bëhen ca si ujëra. Paskua futet në të ndarën tjetër.

— Fuzone — pëshpëriti. — Nuk shikoj asgjë; mos e kanë zbrazur?

— Nuk e di!

Pak nga pak sikur i erdhën sytë e shtriu dorën përpëra. Preku një arkë e, si e kapi nga dorezat, e ngriti dhe e nxori maçanë portës. Fuzonja sapo kish afrouar një arkë bosh. I këmbyen. Paskua vendosi arkën bosh atje ku hoqi të parën e mylli portën.

Pas dy ditësh Paskua u takua me Pirron.

— Ku ke humbur? — e pyeti tetari me buzë të mbledhura e duke tundur kokën në shenjë qortimi.

— Të kam pritur si gruaja burrin e ti... ah ti, çap-kën që më zhdukesh si hije!

Pirrua qesh. Tetari i shkel synë e, pasi i ngjesh një grusht përkëdhelës në gjoks, e ul në tavolinë.

— Të kam sjellë ca dhurata. Piro! Vështro këtu — shtriu dorën mbi këmishën e blertë, mbi të cilën u sajuan format e krehërve të fishekëve.

Pirros i gufon zemra e, sikur të mos u zerë besë syve, mban shikimin një copë herë mbi këmishën. Pas-kua e vështron në sy e buzëqesh me kënaqësi.

— Bashkë me Fuzonen?

— Po.

— E dija që s'do të kursehej.

Tre gjuajtës u vërtitën me një buçimë shungulluese mbi kokat e tyre. Tetari ngriti sytë e shtrëngoi dhëmbët.

— M'u mërzitën fort këto maqina, s'ngopen së ngrëni e unë i ziu mezi arrij t'jau mbush barkun me benzinë. Po thonë se këta «Pikiatelët» u vjetëruan e në vend të tyre do të përdorin një lloj tjetër, më të shpejtë e më të shkathët. Pilotët e vjetër ankohen tepër e s'duan të hipin fare në to, sepse, kur bien në pikjatë, u dridhen krahët.

— Po ky lloji tjetër si quhet?

— S'e di, s'e kam parë, por sipas toger Santit, padronit tim, janë një imitim i mesershmidëve.

— Ahere këta «Pikjatelët» do t'i blejmë për partizanët!

Qeshën një copë herë e i rrähën krahët njëri-tjetrit.

— Fuzonja do të ngarkojë rërë në Dunavec — vazhdoi Paskua.

— Do ta pres atje. Parulla do të jetë: «Shisni cigare Maqedonia? Unë ble nuk shes!»

— Fare në rregull.

— Tani t'i transmetoni edhe Fuzones falënderimet e komandantit të njësitet e të të gjithë shokëve të tjerë, e hapni sytë që të tregoheni tepër të kujdes-shëm. Porosia e komandantit është që ta ruani veten. Partia dhe lëvizja do të kenë gjithmonë nevojë për ju.

Paskua dëgjon me vëmendje dhe një gëzim e krenari e pushton dalëngadalë të tèrin. «Partia, lëvizja!» këto fjalë i kumbojnë në vesh vazhdimit, s'i shqiten për asnijë çast, e ndjekin pas e i japin forcë. Sa ndryshe mendon tani! Asnjëherë s'e ka parë jetën kështu. E vë veten përballë dy tablove, dy jetëve dhe vështron me habi se si u bë njeri aq i vlefshëm. Tani, të tjerë mendojnë edhe për atë, e duan dhe e ruajnë, e quajnë «shoku ynë i luftës».

Vështron Pirron që ka përpara e mendon toger Santin. Sa larg qëndron Pirroja nga toger Santi. Ai s'është zotni si togeri, s'ka yje e shirita, as qizme e as napolona. Çapi i tij s'kumbon në kalldrëm si çapi i oficerit, askush s'i lëshon rrugë e s'i bën nderime, përkundrazi, as i hyn në sy njeriu ai djalë i keq i veshur pa gusto e që bie erë qepë. Por sa ndryshojnë ata të dy, pikërisht ata të dy, që bëjnë pjesë në jetën e Paskuas. E Paskua i ve në peshë, i shkoqit e i shoshit.

Paskua dalëngadalë e vështron veten të lidhur fort pazgjidhmërisht me këtë vepër të bukur. Jeta e tij ka marrë tjetër kuptim tani. Ai e di se tani s'jeton vetëm për veten e tij dhe kjo e vërtetë e frymëzon e i mishëron ndjenjën, dëshirën e tij. Ai e ndjen më shumë se kurrë, tani, se me q'forcë të madhe e përbuz rendin e zotërinjve. Sa të vegjël e sa të këqinj pas kan qenë këta egoistë dhe sqimatarë. «Po unë ku i paskam pasur sytë vallë?» Tani fillon ta kuptojë edhe të atin, i cili s'dinte të thoshtë më tepër se pesë fjalë: «Jeta është e rëndë, biri im!»

Pas këtyre mendimeve vështron sytë e Pirros të ndriçëm e të gjallë, fytyrën e tij të imtë e të thekur në diellë, mustaqet e rralla, të cilave s'ua ka shkuar kurrë briskun, dhe habitet me vendosmërinë e qartësinë e këtij djaloshi.

* * *

Dielli shkëlqen me një dritë verbuese. Në ujët e lumit pasqyrohen hijet e ca reve të bardha, që e errë-sojnë herë pas here edhe rërën edhe tinën e murme. Në vendet e thella, ku uji duket sikur fle, lëvrijnë cironkat pa pushim. Sapo zhduket peshku, mbi sipërfaqen e ujit sajohen rrathë, që hapen me nxitim deri sa prishen fare. Rrezet e diellit bien si tufa gjilpërash mbi ujë e sikur derdhin mbi të heshtjen nëpër të cilën dëgjohet qartë fluturimi i zekthit. Pirrua noton buzë lekëheve të ngrëna, zhytet, si peshqit, e befas del sipër duke shfryrë ujët.

— Më duket se po vjen — tha Sotiri, shoku i Pirros.

Pirroja hipi mbi ledh e shtiri sytë nga xhadeja. Kamioni apo mori kthesën te ura e, ngaqë Fuzonja ekte shpejt pa e ulur gazon edhe në kthesat, maqina u anua aq shumë, sa ushtarët që ishin mbi të u hodhën nga një spont në tjetrin. Disa sekonda kamioni u zhduk në të tatëpjetën e shkurtër të lumit, pastaj befas u duk hunda e tij e gjerë e mbuluar me një maskeri-no prej rrjete teli të trashë. Motori uturoi një hop e gazet e zeza të karburantit u hapën si re, pastaj zhurma u zbut deri sa motori u shua fare. Ndërkohë që po zhdukej reja e gazeve, xhamet e fenerëve shkël-qyen si inxhi mbi ujë. Shoferi, pasi i erdhi rrrotull kamionit duke parë gomat e balestrat, vuri duart në ije e zuri të sodiste ujët.

Mbajti vesh, vështroi në pasqyrën e mbërthyer te porta në krahun e tij e, pasi pa ushtarët që ja filluan punës, ngriti njëren sedile, hoqi mënjanë një sërë lec-kash e shtiri dorën brenda. Doli nga kabina edhe vendosi fishekët në të. Pasi mori edhe pezaulin nga një qoshe e kabinës, u foli ushtarëve:

— Unë do të shkoj për peshk, djema. Kur të jini gati më bëni zë.

Zuri vend në një ledh, që hynte si hundë në

shtratin e lumenit. Njëzet hapa më tej pa dy njerëz, të cilët po bënин banjë dielli dhe s'treguan ndonjë intëresim pér të porsaardhurin. Fuzonja njohu Pirron; atë tjetrin s'e kish parë ndonjëherë.

Kur Fuzonja hodhi pezaulin në lumë, dëgjoi zërin e Pirros:

- Mirëmëngjez, rreshter!
- Mirëmëngjez!
- Shisni cigare Makëdonia?
- Unë blej, nuk shes!
- Shtrënguan duart e Fuzonja, pasi bëri me kokë nga kova, tha:
— Zhdukuni shpejt!

Kur çdo gjë kish marrë fund, rreshteri ngriti pezaulin dhe pa me gëzim se në rrjetë po kërcenin një tok mërenka. Disa prej tyre kërcyen fort e ranë pingul mbi ujë, kurse ato më të voglat zhunë të dalin nga vrimat e rrjetës.

— Shpejt se të ikën, rreshter.
Fuzonja zbrazi pezaulin në kovë dhe e hodhi së dyti.

«Çdo gjë shkoi pér mrekulli, ja edhe peshqit» tha më vete e, duke vështruar me bisht të syrit Pirron e Sotirin, mendoi: «Me djema të këtillë ka lezet të kesh miqësl».

Atë çast u dëgjua zëri i një ushtari:
Rreshteri s'u përgjegj, por zgjati kovën e i tha Pirros:

- Zgjidhni ata më të mëdhenjtë!
- Falem nderit; herën tjetër kur të zini më tepër.
- Si të doni, djema; nesër do të dal përsëri pér peshk. Mirë u pafshim.
- Qeshi me zë, fikthi iu drodh e, duke shkelur syrin. u largua tërë qejf.

* * *

— Xhakomo... ku je, i dashur?

Nga porta e vogël e kuzhinës zgjati kokën gjellë-bërësi:

— Ç'ke, rrështer, — pyeti rëndë-rëndë ai burrë hundëmadh e me ca sy të vegjël, si pa ngjyrë.

Fuzonja i tregoi kovën. Kuzhinieri ndërrroi fytyna menjëherë, u bë i ëmbël, i butë e, duke qeshur, u përkul mbi kovë e foli me zë përkëdhelës:

— Peshq të uruar! Pa shiko, shiko, qenkan ende gjallë. Po ku ke qenë deri më sot? Do të pimë verë, Fuzone, shpejt, t'i fërgoj sa janë gjallë.

Paskua te porta vështron e dëgjon.

— Ej Paskua, pa shiko këtu. Fuzonja ka sjellë peshk.

Tetari pa Fuzonen që i shkeli synë.

Në mbrëmje, kur po pinin verë, Fuzonja filloi t'i tregojë për marshall Skopin, atë të kontrollit rrugor. Ish grindur keq me të dhe ai e kish gjobitur.

— Këto pesë frangat e mia mos ishin llogaritur për ndonjë nevojën tuaj personale, zoti Skopi? — i thashë. E ta kishit parë si u ndez fashisti, u tërbua e më kërcënoi.

— Përse grindesh me njerëz të tillë? — e këshi-lloji Xhakomoja.

— S'mund t'i duroj këta batakçinj. Ti, Xhakomo, s'e njeh atë maskara, që u ka shtënë tmerrin gjithë shoferëve. Ai faqeprerë e ka zemrën të zezë si këmissha që mban...

— Mjaft, Fuzone, — ja priti Paskua. — Ti flet shumë, nuk bën.

Fuzonja ngriti shishen e, si kapërdiu disa hurba verë, mori një merenkë dhe e kapërdiu me gjithë hala.

Të nesërmen Fuzonen e thirrën në zyrën e shërbimit special dhe, pasi ja hoqën veshët mirë për pu-

nën e marshall Skopit, e dënuan tri ditë arrest kazerme.

Kapiten Laxareti në dosjen e Fuzones hodhi edhe një copë letër tjetër të veçantë e në të shënoi:

«Tetar Paskuale Vakaro, furnizues i aeroplaniёve me karburant dhe Xhakomo Vigoreli, kuzhinier».

Po atë ditë, përpëra kapiten Laxaretit u paraqitën informatorët.

— Ju duhet të më zbuloni sa më shpejt gjendjen. Fuzone Fanelli s'e ka pasur këtë gjuhë. Ai rebel paska guximin të ofendojë superiorët. Kujdesuni edhe për Paskuan dhe Xhakomon, se diçka po nuhas!

Kapiteni, ky ujk plak, i regjur në shërbimin speċial, i vëtëdijshém pér detyrën e tij sekrete, i kish rënë hilesë. Truri i tij punonte tepér, ai trazonte çdo gjë e slinte gur pa lojtur nga vendi. I zhytur në mendime, duke pirë me duf duhan e duke shëtitur nëpér zyrë, vendosi të provojë Paskuan. Ai u nis menjëherë dhe e gjeti Paskuan tek po merrej me ca punë personale të toger Santit. Tetari sapo e pa, mori drejtqëndrim e i qepi sytë kapitenit, duke pritur urdhërat.

— Siç e shikon, tetar, erdha unë tek ju.

— Zoti kapiten, unë s'kisha pasur ndonjë urdhër që t'ju paraqitesha.

Kapiteni, duke i vënë dorën në sup, e përkëdheli me sy dhe e uli në një fron pranë tij.

— Erdha t'ju pyes e shpresoj se do të më thoni diçka... Rreshteri Fuzone Faneli ka folur keq pér mareshallin Skopi, pér këmishën e tij të zezë e... mjaft të tjera që ju duhet t'i dini më mirë. Por mua më intereson më tepér të di ku e ka burimin, se një guxim i tillé...

— Zoti kapiten, ç'mund t'ju them më tepér?

Kapiteni tundi kokën në shenjë keqardhjeje e bëri shenjë me dorë që të heshtte.

— Tetar Paskuale Vakaro, pres të më thoni kush e mëson rreshterin të flasë kështu.

— Nuk ju kuptoj, zoti kapiten. Ju lutem të më

falni, por si t'ju siguroj se rreshteri s'ka folur asnjéherë me nénkuptime. Pastaj ai ka qenë i dehur, besomëni.

Sytë e kapitenit e vështruan ftohtë. Kapaku i syrit të djathtë, të cilin e ka pak të fryrë e i shëmbllen aq fort një cope brumi të ardhur iu drodh keq e, si pér të shkuar kohën, ose, më mirë, duke numëruar minutat gjer kur Paskua do të fliste, godiste gishtat me nervozizëm në gju. Kur iu sos durimi, iu afrua Paskuas, e pa ngultas në sy, i përkëdheli çipin e jakës me dy gishtat e thatë e eshtakë, që i dridheshin e i binin erë parfum e ja priti me ton ushtarak:

— Unë kam nevojë pér ty. Dua të më informosh pér biseda e fjalë të dyshimta që do të dëgjosh.

Paskua, i mbërthyer keq nga shkimi i ftohtë i kapitenit, ndjeu djersë në ballë. Një drithmë e një shqetësim i lehtë i përshkoi téré trupin. Vështroi edhe ai ngultas sytë e kapitenit dhe s'bëri përpjekje pér ta shqitur shikimin. Zhurma e disa aeroplanëve bëri që kapiteni të lëvizë, të hedhë sytë në dritare e të flasë me ton të butë:

— Besoj se u kuptuam, nënoficer Vakaro!

Kur doli nga dhoma e togerit Santi, aeroplanët po zbrisnin një nga një. Tetari rendi drejt aeroplanit të togerit se e dinte që atij i bëhej qejfi. Sapo u shua motori, Paskua këceu në krahët e aeroplanit, hapi xhamin plastik e zuri t'i zgjidhë rripat e parashutës. E togeri téré qejf e pyeti:

— E pastrove uniformën?

— Si urdhëron, zoti toger!

— Edhe çizmet?

— Si urdhëron, zotni!

— Bravo, sot pas dite je i lirë.

— Shumë të falem nderit, zoti toger!

* * *

Në furrën e Sandrit Paskua gjeti Pirron. Shpjegoj shkrt e qartë ç'i kish ndodhur e kërkoj këshillë.

Pirrua, i hutuar një çast, s'diti ç'ti thoshte, s'i tha asnjë fjalë aty pér aty, por kur pa se tëtari po e përpinte me sy, tha:

— Do të përpinqem të të dërgoj udhëzime.

— Sa më parë, të lutem.

— Do të mundohem e mos harro se udhëzimet do ti dërgoj me një lustraxhi.

Të nesërmen Paskua arriji në kazermë me mendime të çuditshme. I pari që pa ishte Frankua, një njeri i pacipë, fashist i tërbuar dhe informator besnik i kapiten Laxaretit. Ç'urrejte të thellë ndjeu atë çast pér atë këmishëzi! I erdhi turp nga vetja kur mendoi se edhe nga ai kërkonin të bënин atë që bënte Frankua.

Lustraxhiu, një djalë i qeshur, vinte rrrotull kazer-mës duke bërtitur «Lustrascarpe» e, duke iu treguar ushtarëve një kuti me kokën e negrit të shkruar «Sénégal», iu afroa Paskuas.

— A ti bëjmë, tetar? Kam bojë të pastër, ja, shiko!

Paskuan diçka e goditi në zemër, pa në sy djaloshin e mendoi: «Mos është ky ai lustraxhiu?»

— Asnjëherë s'më kini preferuar — u lut djaloshi të cilin Paskua e dëgjonte me dëshirë dhe i dukej i ëmbël e dashamirës. Boja ime shkëlqen. Do të mbeteni të kënaqur!

— Eja, djalë, eja meqë paske bojë të pastër.

Lustraxhiu godet furçat si zakonisht e, pasi ja fshin pluhurin, ngjen sfungjerin në bojë.

Njëra këpucë mbaroi shpejt, e kur tetari vuri tjetren mbi arkën mbështetëse të lustraxhiut, ai i zgjati një kuti pastë dhëmbësh:

— Ju ra nga xhepi!

Paskua vështroi një çast djaloshin, buzëqeshi dhe mori kutinë.

— Falem nderit, djalë, apo e kisha blerë.

Kur futi kutinë në xhep, djaloshi goditi furçën në arkë. Tetari u ngrit dhe futi dorën në xhep, por ai hodhi arkën në sup e u zhduk duke thënë:

— Për ju s'marr para!

Paskua hapi kutinë, kontrolloi brenda, por veç pastës dhe fletëreklamës s'kish asgjë tjetër. Lexoi fletëreklamën dhe dalloi se disa gërma ishin shënuar me pika, me kalem. E lexoi përsëri e, pasi i bashkoi me mendje gërmat e shënuara me pika, lexoi fjalën «Shërbeni».

Tani s'di ç'të mendojë, as ka fuqi të lozë nga vendi. Pëshpërit fjalën «shërbeni» e mbyll sytë. Ashtu me sy mbyllur i bëhet sikur dëgjon fjalët e Pirros atje në furre.

Në mbrëmje, kur ra në shtrat e pa se s'do ta merrte gjumi, për të parën herë i kërkoi Fuzones cigare. E, duke ndjerë hidhërimin e tymit e duke pështyrë, Paskua u rropat në shtrat sa andej-këtej.

— Mbyll sytë, Paskua, e mundohu të shikosh në endërr të dashurën tënde... natën e mirë.

Tetari, i mbështetur më krah, vështron xhamin e dritarës që zbardh nga drita e hënës. I mban sytë mjaft kohë në atë xham e dëgjon gërhimën e Fuzones, që fle i qetë.

«Ja, ti, Fuzone, fle, ti je i qetë e as të shkon mendja se si po koklavitet ky lëmsh. Tani duhet t'i shërbej edhe kapitenit, por me këtë s'është aq lehtë. Ky s'kérkon këpucë të lustruara, as xhaketë të heku-rosur, as t'i zgjidh parashutën. Jo, ky kérkon një punë që është zanat më vets, por argatët, i dashur Fuzone, s'e kanë qejf këtë zanat. Eh, sa mirë fle ti, po ty të kérkojnë më pak e s'ke nevojë të vrasësh mendjen si unë. Mjafton të qëndrosh në timon dhe... Oh! po dale, ç'flas kështu? Jo, Fuzone, më fal, ti m'i ke dhënë të dy krahët e tu të fuqishme. Megjithatë ti flë i qetë natën dhe ditën kujdesesh për automobilin e qenin, siç kujdesem edhe vetë për aeroplanët.»

Në zyrën e shërbimit special u paraqit tetari Pas-kuale Vakaro. Kapiteni, i ulur në tavolinën e punës, ngriti vetëm kokën, vështroi ftohtë tetarin dhe i tregoi një karrigë. Paskua u ul përballë tij dhe vuri duart në gjunjë.

— Çfarë do të më thuash?

— Zoti kapiten... Çezarinoja e tha troç se i është mërzitur lufta dhe as i intereson nëse fitojmë apo jo. Bisedonte me Luçianon. Ky, i aprovonte fjalët e tij, e tha se tani nuk u zinte besë më lajmeve të Kuartierit të Përgjithshëm!

— Je i sigurt?

— Shumë i sigurt, zoti kapiten. I kam dëgjuar me këta veshë dje, kur pinin verë në kafe.

— Falem nderit... Përgjojini, zbuloni më tepër, më tepër.

Oficeri shkoi në dritare dhe ndoqi më sy Paskuan tek po largohej. Tetari nuk e gënjeu, por i tha pikë përpikë atë që kish dëgjuar se e dinte fare mirë kush i sh Çezarinua dhe Luçianua. Kapiteni bëri kështu provën e agjentit të ri dhe me këtë besoi se ja hodhi Paskuas.

«I shkreti djalë filloi të më pëlqejë që sot. Mirë, pra, por... po sikur të më jesh një këlysh dhelpëre e t'i kesh rënë erë punës? Ta zemë se s'je i tillë, po a mund të mos kesh dëgjuar edhe të tjerë? Po çështjen e Fuzones e harrove?»

Paskua u zhduk në qoshen e parë, ndërsa kapiteni ndezi një cigare e vazhdoi të mendojë, duke e shfryrë duhanin te xhami i dritares.

Ditët u rrokuillisen shpejt. Paskua dhe Fuzonja i zbrazën nga dhjetë arka fishekë. Po ashtu tetari i raportonte rregullisht kapitenit dhe ky i fundit donte s'donte do të shënonte në dosje. U bënë nga pesëmbëdhjetë emra, e këta në pjesën më të madhe ishin këmishëz e disa borgjezë e nën oficerë prej të cilëve s'mund të prisje asgjë të mirë. Kapiteni Laxareti kafshonte gishtat nga inati e sa s'pëlciste, por tetari, duke

u sjellë si një njeri që s'kupton shumë gjëra, s'i dha asnjë emër ushtari prej atyre që priste kapiteni.

Andaj kapiteni gjurmonte Paskuan dhe Fuzonen dhe, për t'i zbuluar, përdorte njëmijë mënyra. Spiuni Franko diçka kish nuhatur dhe kapiteni i kish vënë nën urdhër atij gjithë informatorët.

* * *

Natë shtatori. Gjethet që kanë zënë të zverdhen aty këtu, fëshférjnë lehtë. Kapiteni apo ka rënë në shtrat, kur befas dëgjon në portë një trokëllimë të fortë dhë një zë:

— Zoti kapiten!

Te porta, spiuni Franko belbëzon:

— Ata... ata, në depon e municionit!

— Si, si... kush?!

— Paskua, Fuzonja!

— Shpejt!

Paskua apo ka kyçur portën, kur dëgjon zërin e njohur të kapiténit:

— Kush është aty?

— ...!

— Kush është aty?

Paskua u bë një me murin, kurse Fuzonja u struk midis arkave të zbrazta. Sytë e tyre shkëlqyen në errë-sirën e shtallës. Dy hije u dukën te porta. Pas pak ushtarët u futën brenda. Në çast Fuzonja iu hodh të parit, e goditi me grusht hundëve dhe e rrëzoi përdhe. Një zhurmë tjetër u dëgjua e një oh! Paskua rendi te porta dhe atje u ndesh ballë për ballë me Frankon dhe kapiténin. Të dy këta të fundit mbanin armë në dorë.

— Asnjë lëvizje!... jini të arrestuar — thirri kapiteni.

Paskua kapi dorën e Frankos dhe ja ngjeshi me

gju nën bark, ndërsa Fuzonja iu derdh kapitenit, por ai ngriti dorën dhe e lëshoi më forcë mbi rreshterin duke e goditur në zverk me myllin e berretit. Fuzones iu veshën sytë, koka iu ep, por u mbajt dhe e goditi kapitenin deri sa e rrëzoi. Zhurma metalike e armës u dëgjua nëpër kalldrëm dhe, menjëherë pas saj, një zbrasje arme. Këmishëzeztë, që sikur mbinë nga dheu, u hodhën mbi Paskuan e Fuzonen.

* * *

— Më në fund, kapiten, goditet në shenjë. Fërgëzimet e mia!

Me këto fjalë hyri në zyrën e shërbimit special një funksionar i SIMI-t.

— M'i sillni shpejt njerin pas tjetrit.

Nga biruca nxuarën Paskuan. Dielli i mëngjezit i vrau sytë, por ai ecte kryelartë, me çap të urregullt, të sigurt, dhe gjakftohtë. Në fytyrë ishte zbehur pak, por shikimin e kish të zjarrtë. Edhe përpara oficerëve ashtu qëndroi, kokëlartë. Sytë i shkëlqyen, zemra i rrihte pak me nxitim dhe ndjeu gjakun se si i vërshoi nëpër trup. Shetiti sytë nëpër dhomë, i fiksoi një çast mbi tavolinë, pastaj vështroi ngultas kapitenin.

— Shpjegoni — klithi ai që ish veshur civil.

Paskua hodhi sytë mbi atë burrë me trup të lidhur, i mati kokën e madhe me flokë të zez, si të ngjitur pas kokës e të ndarë në mes, me sytë e vegjël e të shkathët, që i lëviznin si sytë e miut, e soditi një çast, pastaj mblodhi buzët, hoqi sytë nga i panjohuri dhe i hodhi mbi kapitenin.

Çudi, Paskua s'e kish parë kurrë aq me vëmendje kapitenin. E tani sikur të mos kish ndodhur asgjë e sikur të ish në një orë të lirë midis miqve e shokëve, zuri të bëjë krahasime të kota midis këtyre dy burrave aq të kundërt në pamje.

Kapiteni, i gjatë, i hequr, me sy të mëdhenj e me atë kokë të vogël me leshra kaçurrela e të kuqe, qëndror më këmbë si stap e duket si një fëmijë i drojtur përpara atit të vrazhdë.

— Shpjegomëni, ç'ju duhen këta fishekë.

Paskua lëvizi gjuhën nëpër dhëmbë.

— Kini parasysh se heshtja ju rëndon dhe gjithashtu unë s'kam kohë të lirë që të merrem dhe aqë me ju.

— Kujt ja jepni këta fishekë? — ndërhyri kapiteni duke përdorur një zë të butë që Paskua s'ja kish dëgjuar kurrë ndonjëherë.

— E di ti që shkon në gjyqin ushtarak? — u shkreh civili, të cilit tani i dridhej një faqe.

— E di dhe aq më bën!

— Mjaft... Hiqeni e sillni tjetrin!

As Fuzonja s'u tund përpara britmave dhe kërcë-nimeve. Ky as iu hodhi sytë funksionarëve, por vështroi nëpër mure, ashtu siç mund të bënte duke parë diçka të re të panjohur.

— Nuk ka rëndësi — tha eprori me zë që mezi i doli nga fytì. Tetari i tregoi të gjitha.

Ne dimë gjithshka, pra të shohim si do të silleni përpara skuadrës së pushkatimit.

* * *

Atë ditë, kur Paskua dhe Fuzonja do të dilnin përpara gjyqit ushtarak, plasi lajmi i jashtëzakonshëm dhe aq i gëzueshëm, që e bëri kazermën të ziej si një zgjubletësh. Ushtarët, të mbledhur në grupe, pyesnin njërit-tjetrin e bisedonin me zë të lartë. Grumbuj të tjerë ushtarësh vërtiteshin në xhade e në kafene. Xhakomoja, kuzhinieri, midis tyre fliste duke tundur duart, por, kur pa togerin Santi, i doli përpara dhe e ndali.

— Zoti toger, ju lutem, a mund të na ndihmoni përt'i liruar të burgosurit?

— Çfarë doni prej meje?

— Të burgosurit janë në rrezik, e ligjet tona tani s'kanë më fuqi; çdo gjë mbaroi zoti toger, vetëm këmi-shëzestë s'duan të besojnë e të hapin dyert. Jam i sigurtë se autoriteti juaj do t'i bindë, kështu s'do të detyrohemë të përdorim forcën!

— Në qoftë se ju, rebelët, kini forcën që mund ta përdorni, c'prisni më?... Ç'kërkoni nga unë?

Kuzhinieri shtrëngoi dhëmbët e u thirri ushtarëve:

— Djema, Paskua dhe Fuzonja janë në rrezik; duhet t'i lirojmë para se të mbërrijnë gjermanët...

Kur dëgjoi Pirrua që sapo kish arritur te grupi i ushtarëve, se Paskua dhe Fuzonja ishin të burgosur, kapi Xhakomon për krahu e, duke i ngulur sytë, tha:

— Ne jemi shokët e tyre. Ju, Xhakomo, jini njeri i mirë, më ka folur Paskua, e nëse i doni bashkat-dhetarët tuaj, duhet të bëni c'të jetë e mundur që të mos iu dorëzohen gjermanëve:

— Do ti lirojmë djema!

— Kini nevojë për ne të njësitet?

Xhakomoja s'di c'të thotë, e shikon Pirron në sy e s'para i kuption këto fjalët e fundit, por Pirrua, që kërkon ta shpejtojë punën, ngre dorën lart e thërret:

— Ushtarë!

Ju të gjithë e dini se çfarë ka ndodhur sot. Italia kapitulloi pa kushte dhe doli nga lufta. Ju mbetët pa komandë, por rrugëve s'duhet të mbeteni. Fronti nacionalçlirimtar ju bën thirrje të bashkoheni me forcat nacionalçlirimtare që të mos u shërbeni më gjermanëve. Sot do të bëhet një manifestim popullor. Ejani edhe ju të gjithë, ushtarë e nënëficerë. Ne ju presim me krahë hapur. Populli ynë do t'ju përkrahë me gjithë zemër. Do t'a shikoni.

Shkëputuni nga këmishëzëtë se ata do të përpinqen t'ju mashtrojnë, do t'ju dorëzojnë te gjermanët dhe atëhere, atëhere asnjë prej jush s'ka për t'u kthyer në shtëpi.

Me ne sot janë bashkuar shumë ushtarë. Gjerma-nët priten të vijnë nga çasti në çast. Shpejtoni sa s'është vonë, e më parë se të gjitha duhet të lironi shokët tuaj të burgosur. Në kini pritur deri tani kot së koti, se askush s'ju ndalon, nxitonni, vellezër, sa pa arrijtur gjermanët.

Pas kësaj një grup ushtarësh i shkuan pas Xhakomos dhe iu vërvitën rojeve të burgut:

— Hapni dyert, — bërtiti Xhakomoja.

— S'kemi urdhër!

— Nga kush prisni urdhër ju, i kini trutë në kokë apo u kanë rrjedhur? Dëgjoni, djema... Këta presin urdhër! .

— Dorëzoni çelësat se po i hapim vetë — thirrën një tok zérash.

Midis poteres së zérave, Paskua, që kish dalluar zérin e Xhakomos, rendi te porta e, duke e goditur me grushte, thirri:

— Xhakomo!

— Jam unë, unë Xhakomoja, jam këtu... A dëgjoni? Ç'do gjë mbaroi!

Të burgosurit dolën me rrëmbim në korridor. Përgëzimet e përqafimet u përzien me poteren e zérave të gëzuar, e, në mes të kësaj zhurmë, u ndje zëri i Xhakomos:

— Dilni jashtë, shokë, sa më parë!

Kur arrijti kapiten Laxareti me spiunët e tij të shoqëruar nga gjermanët e porsaardhur Paskua, Fuzonja, Xhakomoja dhe ushtarët e tjerë, të shoqëruar nga Pirrua me shokët e njësitet, ishin zhdukur.

DITË STUHIE

Eshtë dita e pestë që po gjëmon kjo gryka e Gjergjevicës. Moti eshtë i ashpër me dëborë të madhe e me cingërimë të paparë. Qiellin e zymtë e shtrën-gojnë re të përhimita, e ngushtojnë dhe e zvogëlojnë së tepërmë. Acari të përthan lëkurën e ashpër e të plasur. Fluturojnë tallazet e borës e sakaq i ndërrojnë reliefin tokës. Këtu mbushen vijat, atje fshihen e lëpihen brinjët. E në këtë stuhi të tërbuar, syri s'të vështron larg, lotët të ngrijnë mbi mollëzën e faqes së akullt e që ke pranë të humb nëpër perden e mjegullt, që luhatet si cohë e përhimtë dhe e bardhë.

Pesë ditë përpjekje në këtë luftë të ashpër e të pabarabartë, të izoluar në këtë grykë të akullt, që ulërin si një lubi nga erërat, eshtë një provë e pa-shoqe për këta partizanë. Vështroi Kujtimin tek po numëron fishekët. Deri tani eshtë zvaritur dy herë deri te armiqtë e vrarë e i ka xhvatur. Një dorë me fishekë, një gjysmë galete e një bombë me bisht druri, më tepër se ne të tjerët. Atij i ndih fati. E kush nga ne i ka këto? Asnjë!

I radhit fishekët në gjerdanin e ri që e sajoi vetë me një copë stofë të fortë prej çadre e i numëron sikur të jenë rubinë. Në dorë mban galetën e fortë si gur. Sytë e përkuqur me vetulla të zbardhura nga okita i shkëlqejnë. Kapa e prerë tepër e vogël për kokënn e tij tërë flokë kokoridh i rri si një kapë fëmi-jësh. Edhe xhaketën s'e kopsit dot, mbasi edhe ajo

është prerë ngushtë e shkurtër. Ai gjermani paskish qenë fare kérthi! Më vinte t'ja plasja gazit tek e vështroja me këtë xhaketë që Kujtimi e kish prerë me brisk në ijet e në kurriz.

— Ptu — ja bën ai. — Unë të bleva për thes, moj e shkretë, e ti më dole qeskë për trahana. — E duke qeshur më afrohet.

— Ndaje — më zgjati galetën. — Mua s'më bëjnë duart, më ranë thonjtë!

E zuri t'i férkojë me borë.

Po ngryset dhe akoma s'kemi vënë gjë në gojë, e kur të mundon uria të vete mendja te gjellët më të mira dhe tek ato që s'i ke ngrënë kurrë e s'i ke parë as më sy. Ç'ironi!

Stefi ka mbërthyer sytë në copën e galetës. Sa më dhimset kur e shikoj kështu, të uritur e të kuspusullosur në atë gjerdhishten e ngrirë. Është më hamësi nga të gjithë dhe kur i gërrasin zorrët, rrropatet e ngërdhesht si mos më keq. Bën ç'bën e rrëmon xhepet, por edhe dëllinjat i janë sosur që njëherë.

— I dhashë copën e galetës.

— Oj, oj, — qeshi. — Po ç'më sjell vërdallë? Mos ke edhe ca?

Kam një copë për Teftën.

— Eh... kur do të ngopem njëherë pa copë të bëhet, M'u ngjitën zorrët fare... Po Tefta s'është kthyer akoma? Thua të sjellë gjë?

— Patjetër. S'do të vijë duarbosh. Ja, shiko, shiko, kujto qenin e rrëmbe shkopin!

Tefta ka hedhur një trastë në sup e po vjen. Fytyra i qesh. Sakaq na lëshoi nga një dorë me kokrra misri e u largua shpejt duke buzëqeshur. Kur u ndal te Kujtimi, pesë hapa larg, i pashë buzët të mavijosura, sytë të buhavitur, e flokët të zbardhur nga ngrica. Nga një këpucë e shkyer i kishin dalë gishtat jashtë, të përkur që dhe të buhavitur edhe ata. E duke parë të rendë si sorkadhe nga një partizan te tjetri, duke zgjatur dorën e bardhë, të vogël e kosk' e lëkurë, mendoja: «Sa e mirë është kjo Tefta jonë!»

Sot bën punën e intendentit, nesër të infermieres, ditën tjetër drejton kursin kundër analfabetizmit e bën ç't'i dalë pérpara. Në vijën e parë lufton si burrë, s'i trembet syri fare, vuan një soj si ne e s'pranon kurrë privilegje. Ne na bëhet zemra mal, veç s'para na vjen mirë kur na arnon. Janë disa që u vjen turp, por ajo ua rrëmben ndërrresat nga duart e bën punën e saj. E po të mori vesh se s'do t'i rëndohesh, të ve pérpara me atë gjuhë brisk e të bën pér pesë para. Do s'do, do t'i bindesh. Ajo ka vënë ca rregulla këtu që askujt s'i shkon në mend t'i shkelë. Kur ndez zjarrin pér të larë ndërrresat, secili shkon te kazani dhe hedh të vetat. Ajo rri atje e i përvëlon një nga një, duke i trazuar me një shkop thane të gjatë.

Sot brodhi tërë ditën e më në fund u kthyte me një trastë me misër.

Po afron muzgu. Dëbora bie si miell i situr, e gryka e Gjergjevicës s'ushtin si ca orë më parë, se të shtënat janë rralluar.

* * *

Dëgjohet urdhëri:

— Kolona në marshim!

Fillon lëvizja. Dikush shembet, një tjetër mezi ecën. Sa keq i paskemi këmbét! Vetëm tani në ecje e kuptojmë. Njëri pérplaset pas degëve të ndehura deri përdhe, mallëkon pishën e ngrihet duke pështyrë. Kujtimi dhe Tefta heqin një partizan që mezi capitet.

Heshtja prishet vetëm nga krisma e borës. Askush s'flet. Kohë më kohë dëgjohet një zë i mbytur që i përngjet më shumë shushurimës së pishave se sa zërit të njeriut. Befas dëgjohet një krismë arme, pastaj një breshëri e gjatë mitralozi. Plumbat fishkëllejnë mbi ne. Të parët e kolonës hapën zjarr. Nga zjarri i armëve kuptohet se jemi ballë pér ballë me armikun.

Luftha ndizet e ashpér me batare të fuqishme e me

kryqëzime të çuditshme zjarresh. Duket sikur po xhindosen edhe malet.

— Këta paskan municion, jo shaka — dëgjoj zërin e Kujtimit.

Zjarri i stuhishëm po vazhdon me një monotoni të qëmendur. Shrapnelat pëlcasin në erë si fishekzare e bien në tokë me tërsëllëm si shi i përvëluar. Dëbora po bëhet shoshë.

Tri herë hidhemi në sulm e tri herë prapsemi. Armiku ka pozita të forta e s'tundet kollaj që andej. Duhet menduar mirë. Duhet bërë diçka. Dalin vullnetarët. I pari është Kujtimi me Stefin, por komandanti është në mëdyshje. Vdekja e Gurkës e bren e tani duhet të përsëritet heroizmi i tij. Rrugë tjetër s'ka, dhe të qëndrosh kështu i gozhduar në vend për të kurssyer një jetë e pér të humbur shumë të tjera është marrëzi. Duhej të çuhej një shteg me doemos, kjo ishte një nevojë e ngutshme. Por a do të mjaftonin dy, tre ose pesë vullnetarë? Jo, kjo ishte e pamundur. Zjarri ishte tepër i rëndë dhe i shumanshëm. Armiku na kish marrë krahët.

Shikoj fytyrat e partizanëve e përpinqem të zbuloj mendimet e tyre; e kuptoj fare mirë dëshirën e tyre të zjarrtë pér të çarë tejpërtej këtë rrith.

Shtegu i fundit është mbyllur. Dara sa vjen e po shtrëngohet fort e më fort. Tre gryka mitralozësh vjellin zjarr e hekur mbi ne. Ç'do të bëhej vallë sikur të ish ditë?...

Komandanti rrötullon kokën e përpinqet të vështrojë ata që i kap syri, tund armën në ajër e, para se të hedhë çapin përpara kolona, ngrihet njëherësh më këmbë e turret si një vallë e fuqishme e paepur që shtyp e dërmont g'gjen përpara. Ne buçasim si një zë i vetëm e jo si dyzet zëra, e në mes të vilkamës e poteres shungulluese, zbratzim mbi armikun tërë bombat e granadat që na ndodhen. Dy mitralozë armiq u bënë çikë e thërrime.

Dritat e agimit kanë zënë të feksin. Dëbora ka

pushuar, por thëllimi të gërvisht fytyrën si me thonj. Ecim në formacion lufte. Armiku prapset duke rezistuar. Plumbat fluturojnë si zogj të çakërdisur. Kjo kthesë e përnjëherershme na ka mbushur me gjëzim të madh.

Arrijtëm në një pyll. Gjylet e bombat kanë çapëluar e përzhitur drurët këtu. Heshtje e thellë. Vjen erë tym e barot. Për çudi shikojmë se paskemi mbetur shumë prapa. Tefta, Kujtimi, Stefi e unë qenkemi shkëputur nga shokët.

— Paskemi humbur rrugë — thotë Stefi. — Po ky gjak c'është kështu?

— Është gjaku im!

— Ti, Kujtim, s'je fare në vete — ja priti Tefta duke e vështruar butë e me dhëmshuri. — S'ke gojë të thuash një fjalë... Uh, c'njeri i çuditshëm!

E ndërkohë që po ja lidh kofshën e djathëtë të shpuar tejpërtej, ankohet dhe e qorton Kujtimin. Ai bën sikur s'e dëgjon e pulit sytë e përkuqur, që e kanë humbur shkëlqimin e parë. Mollëzat e faqeve të zbehta i dridhen pa pushim, hunda i ka marrë ngjyrën e limonit e dhëmbët i kërcasin nga dhëmbja.

Jam prekur thellë e s'di ç'të them. Më vjen edhe keq edhe inat. Stefi e vështron me një sy të çuditshëm dhe tund kokën në shenjë talljeje.

— Ti, more djalë, qenke hasm i vetes, por, siç duket, paske gjak të tepërt... Hajde, kokë shkëmb, hajde!

Nisemi. Drejtimin e shokëve nuk e dimë. Gjurmët janë fshirë ose, në këtë zonë, s'ka fare. Pak më vonë Stefi njohu vendin.

— Këtej duhet të bjerë Osoja — tregoi me dorë veriun ai.

— Je i sigurt?

— Po, po. Më kujtohet kur kaluam kësaj ane në vjeshtë.

Marshimi ynë është i ngadalshëm. Kujtimi tani s'e përdor këmbën fare. Ajo s'i bindet. Qëndrojmë shpesh

e çlodhemi se dëbora mezi çahet. Kujtimin e kanë kaphar dhëmbjet.

— Duhet gjetur ndonjë marifet, kështu s'do të sosim dot — thotë Stefi.

— Ç'të bëjmë?

— Të ngremë një sajë!

— Sajë!... Pa dale, s'e ke keq. Po si s'të ra ndër mend më parë?

— Mos humbni kohë, vëllezër, por hënë kështu si jemi. Shokët s'besoj të jenë larg.

— Ti s'ecën dot, Kujtim. Kështu do të dërmohesh fare. Stefi ka të drejtë.

— Pse, kaq u bëra unë... për në tezgë?!

E lëmë Teftën t'i mbushë mendjen Kujtimit e ne zëmë të ngremë sajën. Thyejmë degë bredhi, i thurim e i lidhim me copa litarësh mëndafshi prej parashute. Pas disa minutash del një farë saje e lehtë dhe e volitshme. E vëmë Kujtimin mbi të e marrim rrugën.

Tani e kemi më lehtë. Degët shkasin aq mirë mbi cipën e ngirirë të dëborës sa në të tatëpjetat saja na vë përpara. I plagosuri mbahet pas degës së trashë, që shërben si timon e këmben ngadonjë fjalë sa për të na mbushur mendjen se është mirë. Hedh edhe romuze, por pamja e tij tregon vuajtje e dhëmbje. Ai është shumë i duruar e bën aq shumë që ta mbajë vreten sa ne na torturon. Mjafton t'i vështrosh sytë e zverdhur, mjekrën e varur e qafën e zgjatur e të holluar që të bindesh se s'i ka mbetur pikë gjaku.

Tefta ecën prapa sajës e ngarkuar me trastën dhe pushkën e Kujtimit. Në pushimet e shkurtëra i shtronëgon fashot për t'i ndalur gjakun. Bën ç'ti vijë për dore për t'ja pakësuar dhimbjen. Sytë e saj të mëdhenj e të butë si të një mëshquerre, ndonëse të drobitur, qeshin pareshtur. Gishtat e këmbës i kanë dalë fare jashtë. Stefi do t'i japë një këpucë edhe unë po i lutem, por

ajo s'pranon, buzëqeshëm bësi i buzëqeshëm nëna fëmijës e vazhdon rrugën.

— Ju lodha, vëllezër, — thotë me zë të këputur Kujtim. — Lermëni gjëkundi, mos humbni kohën me mua.

— Ja edhe një marrëzi tjetër.

Kujtimi pa sytë e zez të Teftës, bëri buzën në gaz e s'foli.

* * *

Po ecim mbi një shpat të thepisur. Këmbët na dridhen. Saja rrëshqet, litarët janë tendosur jashtë masës. Me pushkët që përdorim si shkopinj zgjedhim vendin. Pushojmë. Udhë po na i shter fuqitë dalëngadalë e pas çdo pushimi aq më të ronitur e ndjejmë veten. Dëborë bie përsëri. Edhe pak e dë të vijë nata e zezë, e akullt me fishkëllimat e erës së tërbuar. Hedh sytë përreth e nuk shquaj veç borën, që shtrihet tej e mbanë. Them me vete: «Mos po ecim kuturu?»

Stefi duket i menduar; dika e mundon. Picëron sytë. Diçka mundohet të dallojë.

— Duhet gjetur një strehë për të kaluar natën. Kam frikë mos mbetemi në dëborë e zor të gdhihem të gjallë.

— S'do të arrijmë dot në Osojë?

— Kemi marrë një shteg tjetër. Kjo udhë s'të shpie atje. Më duket se kemi ecur kot, ta marrë djalli!

Stefi kap tëmthat me duar, i shtrëngon fort e lan fytyrën me dëborë. Kujtimi po na vështron me një buzëqeshje të lehtë e, sikur të mos iu japë fare rëndësi fjalëve tona, ja merr këngës. Ne i shkojmë pas me zëra të ngjirur, fallco, pa ton. Vetëm zëri i Teftës éshëtë i shkrifët e i bëmbël. Ky zë na mbush me gëzim. Kështu e ndjejmë vetën më mirë, kënga na përtërin forcat.

Papritur shkojmë përpëra faqet e ca shkëmbinj-

ve të hirtë e të mëdhenj të cilëve bora u rri si kapuç i butë mbi krye. Më tej nxijnë trungjet e përthara të drurëve. Ndonjë pyll përsëri. Edhe pak sa të shkëputeshim nga ky shpat i mallëkuar; në pyll mbasse do të ishte më mirë.

Instinktivisht ecim drejt shkëmbinjve, pa marrë mendje nga njëri-tjetri. Askush s'thotë ku shkojmë e pse shkojmë këtej, veç ikim, nxitojmë që të shpëtojmë sa më parë nga ky thëllim i tërbuar, që të përthan e të ngre si pupël në këtë shpat.

Ja edhe gurët masivë, në të cilët nxin një si gojë e madhe. Shkurre të thata të lyera me borë e akull u varen shkëmbinjve si perde tyli, e ajo goja e zezë qenka një vrimë e stërmadhe trëcipshe. Pranë gojës së zezë, dëbora vërtitet e ngrihet përpjetë si një re e bardhë dhe e shkumëzuar. Të duket sikur kjo gojë shfryn shkumë e avull.

Afrohemë. Marr pushkën në dorë e, pasi ja heq sigurecën, hyj brenda. Ndjej se po shkel mbi zall. Disa çape më tej nuk duket asgjë, veç një masë e zezë e palë-vizhme, që i përngjet fundit të një pusi. Dhe kjo errë-sirë duket sikur griset nga çurka e një currili uji të padukshëm. Shtrij duart përpara, anash e prek ca faqe guri të ftohta e të lagështa. Një afsh i lagët më përkëdhel fytyrën e akullt e të mpirë. Veshët më buçasin nga studia. Marr frymë thellë e fërkoj sytë sikur kjo punë të më ndihmojë që të shikoj më mirë. Kthehem e u dal përpara shokëve.

— Një shpellë e mrekullueshme, e ngrohtë dhe e qetë. Ejani të shikoni.

Kujtimin e futëm brenda me gjith sajë e në kokë i vumë trastën si jastëk. Tefta po i fshinte dëborën nga fytyra. Dora i dridhej fort e diçka të pakuptueshme pëshpëriti nëpër dhëmbë. Tjetri e shikon me ata sytë e drobitur që s'ka fuqi t'i lëvizë. Fryma e tij e vakët lëmon faqet e vajzës, që tanë po i marrin ngjyrë nga që thëllimi ja ka rahur ditë me radhë. Jashtë dëgjohet ulërima e tufanit, që përplas degët e lisave duke i tun-

dur e shkundur me forcë. Kërcëllitja e degëve, që thyhen e çapëlohen, vjen deri tek ne.

Mbledhim dru e mundohemi të bëjmë zjarr. Stefi nxjerr urorin, por s'e mban dot strallin. Duart s'i bëjnë. Provoj edhe vetë, por më keq. Férkojmë duart me dëborë, i ngrohim me frymë, i futim nën sqetulla, por as që vinë në vete, njësoj si këmbët që pas këtij qëndrimi na duken të rënda sikur t'iu kemi varur gurë.

Tefta po i ndërron plagën Kujtimit. Shikoj fashot e përlyera me gjak. Jo, ato s'mund të përdoren më, prandaj, në mungesë të lidhseve të reja, përdorim shaminë e qafës. Këtë punë e bëjmë instinktivisht, pa na e lypur njeri, veç duke ndjekur shembullin e Teftës.

I plagosuri mban sytë mbyllur, s'do të shohë se q'bëhet me këmbën e vet. Kështu, ndofta, mposht dhëmbjen.

Më në fund ndezim zjarrin. Shpella llamburit nga flakët. Tymi i bardhë i déllinjave e me erë të këndshme fillon të luhatet nëpër faqet shkëmbore, shtillet si uji në gjeratore e del me gulfë nga goja e shpellës.

Pas pak dëgjuam një zhurmë të mbytur. Shpella u tund e një valë ajri e ftohtë u përplas mbi muret shkëmborë. Flaka e zjarrit u platis, vezullimet e dritës, që u jepnin ngjyra gurëve dhe ujit, humbën me një herë. Përsëri ajo masa e zezë u shtrit në shpellë. Shikojmë vetëm thëngjiftë, që shkëlqeijnë si një tok xixëllonja dhe ndjejmë hidhërimin e tymit, që po na djeg sytë.

— Ç'u bë kështu?

Stefi i përgjumur çohet më këmbë e të dy drejtohem i nga hyrja e shpellës. Bëjmë dritë e përpinqemi të marrim vesh ç'ngjet. Dhe i shkrifët i përzjerë me borë e gurë derdhet në këmbët tona; shpella dridhet e ne prapsemi vetvetiu.

Është e qartë. Orteku i borës ka mbyllur hyrjen. Këmbejmë shikime. Në sytë tona është po ai shkëlim, që kanë edhe thëngjiftë. Tefta shtrëngon dorën e Kujtimit dhe është shastisur fare nga kjo e papritur.

Heshtje. Një heshtje e frikshme. Dëgjojmë fryshtës marrjen. Vjen erë dhe, dhe tymi po bëhet edhe më i hidhur. Sytë na djegin e na përvëlojnë.

— Të shuajmë zjarrin, shokë! — thotë Tefta. Duhet të kursejmë oksigjenin sa të çelim një vrimë.

Në çast, Stefi mbushi duart me dhe e me dëborë e sakaq zjarri u platisht.

Asnjë lëvizje. Asnjë zhurmë. Jemi si të paralizuar. Jam mbështetur pas mureve të shpellës se më buçet koka. Vë dorën në ballë, në barkun e thelluar si gropë e në xhep. Gërmoj mos gjej ndonjë kokërr misër, gëlltim sa për të gënjer veten e mbahem pas gurëve.

— Mos do të presim kështu sa të na mbulojë dheu?

Fjalët e Stefit më sollën në vete. Tefta lëvizi nga vendi e filloj bashkë me ne të gërmojë dhe e dëborë.

Guri janë të ftohtë, të qulltë e të shkasin nëpër duar si peshku në rrjetë. Dheu bëhet baltë. Kujtimi lëshon ca rënkim, që të ngjethin. E marr me mend sa vuani e sa zor e ka të mposhtë dhëmbjen. Fuqia e ka lënë fare e gjymtyrët i ka të rënda e të plogëta nga gjaku që ka humbur.

Më në fund s'u ndie zëri i tij. I shkoj pranë dhe përgjoi. Ka humbur në gjumë. E unë mendoj: «Në këtë gjumë të rëndë, në prehrin e kësaj shpelle të zezë e të ftohtë, ai, ndofta, éndërron të ardhmen e lumtur».

Dua t'ja shfaq edhe Teftës këtë mendim, edhe Stefit, por ata punojnë me mish e me shpirt duke pasur mendjen te Kujtimi e te orteku i borës, që mbylli shpellën. Prandaj s'dua t'i bezdis me fjalë, se puna më e parë në këtë çast është të heqim sa më shumë gurë, të gërmojmë sa më tepër dhe e borë.

Punojmë gjatë kështu, rropatemi sa mundim të mbytur në djersë e baltë. Dëbora e ngrirë na i mpin e na i ther mishrat e gishtërinjve. Në mes të gulçimeve tona dëgjohet një murmuritje, pastaj një zë i mbytur. Kujtimi flet nëpër gjumë, flet përcart e asnjë fjalë s'i kuqtohet. E dëgjojmë disa çaste e vazhdojmë përsëri punën.

Dëgjohet përsëri Kujtimi. Një kollë e thatë po ja çjerr fytin. Është në ethe, digjet si zjarr. Ja, po bie në kllapi.

Gërryejmë dhe e shkulim gurë me thonj. Kujtimi ka nevojë pér ajér, ai po vdes!

Afshi i rëndë, i lagët e i hidhur mbulon guvën e thellë si varr e po na asfikson. Gérhima e thellë, që gërvisht gjoksin e të plagosurit na ngjëth mishin. Po vjen në vete. Diçka belbëzon... kérkon ujë. Tefta çan errësirën, duke shtrirë duart pérpara si një e verbër, fut shaminë te currili i ujit, që qan parreshtur e i njom buzët e i lag ballin të sémurit. Por ai kérkon përsëri ujë, ujë.

Zéri i Kujtimit pëshpërit fjalë pa kuptim, fjalë të ngatërruara ose copa fjalësh, por ky zë është si një forcë pér ne, tingëllon si një lutje pér dritë, pér ajér e pér jetë.

Kokën e kam të mpitë, kurse gérhima e frymë-marrjes së Kujtimit me çjerr zemrën. Çapet e Teftës, që shkon te currilat pér të marrë ujë, bëjnë një zhurmë që më duket e largët, fort e largët, si një kujtim i fëminisë. Atje Kujtimi rrropatet, belbëzon, rënkon. Grahma e tij më sillet rrrotull, më fshikullon témthat, më ngjeth mishin, më ndrydh muskujt. Kjo trazirë më vjen herë pas here; pastaj, si më qetësohen nervat e më kthjellohet truri, e shikoj veten të pushtuar nga një dëshirë e vetme dhe e pamposhtur, nga dëshira pér të çelur një vrimë në këtë varr të qullët, aq sa të shoh një njollë drite të bardhë mbi ftyrën e Kujtimit.

Me duar të përlyera me gjak, shkulim një copë shkëmbi me brinjë të mprehta si tehu i thikës. Në çast shembet një copë dëbore e madhe e ngjeshur fort, si top, që na shtyn pérpara, e një njollë drite zbardhi mu pérpara syve tona.

— Dritë! — bërtasim.

Dritë e ajér i ftohtë u derdh në shpellë. Te këmbët e Kujtimit u sajua një vijë e bardhë drite. Kujtimi, i tretur në ftyrë, me sy fare të shuar, dergjet atje.

Një buzëqeshje e hidhur i ka ngrirë në buzët e përthara e përpinqet të marrë frymë sa më tepër. Shikimi i tij po tretet te vrima e guvës. Tefta, e ulur më gjunjë pranë tij, e bardhë dhe e zbehtë si drita e hënës, i njom buzët me shaminë e lagur. Ne po zmadhojmë vrimën.

Jashtë është dritë. Pra qenka gdhirë edhe një ditë e re. Bën ftohtë. Trupi i qullët si balta e i ftohtë si gurët, më duket si i veshur me një cipë akulli që ma tkurr lëkurën. Tufani ulërin e fshin si me fshesë dëborën, duke zbuluar një kallkan të xhamtë. Qielli është i mugët. Ai shpati i thepisur, tek i cili mënt u gremisëm një ditë më parë, duket larg ose s'egziston fare e sikur s'kemi kaluar fare andej, por ndodhemi këtu prej kohësh.

Bëjmë zjarr. Ngrohtësia e tij na kapit fare. Mishi s'na e duron dot këtë të nxehjtë. Kockat e shtypura e të ndrydhura që sikur të na i kenë nxjerrë nga dheri na djegin e na çajnë.

Kujtimi është pak më i qetë. Tek e vështroj, më bëhet sikur s'më ngjet fare me Kujtimin tonë me të cilin kemi luftuar e jetuar, por me një tjetër që s'e kam parë kurrë, tiparet e të cilil me shëmbëllejnë me ato të Kujtimit. Vështrimi i tij është i përmallshëm e ajo buzëqeshja, që i ka ngrirë në buzët e zbehta, duket sikur s'është e tij.

Ai zgjat dorën e kap timen pastaj të Stefit. Gishtë-rinjtë e ftohtë, të dobët e të pafuqishëm i dridhen.

— Eh vëllezër, kot e humbët kohën me mua, do të ishit bashkuar me shokët...

— Ne do të bashkohemi që të katër, Kujtim, dhe së bashku do të luftojmë përsëri në vijën e parë.

— Nuk them se s'do të luftojmë...

Kujtimi është njeri i çuditshëm. Shpirti i tij të mbush me zjarr, dhe ne as që përpinqemi t'i japim zemër. Ai qëndron i fortë si shkëmb edhe pse është në çastet e fundit të jetës. Zëri i tij, nga çasti në çast, po bëhet më i pafuqishëm, këputet në mes dhe fjalët e përgjysmuara i thotë copa-copa. Tefta ja njom buzët vazh-

dimisht me shaminë e lagur. Pas një çasti qetësie, ai fillon të mërmëritë nëpër dhëmbë. Po këndon. Edhe ne këndojojmë. Shpella buçet dhe të duket sikurjeta po rilind tek ai. Pastaj e ul zërin fare, sytë i shkëlqejnë fort dhe po aq shpejt, siç kanë marrë gjallëri, ashtu e kanë humbur dritën dhe janë shuajtur fare.

Sapo e kishim varrosur shokun, kur dëgjojmë krisma armësh. Ato sikur ranë nga qielli, apo sikur plasën nga dheu, por buçitën fare pranë.

— Gati, shokë! — tha Tefta. -- Gjakun e Kujtimit le ta lajmë me gjak dhe emri i tij le të mbetet i gjallë e le të na mbushë me guxim!

Zumë grykën e shpellës. Armiqtë po tërhiqeshin e po vinin drejt nesh. Shokët po i ndiqnin këmba-këmbës. Tani qe radha jonë. Zemra na gufonte, por asnjë nuk po shtinte. Mos donim t'i zinim me dorë? Jo, ne pritëm që të vinin aq pranë, sa të mos kishin kohë që të iknin më.

D E S H T I M I

Kolonel Karpi, pasi erdhi rrotull disa herë nëpër zyrën e tij luksoze, shkoi te dritarja, futi duart në xhepet e pantallonave e hodhi sytë përtej xhameve. Qëndroi gjatë atje e ndoqi me sy gjithë lëvizjet, që bëheshin në atë rrugë aq të bujshme.

Se ç'mendoi ato minuta, zor ta themi, mbasi koloneli ishte një njeri i çuditshëm. Ndihmësi i tij thosh «Shefi im, atë që bën sot, natyrisht e ka menduar e stërmenduar një muaj më parë».

Por, atë ditë, koloneli s'ish aq i qetë. Shkoi heret në zyrë; deri në mes ditë nuk foli me asnjeri e ndihmësin e thirri vetëm një herë.

Si u shkëput nga dritarja, u ul në tavolinë, hapi dosjen që kish përpara e nguli sytë. Mori në dorë një fotografi e zuri ta vrejë me kujdes.

Në të, ishte një fytyrë burri me një kokë të mishtë me ca sy të vegjël, të përhimtë si pa jetë e me një grumbull flokësh të dendur e të dredhur në ngjyrë të gështenjës. E pa aq shumë sa iu duk sikur i lëvizte nëpër duar. E vuri në vend, mbylli dosjen dhe shtypi butonin elektrik që ishte mbërthyer në cep të tavolinës.

Në çast u hap porta e që andej hyri ndihmësi, një major i vjetër me trup mesatar, i pakët dhe shumë i shkathët për moshën e tij. Ndihmësi nuk qëndroi te porta duke pritur urdhërin e eprorit, as tërhoqi takat, as përshëndeti as foli, por eci drejt tavolinës së kolo-

nelit dhe qëndroi në buzë të saj duke i ngulur sytë shefit. Ky i fundit ngriti kokën dhe, para se ta shikonte, pyeti:

— Sikur edhe ky të dështojë, çdo të më thoni pastaj?

Ndihmësi shpuri buzën në gaz, u mendua pak e tha:

— I kam marrë të gjitha masat që të mos ndodhë asgjë e tillë!

— Unë po ju pyes: sikur të dështojë?

E, duke u shqitur nga tavolina, e kapi për krahu miqësish.

Përsëri u drejtua nga dritarja, por këtë herë nuk qëndroi veç sa hodhi një sy, dhe u kthye përsëri në tavolinë.

— Ulu — i tha.

— Hm... ç'do të më thuash? — pëshpëriti nëpër dhëmbë me sytë te letrat e dosjes që po shfletonte.

— Unë kam parasysh se ky është më i sprovuari, zoti kolonel, dhe nuk besoj të kem humbur kohën me të. As instruktorët.

— Oh, plaku im, sa më gjëzon me këtë optimizëm. Po përsë të mos jua përsëris se ky optimizmi juaj bie erë tuafllëk?

Majori s'e prishi qejfin, nënqeshi e, tek po e shikonte në sy, po mundohej të zbulonte q'gjë e brente. Pastaj, duke marrë pamje serioze, foli:

— Duhet të kemi besim, zotni.

— Gjithmonë kështu kini thënë e gjithmonë kini dështuar. Dhe as e kini fare parasysh se këta shqiptarët po m'i prishin nervat! ...Do të doja të kisha gjakun tuaj, por edhe ashtu prapë më ngacmoni.

Majori kafshoi buzën e poshtme, lidhi duart përrapa, siç bën nxënësi në klasë, e shqiptoi me zë të ulët e fjalë të prera:

— Atëherë mund të mos e përjashtojmë dështimin, por kjo mund të ndodhë kur agjenti t'ja ketë mbërrijtur qëllimit!

— Ç'është kjo alternativë e çuditshme?
— Është parashikuar, por, sidoqoftë, ai s'do të flasë!

— Kështu si e kini zënë, ju do ta zhdukni tërë kampin!... Mirë, pra, zhdukini, aq më bën, s'do të shpenzojmë më për të ushqyer këta derra.

Koloneli u qetësua, por dukej se mendjen e kish përsëri te agjenti e në çast mori fotografinë në dorë, të cilën, pasi i hodhi edhe një sy rrëmbimthi, e hoqi mënjanë dhe mori një fletë kartë, ku ishin shkruar karakteristikat e agjentit.

— Këtu thuhet se Gestapos i ka shërbuer pa kursim.

— Po.

— Se nga amnistia nuk ka përfituar.

— Jo.

— Se disa të afërm ja kanë shpronësuar.

— Po.

— Atëhere ç'mund t'ju them? Ngandonjëherë më duket se ju ma mbushni kokën para kohe. Mirë, pra, s'kam kundërshtim, le të niset.

Majori përkuli kokën në shenjë falënderimi.

* * *

Në kabarenë «Dritat e Elerta» s'kish vend ku të hidhje mollën. Orkestra bënte aq shumë zhurmë sa zëri i këngëtores mezi fitonte mbi tingujt e çjerrë të klarinos, ndërsa xhasbandisti s'pushonte së fshiri me brushë daullkat e çaparet e shkëlqyeshme. Shumë nga ata që ishin ulur pranë orkestrës, ishin rrëmbyer nga zëri i këngëtores, e cila ish veshur shumë hollë. Mishi i saj i bardhë në kofshë, kraharor e shpinë i ngacmonte pa masë ata bandillë, prandaj edhe ajo s'pu-

shonte së treguari herë këmbët, herë vithet, herë gjinjët e fryrë.

Kur hyri majori, këngëtarja kish zbritur nga podiumi e po këcente midis tavolinave të mbushura me lloj-lloj pije. S'qe një ai që i lutej të qëndronte një minutë në tavolinën e vet, por ajo falënderonte e rrëshqiste si në akull, duke shpërndarë të puthura me dorën e saj të vogël e të bardhë. Majori i nguli sytë, qeshi e, si nuk i zuri syri vend të lirë, u ul në banak.

Porositi vermut. Në çast i vunë përpara gotën e kristaltë me fron të gjatë si qafë pate, brenda në të cilën notonte një riskë limoni. E hoqi me shijë e, pasi lëshoi gotën, ktheu kokën andej nga vinin sokëllimat. Këngëtarja i dërgoi një të puthur e ky ja ktheu po ashtu, qeshi pa zë e tundi kokën në shenjë aprovimi. Mori gotën dhe e ngriti.

— Për shëndetin tuaj, ëngjell i dashur!

Që prapa dëgjoi një zë, ktheu kokën e pa Billin.

— Mirë mbrëma, Bill!

— Oh, zoti Pop, ju qenki në tokë e unë po ju kërkoj në qiell!

— Edhe ju paski rënë në tokë, miku im; si kështu, qenkeni i lirë?

— Fare i lirë — mblodhi buzët tjetri. — U bënë dhjetë ditë që s'kam flutuar.

— As ditën s'kini flutuar?

— Unë fluturoj gjithmonë natën, zotni!

Qeshën me zë, e majori kërkoi dy gota të tjera.

— Do ta pi me gjith qejf, vetëm urdhëroni të fluturoj, jam gati që tanë. M'u mërzitën këto kabaretë e mallëkuara, më duket sikur këtu ma thithin gjakun.

— Do të fluturojmë, Bill, që sonte!

— Vërtet që sonte?!

— Që tanil... Ikim.

— Nën urdhërat tuaja, zoti major.

Jashtë Billi pyeti:

— Do të shkojmë larg?

— Jo shumë.

— Bukur!

— Më prisni në aeroport; për një orë jam atje.

Billi nderoi e ndoqi me sy automobilin, që u zhduk me shpejtësi në rrugën e drejtë. Pastaj ngriti sytë nga qielli dhe pa yjtë. Hëna s'kishte dalë.

Major Popi eci me shpejtësi e, kur u ndal përpara ndërtesës së kampit, frenoi aq fort sa rrotat rrëshqitën mbi asfalt duke lëshuar një fishkëllimë të mprehëtë.

— Do të thyej kokën ndonjë ditë ky i marrë — pëshpëriti roja duke nderuar.

Përgjegjësi i kampit, një kapiten i trashë e i plogët, mezi lojti nga vëndi kur hyri majori.

— Mirë mbrëma, zoti major, q'e mirë ju solli në këtë orë?... Urdhëroni, uluni të pimë nga një gotë.

— Oh, ju! — e ndërpren tjetri — gjithmonë uluni të pimë thoni, dreqi t'u marrë me gjithë ato shishe!

Kapiteni afroi karrigën dhe majori flaku kapelën në një divan aty pranë.

— Më sillni «njëzetetreshin»!

— I erdhi radha edhe këtij?

— Shpejt, mos humb kohë! Nuk shikon se po nxitoj?

— Për një minutë do të jetë këtu, zotni.

Popi ngriti receptorin.

— Gatitni pajimet dhe më dërgoni «njëzetetreshin» — urdhëroi me zë të thatë.

Ndezi cigaren dhe hodhi këmbën mbi këmbë. Thithi tymin thellë e zuri të bëjë rrathë. Bëri nja tre me radhë. I katërti iu prish. Shohti cigaren me inat e u ngrit. Atëherë u çel porta e në prak të saj u duk «Njëzetetreshi». Majori i doli përpara e, duke i zgjatur dorën, foli tërë qejf:

— Ndofta s'më prisnit në këtë orë, por ardhë t'ju gëzoj me një lajm të mirë...

I porsaardhuri u hutua, i qepi sytë e përhime; faqet i muar një çehre të kuqe e, pa nxjerrë fjalë nga goja, priti të dëgjonte lajmin e mirë.

— Urime, miku im... Ju thërresin në kryeqytet! Duhet të niseni sa më shpejt. Tani jepini lamtumirën kapitenit.

Kapiteni i shtrëngoi dorën, i uroi rrugë të mbarë e, duke e përcjellë, shtoi me dëshpërim:

— Kujtomë mua të mjerin që u kalba në këtë *provincë*. Kur të ma sjellë rasti të vij në kryeqytet, do t'ju kërkoj.

— Do të më gëzoni — ja bëri «njëzetetreshi».

Kur automobili mori shpejtësinë, agjenti pyeti:

— Vërtet më thërresin në kryeqytet?

Majori qeshi me zë e, sikur të fliste me vete, tha:

— Ju thërresin në Shqipëri, miku im!

— Në Shqipëri?

— Po. S'ju ka marrë malli për atdheun?

Një pshëritimë e lehtë i shpëtoi tjetrit. Pastaj ndjeu të ngjethura.

— Do të niseni që sonte — vazhdoi majori me ton urdhëronjës. Do t'ju përcjell. Andej e dini q'do të bëni. Lajmëroni ngritjen e grupit, aksionin e parë, çdo gjë. Duam informata, sa më shumë, sa më tepër të jepni, aq më tepër do të fitoni. Udhëzimet i kini të freskëta.

Disa minuta s'këmbyen fjalë. Agjenti ra në mendime, kurse major Popi e shkeli gazin deri në fund.

Befas e ngadalësoi shpejtësinë e, pas një çasti, frenoi. Kishin arrijtur në aeroport. Hekurat e portës së madhe shkëlqyen përpara dritave të automobilit. Pas disa sekondash, sikur ta komandonte vetë major Popi me levën e marshit, porta u hap dhe automobili rrëshqiti në pistën e ndritshme. «Njëzetetreshi» u drodh kur pa se përpara tij shtriheshin krahët e zez të një aeroplani dymotorësh. Atëhere e mblođhi. E ndjeu veten aq të plogët sa s'kish fuqi të zbriste, por majori e shkundi me fjalë të prera:

— Zbrit!

Billi ish mbështetur në njërin *nësa* krahët e aero-

planit e thithte i qetë puron e parfumuar, që përhapte një aromë të këndshme. Kur u afroan udhëtarët, ai u doli përpala e u tregoi shkallët.

— Jam në dispozicjonin tuaj, zotërinj; mund të nisemi.

— Bukur, bukur, Bill, ju çmoj së tepërti — ja priti majori e i rrahu supet.

Agjenti i hodhi një vështrim të vëngër.

Dy pilotët e tjerë kishin zënë vend e as u hodhën sytë udhëtarëve, ndërsa major Popi e hoqi agjentin pas dhe e drejtoi nga fundi i aeroplanit.

— Ndërrohu — e urdhëroi.

Kur preku rrobat e shajakta, si ato të barinjve, iu drodhën duart. U vesh e u mbath si bari. Shtrëngoi kollanin nën xhaqetë e lidhi në të këllëfin e thikës e të revolverit. Pastaj hodhi çantën me ushqime pér pesë ditë, vari në qafë radiotransmetuesin dhe automatikun.

— Bukur — tha i kënaqur majori, duke i lëshuar në dorë pashaportën së bashku me një qese lëkure të rëndë.

— Tani për tani do t'ju mjaftojnë.

Njëzetetreshi futi paratë në xhep e hapi pashaportën. Majori e kish pagëzuar me emrin Astrit Salimllari! Si vendosi edhe pashaportën në xhep, hodhi rripat e parashutës. Këtë radhë i erdhi në ndihmë Billi, i cili ja shtrëngoi aq fort sa mezi merrte frymë.

— Bukur, bukur, — përsëriti majori; — tani eja të ulemi.

Agjenti mezi ecte, aq ish rënduar. Kishte vapë e rripat që i kryqëzoheshin në shpinë e kraharor sikur po e mbytnin dalëngadalë.

U ulën pranë kabinës së pilotëve e, sa zunë vend, majori urdhëroi të niset aeroplani. Pilotët vunë ku fjet në vesh dhe befas buçitën motorët. Ajri i rrahu nga helikat ulëriti e skapamentot lëshuan gjuhë flake të gjelbër. Buçima e motorëve u bë më e thekshme kur u nis aeroplani.

Ndezën nga një cigare. Nga kabina u dëgjua zëri i Billit:

- Ju lutem, zoti major, më jepni drejtimin.
- Shqipëri, kuadrati i zakonshëm!

Billi e ktheu maqinën majtas e fillooi të marrë lartësi.

Sipër nata ish e errët, megjithëse yjtë shkëlqenin. Motorët rënkuani edhe një herë pastaj sikur u lehtësuan e aeroplani mori shpejtësi normale.

Majori e shikonte agjentin me bisht të syrit, ndërsa Billi vërvhellente meloditë që kish dëgjuar atë mbrëmje në kabare.

Ajgenti ndezi një cigare të dytë; ish i shqetësuar e, që kurse mori vesh se do ta hidhnin në Shqipëri, iu prenë fjalët. Ai ish pregetitur me kujdes për atë punë, kish dhënë prova aftësie e majori, veçanërisht, priste shumë. Por tani truri i ziente, veshët i buçisnin e nuk e mblidhët dot veten. I dukej sikur sapo t'i zinin këmbët dhe, do ta kapnin menjëherë. Zgjatë kokën në dritare, merrte frymë thellë, shikonte qiellin e zi, që shpohej nga yjtë e ndritshëm e sikur merrte pak zëmër. Kur hiqte sytë nga dritarja e shikonte majorin, i dukej sikur do t'i merrej fryma.

— Përpiku të strehohesh që sonte — theu heshtjen majori. — Doemos që sonte, ndryshe do t'i hapësh telashe vetes.

— Do të përpinqem, zoti major.

— Ashtu, miku im, ashtu duhet, sa pa dalë dita. Nesër, të shumtën pasnesër, pres lajme. Atëhere do të jem i qetë.

Aeroplani u anua djathatas, dhe Billi, pasi kontrolloi edhe një herë hartën, thirri:

— Gati, zotérinj!

Majori u ngrit, ashtu bëri edhe agjenti, ndërsa njëri nga pilotët hoqi kufjet e çeli portën. Ajri i ftohtë u derdh me rrëmbim brenda e kapela e majorit fluturoi e u rrrokullis nëpër korridorin e ngushtë të kabinës. S'ja vuri veshin kapelës, por hodhi dorën e majtë e u kap pas rripit

mbajtës, që i varej mbi kokë, ndërsa me dorën tjetër shtrëngoi atë të agjentit, që ishte e ftohtë si akull.

— Udh' e mbarë, miku im, u pafshim përsëri së shpejti.

— Natën e mirë! — bërtiti Billi.

Ndërsa agjenti u lëshua si plumb dhe piloti mbylli portën, major Popi mbajti sytë në dritare; pastaj sikur të zgjohej nga gjumi, urdhëroi:

— Ktheu, Bill!

* * *

Toger Musta hoqi çizmet e u shtri në shtratin e ngshtë e të butë. Fërkoi sytë, gogësiti e pa orën. Kishte vajtur mesi i natës, por as e kish vënë re dhe kjo i ndodhë sa herë lexonte. Ja, atë natë sapo kish mbaruar «Universitetet e mia» të Gorkit, të cilën s'e zuri më shumë se tri herë me dorë. Ushtarët çuditeshin me të e thoshnin sa herë binte rasti: «Togeri ynë, kur lexon, s'ngre kokën dhe e mbaron librin aq shpejt sikur të ishte pjatë me pilaf».

Do ta kish zënë gjumi ashtu por, kur po mbyllte sytë, i dorëzuan një radiogram. U ngrit shpejt, mbathi çizmet, që ishin akoma të ngrohta dhe doli menjëherë. Pas një ore, toger Musta me dy ushtarë kish arritur në vend.

Ndofta kjo ndodhi atë kohë, kur major Popi i shtrëngoi dorën agjentit, sepse dëgjuan zhurmën e aeroplanit e pas pak panë edhe parashutën që po ulej mbi ta.

— Kini mendjen — u tha ushtarëve togeri, — Diversanti s'duhet të pësojë gjë. Detyra jonë është të mësojmë se ku do të strehohet, asgjë më tepër. Kjo të mbahet e fshehtë.

Të tjerët u panë në sy dhe aprovuan me kokë:

* * *

Diversanti ra në mes të një korieje me dushk, pikërisht atje ku kish zënë vend e priste togeri. Disa sekonda qëndroi më kurri ashtu siç ra, pastaj u ngrit me kujdes dhe përgjoi. Asnjë zhurmë, asnjë lëvizje. Dëgjoi vetëm të rrahurat e zemrës dhe frysëmarrjen e nxituar. Me shpejtësi mblohti parashutën, e lidhi mirë dhe kërkoi vend ku ta fshihte. Togeri desh t'i thosh. «Lere atë, mos humb kohë, se po kujdesem unë».

Gjeti një ledh të ngrënë dhe e ngjeshi parashutën në rrënjet e përdredhura të ca kulprave. Rrëzoi ledhin me duar dhe e mbuloi krejt. Mori frysëmarrjen e mbajti vesh. Përsëri heshtje, përsëri ndjeu goditjen e zemrës e frysëmarrjen e nxituar.

Kur po thyhej nata e gjelat po ja thërrisinin këngës, agjenti, i ndjekur këmba-këmbës nga toger Musta, arriji në shtëpinë e xha Dautit, e u zhduk në plevicë.

Gulçonte, goja i ish tharë e drithmat i kalonin në trup njëra pas tjetrës. Disa minuta qëndroi pa lëvizur e duke shëtitur sytë nëpër errësirën e haurit. S'dallon-te asgjë veç ndjente erën e mbeturinave e të barit të thatë.

U dëgjuan këmbë. Ai mbajti frysëm e kapi armën. Atë çast pëlliti një lopë. Hauri oshëtiu e agjenti u hodh përpjetë. Kish kohë që s'kish dëgjuar zë të tillë, aq të fuqishëm. Te porta u duk një hije. Ai u fsheh mënjanë e drejtoi armën. Ishte i zotí i shtëpisë, xha Dauti, dajua i së ëmës. Futi armën në xhep e bëri dy hapa përpara.

Plaku hapi dy kanatet e portës dhe drita e vagët dhe e freskët u derdh brenda. Era e mbeturinave u ndje më e fortë, aq sa agjenti zuri hundën. Xha Dauti zuri të zgjidhë bagëtinë. Atëhere dëgjoi një zë:

— Dajo!

Plaku shtangu.

— Dajo! — u dëgjua zëri përsëri.

Ktheu kokën.

— Jam unë, dajo... s'më nje?

I zoti i shtepisë mbeti gojëhapur.

Toka iu drodh nën këmbë, veshët i buçiten e hauri sikur iu përmbyss.

— Ti, ti — belbëzoi si në ëndërr. — O perëndi... mos më bëjnë sytë?

I nipi iu afroa e iu hodh në qafë.

Plaku ish bërë dyllë, duart i vareshin poshtë e i dridheshin; shikonte të nipin e s'u besonte syve.

— Vërtet ti qenek!

— Shëët! — ja bëri tjetri. E, duke e hequr më-njanë, e shpuri nga grumbulli i barit.

Plaku e shikonte me dyshim e ftohtësi.

— Si erdhe gjer këtu, more djalë... nuk e di se këtej përgjojnë edhe gurët?

— Mua më kanë harruar tani, o dajo!

— Si ore, si, po sikur të të kenë parë?

— Vetëm nata më pa!

— Ashtu qoftë, po... as më thua, përse ke ardhur?

Agjenti hapi sytë. S'e priste kështu. Dajua e priti me këmbët e para, as e pyeti për shëndëtin, as u çmall, as e futi brenda. Kështu s'e pandehte. Po hutohej. E pa plakun në sy, bëri buzën në gaz e nxori qesen. E zgjidhi, futi dorën brenda, nxori një grusht napolona e ja zgjati.

— Merri, dajo, do të të zenë vend.

Tjetri hodhi sytë te pëllëmbla, ngriti kokën e tha me një zë të vrazhdë:

— Hiqi ato, djalë, s'kam arrijtur deri atje!

Agjenti e pa veten ngushtë. Ç'të bënte? Me përtim hodhi paratë në qese.

— Përse ke ardhur, djalë? — përsëriti plaku me ton të ashpër.

— Erdha për ju, dajo, për miqtë e për Shqipërinë! Erdhi koha të bashkohemi tanë... Mjaft i duruam hyzme-qarët!

— Ashtu ë... — tha me qesëndi plaku. — Ajo

punë shkoi e vate, po mjerë tì që e trete të ritë në dhe të huaj. Mjerë jot emë e tyt vëllezër që s'kanë sy e faqe t'u dalin botës përpara. Prandaj, në na e do të mirën, mos na bjerë më qafë.

— C'thuas kështu, o dajo?

— Them ato që duhen thënë... Dhe, po të të kenë mbetur mend në kokë e burräri në zemër, ec pas meje e dorëzohu!

— Paske lajthitur, o dajo... Mos je bërë komunist?

— Po të qeshë i ri, do të bëhesha, po tanı...

— Si, ore dajo, kështu, s'qenke më shpiptar?

Plaku tundi kokën në shenjë mohimi, picërrroi sytë e ja plasi:

— Atë fjalë mos ma thuaj mua... po nejse, ty kështu të kanë mësuar, e ti, s'do mënd, ashtu do të thuash. I mjeri ti! Po a e ke shoshitur ndonjëherë këtë punë? A e di se atyre andej aq u bën për kokën tënde?

Agjenti mbeti pa gojë. Një trazirë e madhe po i bëhej e sikur e godisnin një tok çekanë. Dajua s'e kish pasur këtë gojë, çudi si qenkish bërë!

— Mirë — psherëtiu agjenti, — kur qenka kështu, do të iki që sonte e ta zemë se s'jemi parë.

— Prit, djalë, — tha plaku me ton më të butë — mos u nxito; të thashë se këtej përgjojnë edhe gurët. Në do të shkosh si qeni në vreshtë, ikë, po mos na e bëj këtë të keqe, shtroje gjakun, dëgjomë një herë mua plakun.

Tjetri u nxeh, sytë e përhime iu përskuqën e zuri të dridhej. Të gjitha planet ja përmbysi ky plak matuf, e tanı s'e kish lehtë të mendonte si një natë më parë.

Plaku, për pjesën e tij, kish rënë në hall të madh. S'e pandehte që të piqej me të nipin. Kurrë. Atë nipçë të llastuar që s'e kish ndarë as ndonjëherë nga të bijtë, e kish hequr nga zemra qëkurse ish bërë me gjermanët. Edhe atëhere i kishte dalë nga borxhi, por fjalët e tij i kish marrë era. Dhe zemra e Dautit mbeti për-

gjithmonë e thyer se i nipi kish marrë rrugë të ligë, ish bërë ballist, tradhëtar dhe vrasës.

Kur çeta partizane shkeli në fshatin e tyre për të parën herë, Dauti, si shumë të tjerë, ndjeu entuziazëm për partizanët, i mori në shtëpi dhe u bë mik meta. Kur mori vesh se çfarë qëllime kishin ata bij të popullit, që kishin rrokur armët, i përqafoi dhe ngriti dolli, mbasi dyshimet që i kishin pushtuar kokën, zunnë t'i largohen një nga një.

Kishte dëgjuar se qe formuar një parti, se ishin ngritur çeta, të cilat luftonin kundër zaptonjësve, por për të gjitha dyshonte. Dyshimet e tij shpesh bëhen shin pothuaj bindëse. Herë të tjera dëgjonte se ata, partizanët, na qenkëshin ca kalamaj të shitur te rusi e që u kish marrë koka erë dhe qenë ngritur kundër gjithë asaj mbretërie. Pástaj thashethemet shkonin gojë më gojë, zbukuroheshin dhe stiseshin simbas qejfit të parisë së fshatit. Zeqoja, Selamiu e të tjerë ishin ata që shpifnin e trillonin gjërat më të paqëna. Ata e kishin shpallur se me partizanët s'do të përziheshin e se do t'iu vinin sinor.

Gjithë këto fjalë e kishin çoroditur Dautin dhe s'dinte kujt t'i besonte. Prandaj deshi të piqej me partizanët e të kuvëndonte shtruar, që pastaj të zgjidhë rrugën.

Dauti ish bërë patriot i shquar që në kurbet, kish punuar për atdhe, por mundi i tij kish humbur si pluhuri në erë dhe Shqipëria prapëserapë qe shitur te të huajt. Megjithatë plaku s'e kish humbur shpresën përditën e bardhë. Atë ditë e shikonte te armët e djemve të maleve, dhe atë ditë e priste të vinte shpejt.

Atëherë Dauti, me mendje të kthjellët e me besim në fitore, u dha besën partizanëve dhe u bë agitator i flakët i Luftës nacionalçirimitare. Ashtu i shkoqiti punët me parinë e fshatit dhe u nda një herë e mirë me ta. Ai s'ish i pasur dhe as që mund të vihej në sérën e Zeqos apo të Selamiut, por si kurbetli dhe burrë katërqind dërhem që qe, kish emër në fshat.

Armiqtë s'e duronin dot Dautin ëhe u përpoqën shumë ta bënin me vete, por kur e panë se s'ja arritën dot qëllimit, iu vërsulën të nipi Skënderit. Ata e dinin se ai nuk i ngjiste fare të ungjit, ja njihnin karakterin dhe lakmitë e tij, ja shfrytëzuan paditurinë, e gënjen me para dhe e veshën xhandar.

Shumë përpjekje bëri atëhere Dauti për ta sjellë në rrugë të nipin, por kur e pa se s'e mbushi dot kokën e djalit lapërdhak, i tregoi portën dhe s'e qasi më rrë shtëpi.

Skënderi shkoi shumë larg në rrugën e tij. Ai nga dita në ditë po zhytej në llumin e fëlliur të tradhëtisë e të krimit. U bë ballist i shquar dhe tregohej me gisht për «trimëri». Vetëm një detyrë s'e plotësoi dot. S'e ngriti pushkën kundër të ungjit. Dhe këtë jo nga që i vinte keq por, të thuash të drejtën, kish frikë t'i dilte përpara ungjit se e dinte që ai do ta vriste më parë. Ja njihte trimërinë fort mirë.

Dhe Skënderi u prish dhe u degjenerua dalëngadalë. Erdhi një ditë dhe emri s'i u dëgjuat më.

Kur lufta po i afrohej fundit, Zeqoja deshi të afrohej me Dautin. Edhe Selamiu deshi t'i jepte besën që ai t'i lidhte me Frontin, por Dauti, edhe atyre, si të nipit, iu tregoi portën dhe i sikterisi tutje. Pastaj vendi u qirua, u bë reforma agrare dhe u ngrit kooperativa. Fshati po merrte frymë dhe po ecte me këmbët e tij.

Kujtimet e largëta edhe e pezmatuan edhe ja kthje lluan trurin. Vështronte të nipin dhe ndjente një zemërim të papërbajtur. Ballisti, tradhëtar, qe aty, përpara tij. E vështronte, i dëgjonte zërin e ndjente si merrte frymë. Pra ish gjallë. Qe kthyer nga arratia.

E pa punën pisk. Ish në mëdyshje. A duhej t'i tregonte edhe kësaj here portën?... Jo s'do ta linte të ikte.

— C'mendohesh, o dajo, mos pandeh se erdha të të vë zjarrin?

Tjetri tundi kokën me mosbesim dhe dalloj shikimin e ftohtë të syve dinakë të të nipit.

— Unë s'kam ku tä vete. Në daç zgomë, në daç ec e kallëzo, por dije se... — dhe i zgjati prapë atë grusht napolonash që plaku ja pat kthyer pak më parë.

Dauti u mat t'i hidhej në grykë. Shumë mendje iu rrrotulluan në kokë, por asnjerën prej tyre s'e kapi. Agjenti kish marrë zjarr, sytë i lëviznin dhe fytyra iu skuq sikur t'i qe përcëlluar me zjarr.

— Të paska hyrë lepuri në bark ty, s'të paska mbetur burräri!

— Edhe këto fjalë mos m'i thuaj mua, se burrërinë di unë ta tregoj... Po meqë më erdhe mik, s'të përzë dot. — i tha plaku duke lidhur në shami florinjtë që iu drodhën në dorë.

— E po kështu flitet, o dajo.

E duke nxjerrë nga çanta një pagur bakeliti të veshur me stofë tē përhimë, ja zgjati:

— Hiqe një herë se s'ke pирë nga ky konjak.

Tani më bëj një vend këtu në haur; më mirë s'ka ku tē vejë. Sill edhe ca kashtë e bëje kapicë. Më vonë shohim e bëjmë.

— Të tē sjell pér tē ngrënë, more djalë, s'ke uri?

— Jo, nuk dua gjë, veç ujë, se pér tē ngrënë kam me vete pér ca ditë.

Si hodhi sytë përreth, vazhdoi:

— Hap sytë, dajo, mos lerë njeri tē hyjë këtu, edhe bagëtinë do bëni mirë ta milni jashtë.

— Atë punë e di unë. Do bëj një kapicë me bar këtu e do ta ndaj me gardh. Zahirenë e bagëtisë s'ma trazon njeri mua.

Tjetri i rrahu supet.

— Edhe ti hap sytë, mos dil gjékundi ditën se na more më qafë.

Kur dolën bagëtia jashtë, dielli po derdhej në fshat. Në oborr, pulat ishin mbledhur dhe po çukis-nin gërdhuzat që u kish hedhur plaka e shtëpisë. Plaku rrrotulloi sytë nëpër oborr, siç bën gjuetari kur ndjek me çifte rosën në fluturim, u thirri nuseve tē mil-nin lopët, mori latoren dhe zuri tē gdhendëtë një dhogë që do t'ja vinte basamak qerres.

Ishite fare i trullosur e i dukej vetja si mbi ujë. Futi dorën në gji e preku shaminë. Sa e rëndë iu duk, e ajo rëndësirë sikur i peshonte në gjoks e s'e linte të merrte frymë. Psherëtiu e tundi kokën.

«Eh, o i paudhë, q'më fute në turp. Pupu, q'më gjeti!»

Lëshoi latoren mbi dhogë e nxori kutinë e duhanit. Mezi e drodhi, se duart i dridheshin si purtekë. Goja i pikej, ndofta nga ai konjaku i mallëkuar që i kish mbetur si zjarr në grykë.

«Pa duhet t'i shpie edhe ujë... Helm t'u bëftë, o katil, se helm më bëre! Do të më prishësh shtëpinë, por s'do arrish dot, jo!»

Agjenti e ndiqte me sy plakun, e kur e pa se po merrej me punë. hoqi çantën, radion, rripin dhe i fshehu me kujdes në kashtë. Automatikun e municionet i vuri mënjanë, kurse revolen e futi në xheptë pantallonave e thikën nën këmishë. U shtri në kurriz, lidhi duart prapa kokës e u kredh në mendime.

E ktheu dhe e vërtiti mbarë e prapë punën e plakut e më në fund doli se plaku paskish pasur frikë.

«Tani s'ka q'të thotë» mendoi nipi me djallëzi. «Paratë i lidhi me kujdes, u lye. Në është burrë le të vejë e të kallëzojë.»

Agjenti i hodhi sytë në tavan. Nga boshllëku i plloçave të çatisë hynin dhjetëra rreze drite, të cilat binin teposhtë të drejta e shkriheshin në kashtë. Cergat e merimangave ishin aq të shumta sa dukeshin ose u shëmbëllenin ca qëndizmave të ngatërruara me lloj-lloj bojtrash të ndritshme. Ai soditi merimangat, që vareshin nëpër penjë të padukshëm deri sa e zuri gjumi.

U zgjua i llahtarisur e këceu më këmbë duke futur dorën në xhep. U qetësua kur pa plakun.

— C'do? — e pyeti me zë të vrazhdë.
— Të solla ujë.

Diversanti ferkoi sytë e ngriti bardhakun. Piu me etje nga ai ujë që kish plot dyimbëdhjetë vjet pa e venë në gojë. I mpiku dhëmbët e i freskoi trupin.

— Tani lermë të fle.

Gjer më drekë plaku u suall nëpër shtëpi. S'bëri asnijë punë, as dhogën s'e mbaroi e as gjë tjetër s'bëri. S'i bënin duart. Ca 'kafshore mezi i shtyti, por edhe ato i ranë si plumb.

Doli nga shtëpia e çau nëpër rrugët e fshatit. Nuk shikonte as djathtas as majtas, as i dha vaktin njeriu, veç ikte, ikte në një drejtëm të pacaktuar, ashtu, kot. Pas disa minutash u gjend te porta e postës kufitare.

— Dua të piqem me të madhin tuaj — i tha rojes.

— Prit, o xhaxho, se ta gjej unë.

S'kaloi asnijë minut e plakun e futën brenda. Me festen në dorë, i kërrusur e duke u dredhur, kapër-xeu prakun. Komandanti i doli përpëra e i zgjati dorën.

— Mirë se na erdhe, o xha Daut, hajde, hajde, ulu ta ndezim nga një.

Plaku u ul me përtim e, pa ngritur sytë, mori cigaren që i kish zgjatur toger Musta.

— E po ç'e mirë të solli këtej, a po të ra udha?

Plaku ngriti kokën, hodhi shikimin nëpër dhomë, pa togerin e foli me zë të shuar:

— Dëgjo këtu, o bir.

Zgjati edhe më kokën e përhime, mbështeti dorën në buzë të tavolinës dhe vazhdoi:

— Më ka zënë një bela e madhe, e qënka thënë të turpërohem tani në pleqëri, andaj erdha të hap barkun.

Tundi kokën e psherëtiu.

— E po thuaje troç, o burrë, ç'i vjen rrrotull? — i dha zemër togeri.

— Për atë punë erdha, po ja që më dridhet zemra, s'jam mësuar me punë të tillë unë, as jam përzier ndonjëherë me punët e qeverisë, po e sjellka sahati që të më dalë edhe mua emri.

E zgjati edhe më kokën e pëshpëriti:

— Më ka ardhur im nip, Skënderi! Kur hyra sot në mëngjez në haur, më doli si hije. M'u ngjeth mishtë kur e pashë. M'u hodh në qafë e unë ta vura përpara. S'u tund fare. Pashë ç'pashë, u unja e i bëra një vend në haur. Më dha edhe një dorë napolona.

Nxori shaminë dhe e zgjidhi mbi tavolinë. Togeri hodhi një sy mbi monedhat dhe i zgjati përsëri kutilë e cigares.

— Kur i thashë përsë kish ardhur e di ç'më tha? «Erdha pér ju, pér miqtë e pér Shqipérinë», tani erdhë koha të bashkohemi. Ta mbytja pak e kish, po bëra udhë. Ka sjellë me vete një tok plaçka, një lloj pushke që s'e kam parë ndonjëherë edhe një kuti të zezë me rrip. Edhe të tillë s'kam parë.

Këtë kisha pér të thënë. Tani bëmëni ç'të doni!

— Së pari — tha togeri — të falënderoj. Të lumtë që erdhe këtu... dhe ke bërë mirë që nuk e përzure! Edhe paratë mirë bëre që i more!

— Si ore, si? — çakëriti sytë e rrumbullaktë.

— Ke vepruar mirë.

— Ashtu... Po, tani ç'të bëj me të?

— Tani bëj ç'të të thotë yt nip! Jepi të hajë e të pijë e rueje mos lëvizë gjékundi. Ngjitju prapa e thuaji se s'e lë vetëm. Mbushja mendjen që po bën, çmos që të mos e gjejë ndonjë e keqe. Po të kérkojë njeri të takohet, rregulloje edhe këtë. Shiko ç'bën e dëgjo ç'thotë. Këtej nga posta mos u duk më!

— Ashtu, ë?

— Kështu.

— Mos na bëhet ndonjë e keqe, mor bir?

— Hiç mos ki merak, asgjë e keqe s'ka pér të ndodhur; këtë e marr përsipër unë. Ti shiko punën.

— Ashtu u bëftë!

— Lidhi paratë në shami edhe vëri atje ku i kishe. Togeri u ngrit dhe e përcoll li plakun.

— Më rrofsh, o bir, e të dëgjofsha gjithnjë pér mirë.

Tjetri i shtrëngoi dorën e menjëherë shkoi te rastisti.

* * *

Major Popi kishte më shumë se një orë që priste pranë aparatit. S'ish i qetë si zakonisht e sillej rrötull pa pushim. Herë pas here i ngulte sytë radistit, por ky mbledhje buzet e thosh:

— Ju e shikoni se s'po e kap.

Më në fund «njëzetetreshi» dha sinjal e radisti ngriti kokën. Majori u përkul mbi aparat. Dukej se s'merrte frymë dhe u gjallërua vetëm kur i dorëzuan shiritin. Doli si era e trokiti në portën e shefit.

— Ju njoftoj, zoti kolonel, se «njëzetetreshi» u sistemua!

— Mirë — ja bëri tjetri pa treguar ndonjë interesim të veçantë. — Tani të presim.

Majori mori frymë thellë, fërkoi gishtat e picërroi sytë. Shefi nxori një puro nga kutia që kish mbi tavolinë e, ndërkokë që po i këpuste majën, ndihmësi i bëri flakë me çakmak.

— Dua t'ju pyes, major — foli koloneli, duke shfryrë tymin e kaltërt.

Tjetri bëri dy hapa përpara.

— Përse shqiptarët nuk i asgjësojnë menjëherë njerëzit tanë?

— Përse?! Sepse nuk mundin!

— Oh! mos është kjo një hipotezë?

Majori hodhi sytë mbi tavolinë, e pasi u mendua një hop, tha:

— Unë këshfu besoj.

— Mjerisht unë nuk besoj ashtu dhe kam arësy.

Majori hapi pëllëmbët e tundi kokën, pastaj me zë të ulët shtoi:

— Zotni, ju i mbivlerësoni shqiptarët.

— Së pari i urrej!

Tjetri kapsalliti sytë.

— Parandjej fatkeqësi! — e mbylli bisedën koloneli.

* * *

Kaluan disa ditë. Diversanti u mësua me atë banesë të mugët e pak nga pak iu vu punës. Radiotransmetuesen e kish ngritur në një qoshe të errët të haurit, andej ku kulmi i barit arrinte deri në patavrat e çatisë; dilte natën në selishtë e përgjonte, e ditën i mbante sytë në oborr nga një vrimë që kish hapur në mur. Kur shikonte nuset e shtëpisë, skuqëj, fillonte të dridhëj e mezi e mbante veten.

Por ditët kalonin dhe jo nuset por as plaka e as ndonjë nga djemtë nuk hyri në plevicë. Diversanti dergjë prapa murit e kafshonte gishtérinjt e duarve deri sa i gjakoste.

Plaku e ruante nipçen si qeni të zonë. Tani filloi ta ushqejë se çanta me konserva mori fund që me kohë. Me këtë punë e pati ca zor, aq më keq kur nipçaja i kërkonte raki e duhan, po, donte s'donte, do t'ja shpinte.

— A të doli frika tani, o dajo? — e pyeti një ditë.

— Më doli, o djale, më doli. Tani m'u mbush koka se s'i shkon mendja njeriut për tim nip.

— A të thashë?

— Më the, o djale, më the. po mos ma vërë re mua plakut.

— Nuk të zemërohem ty, dajo, jo. Rri të flasim ca shtruar tani.

Plaku hodhi sytë nga porta e u ul.

— Dëgjo. Tani duhet të më ndihmosh. Duhet t'ja fillojmë punës. Kështu s'do të rri, apo jo?

Tjetri po mbushej. Frikë s'kish, po i dukej e pahijshme ajo punë. Hem të nipit t'ja bënte qejfin, hem togerit.

«Djall o punë... këta të sigurimit e zenkan lepurin me qerre!» mendoi.

— Ky Zequa... si i ka punët me komunistët? — pyeti agjenti.

— Si të tërë, o djale.

— Po Selamiu?

— Ai e ka humbur fare!

— E jo dhe aqe, po ai s'e heq mendjen nga malli. Pa i kam thënë kaqë here: «Iku ajo punë, o Selami; ti gjene mirë je», po ku dëgjon ajo kokë!

— Po me kooperativën si i kini punët?

— Mirë, ç'ka, me ca zor, po gjene mirë të themi.

— Domethënë s'jeni të kënaqr?

— Eh, more djalë, se mos ngopet ndonjëherë fshati ynë. Mirë që s'vuan njeri për bukë.

— Unë një gjë di: po u zgjat kjo punë kështu, do të vdisni në punë e s'do ngopi me bukë. S'ju duhet kooperativa juve. Çudi si jua kanë lënë lopët e pulat. Gjetkë i kanë mbledhur edhe ato!

— Jo, ore nipçë, neve s'na i kanë mbledhur ndonjëherë.

— Në jua kanë lënë gjer tani, do t'jau marrin më vonë! Di ç'flas unë.

Plakut po i përzihej. S'i duronte dot ato fjalë. Sa herë kish dëgjuar të tilla nga goja e Zeqos dhe e Selamiut... Por ja që asnjëherë s'u kishin dalë. Ja tani përsëri po ato profka.

Hoqi festën e po kruante kokën. Pa nga porta, shkoi dorën në faqet e rrudhura e fërkoi mjekrën, që i ishte rritur mjaff. Nguli sytë te opingat e diversantit e pastaj te qillotat e xhaqeta e shajaktë. Ja pa duart e bardha e të dobëta e fytyrën e shëndoshë me ato sy të ftohtë. E, duke parë, mendonte: «Se ku i ka gjetur këto tesha e opinga vetë e di. Sikur të kish edhe tras-tën e kërrabëen, kush ta shikonte do ta merrte për bari. Po vishu e mbathu si të duash, po s'qe ai që kërkon të shitesh, edhe të duash t'ua mbushësh mendjen të tjerëve, zor t'ja dalësh mbanë, se zor t'u zërë besë njeri duarve të tua aq të bardha e të buta që s'kanë bërë ndonjëherë punë».

Pa duart e tij me lëkurë të ashpër e të nxira, me plasa e kallo dhe psherëtiu duke u ngritur.

— Po ikën?

— Sikur e zgjatëm.

— Dale, prit.

Plaku ja qepi sytë e lodhura e të përkuqur.

— Dua të takohem me Zeqon e Selaminë. Si do ta rregullosh, ti e di. Në daç të shkoj unë tek ata, në daç të vinë ata këtu.

— Të shohim, djalë, t'u blejmë mendjen njëherë.

— Sa për ata të them unë. I di unë ata. Sa t'u zesh në gojë emrin tim e do të shohësh kur të sullen me një këmbë!

— Ashtu qoftë — tha plaku — e, si hodhi koshin me mbeturina në kurriz, doli.

S'i bënин këmbët të kthehej përsëri në haur. S'e dëgjonte dot e s'deshi t'i shikonte sytë. U ul në selishtë e i vuri kurrizin trungut të një molle. Drodhi një cigare e hodhi shikimin tej në korie.

Natë. Flladi i mbrëmjes ka filluar të përkundë gjetet e mollëve e të kumbullave. Vijat e ujit, që presin kryq e tërthor nëpër fshat, rrjedhin e llokoçitin në qetësi. Kronjtë gurgullojnë me atë monotoninë e tyre të përhershme dhe qentë, pasi lëpinë ujë në të, shkunden e largohen duke nuhatur nëpër dyer.

Xha Dauti qëndroi te kroi i madh e, si piu mirë e mirë, fshiu mustaqet me kurrizin e pëllëmbës. Hodhi sytë nga qielli. Hëna apo ish ndezur e dukej sikur shkiste mbi fshat.

Pas ca minutash trokiti në portën e Zeqos.

— Hajde, o xha Daut, — ja priti ai me zë të dyshimtë — hyrë, hyrë.

Tjetri hyri i kërrusur e, kur Zequa i vuri llozin portës, ai kish arritur në hajat.

E futi në dhomën e miqve e, duke e shikuar me kërséri, i zgjati kutinë e duhanit. Duke dredhur cigarën, xha Dauti vriste mendjen si ta niste, se fjalët i ngatërrroheshin nëpër gojë e s'i lidhte dot. Gjakupi po i ziente:

— E po si e ke punën, o xha Daut? — e solli në vete i zoti i shtëpisë.

— Erdha të të jap një sihariq! — ja priti mysafiri pa i menduar fare fjalët.

— Hair haber! — luajti nga vendi Zequa.

— Më ka ardhur im nip, Skënderi!

— Si, ore?!

— Im nip, ore... e do të piqet me ty e Selaminë.

Zequa iu afrua edhe më Dautit, i kapi dorën, e pa në sy, e sikur t'i dëgjonte ndryshe për ndryshe ato fjalë ose të mos u zinjtë besë, pyeti me zë të ulët e fjalë të zgjatura:

— Vërtet ka ardhur Skënderi?

— Hajde ta shohësh, në s'beson.

— Si ore s'do vi? Po si bëri xhanëm, si kapërxeu?

— Ai e di, veç kyçe gojën se ti e di punën e tij.

— Sa për atë... muri në foltë, pa unë... sikur këtu të ma çikin — vuri gishtin në ballë, — s'hap gojë!

Xha Dauti u ngrit.

— Dale, mor i uruar, ti sa erdhe, dal të pimë nga një kafe.

— Njëherë tjetër, po dëgjo këtu: dilni andej nga selishta se vi e ju marr unë. Hapni sytë mos ju shohë njeri.

— Eh, ç'më gëzove qofsh i gëzuar!

Xha Dauti u zhduk në errësirë duke nëmur. Kokën e kish të rëndë, gjunjët i dridheshin e goja iu poq. Qëndroi përsëri te kroi e u hodhi një grusht ujë syve. Duke u fshirë, mendonte: «Po sikur të sulem me këtë frymë te togeri?»

Sikur të kish bërtitur «tofer, o toger» s'do ta kish dëgjuar më parë se sa i doli përpara.

— Mirë mbrëma, xha Daut! — u dëgjua zëri i togerit.

Plaku u step se nuk e njohu menjëherë, por kur togeri i foli përsëri, qeshi e tundi kokën.

— E po si t'ja vësh emrin kësaj, bre... Daç më beso, daç jo, po ty të kisha në mendje tashi!

Toferi qeshi e i hodhi dorën në sup. Plaku përkuli kokën e pëshpëriti:

— Po bëhesha gati tē vija tek ti.

— Përse?

Se nipçeja më dërgoi tē thérres Zeqon e Selaminë. Isha te Zequa.

— Dhe pér këtë deshe tē vije tek unë?

— Po, s'ma mban zemra mor bir. Pa më ka hyrë edhe një frikë, mos na bëjnë ndonjë tē keqe tē paudhët!

— Mos u bëj merak, bre burrë. Ti shiko punën e bëj ç'të tē thotë!

— E po ku i marr vesh këto punët tuaja unë. Togeri qeshi e i shtrëngoi dorën.

Kur plaku humbi në errësirë, toger Musta mori rrugën pér te selishta e xha Dautit.

Atje, errësira ishte e plotë. Hëna ish pleksur në-pér re, e mollët e kumbullat me degë tē epura bënin edhe më terr. Por syri i mësuar i togerit shquante mirë shtëpinë, oborrin e portën e haurit.

Nata po thellohej. Frynte një erë e pakët që pér-hapte nëpér kopsht erën e athët tē mbeturinave. U dëgjua një zhurmë e mbytur e shkurtër. Togeri mbajti frymën, por kur ajo zhurmë u përsërit, e mori me mënd se atë e bënin mollët e krimbura që po shkundeshin. Ngriti kokën lart e shtriu dorën. Padashur ajo u cik te një mollë e madhe e, si pér çudi, fruta u këput e ra mbi plisa.

— Sa keq! — ja bëri togeri. — S'do tē jetë kuj-dësur dhe aq xha Dauti.

Atëhere pa një hije që po hiqej pas imureve tē shtëpisë. E ndoqi me sy gjer sa dalloi siluetën e xha Dautit, që po humbte në kopsht.

Deshi tē gjente një vend tē fshehir se ashtu pas pemëve edhe mund tē binte në sy. Pa pirgun e plehut e u fsheh pas tij.

S'kaloi shumë e ja i zoti shtëpisë u duk përsëri bashkë me dy tē tjerë, tē cilët kaluan fare pranë togerit. Sa fort i rrahu zemra në atë çast,

Fill pas tyre, togeri u hoq pas mureve e arriti te

porta e haurit. Njéri kanat ish një pëllëmbë e hapur. Zgjati kokën e mbajti frymën. Dëgjoi zëra:

— Tani ka ardhur koha të bashkohemi — po u mbushte mendjen diversanti — Komunistët e mbushën kupën e unë nuk e marr dot me mend si i duroni gjithë këto të zeza. Dikur ishit zotër e sot hyzmeqarë. Mos kérkonit të vdisni kështu?

— Shpirti na e di — u dëgjua zëri i Zeqos — por ç'të bëjmë? Një Perëndi na i di hallet neve! Me djemtë s'flasim dot, nuseve u është bërë syri pishë, kurse unë... unë u vi rrrotull arave e ja, këtu më sëmbon!

— Kemi rënë në dorën e axhaminjve — shtoi Selamini. — Bëjnë si u do qefi e s'të lenë të thuash një fjalë. Papo kulakë na vënë, kulakë na ngrenë. Ç'u kemi bërë ne?... S'ua kemi kursyer të ngrënët ndonjëherë. Papo tashi më s'merret vesh q'bëhet. Të urdhëron e të shet mend varfanjaku që të çuditesh. Që kur zunë venë edhe në shkollë, janë bërë si të tërbuar!

— Mjerë ju ç'kini pér të hequr prej këtyre të më-suarve — u hodh e tha agjenti. — Po ju nuk e kuptioni pérse i mbyllin në shkollë e nëpër mbledhjet? T'ju them unë: Duan t'ua marrin mendtë, t'i gënjejnë e të mos i lënë të qajnë hallet e shtëpisë. Po si të bëhen të gjithë të mësuar, kush do të punojë pastaj? Të gjithë do të këndojojnë libra e gazeta!

Andaj të mos presim, o vëllezër. Mjaft me shkolla e mbledhje, mjaft me kooperativë e komunistë. Zoti është me ne, me hallet tona. Sa ta ndezim flakën, pa do të shikoni si do të derdhen miqtë tanë!

— Cfarë të bëjmë? — ja priti xha Dauti.

— Ç'të bëjmë, è?... Zjarrin shkollës, zjarrin kooperativës, plumbin komunistëve!

— Dale, more djalë, se s'është aq kollaj sa ç'pandeh ti.

— Pér ty, o dajo, që të ka hyrë lepuri në bark, s'bëhet asgjë, por këtyre burrave këtu s'u trembet syri. Po, sidoqoftë, këto punë do t'i mendojmë, mjafton të jemi në një mendje.

U dëgjua tringëllima e napolonave.

- E di që jini hollë, o vëllezër, merrini këto.
- Na rrofsh, o Skënder, të dhëntë Zoti ç'të do zemra.

- Unë nuk jam më Skënderi! — koregjoi agjenti.
- Ai ka kohë që kë vdekur... Mua më quajnë Astrit! Të tjerët s'folën.

— Tani të ndahemi sa pa gdhirë.

U dëgjuan përshëndetje, ndërsa togeri u zhduk si era e u fsheh pas qoshes së murit.

I pa kur dolën njëri pas tjetrit duke kthyer kokën sa andej-këtej. Ikën si minj.

Kur u kthye togeri në postkomandë, errësira e natës kish zënë të çuhej. Mbështeti bërrylet te praku i drıtares dhe treti shikimin larg, në hapësirën e pafundme.

Heshtje. Fshati i përgjumur dukej i trishtuar e i pushtuar nga muzgu. Togeri s'lëvizi as sytë, por mendonte, mendonte thellë.

* * *

Kolonel Karpi u zgjua pa qejf. Ndofta do t'ja kish prishur rehatin ajo dreq kabare me atë potere, dhe ajo kope njerëzish, që sa sqimatarë duken, aq barbarë bëhen kur nis e i nënshtron viski dhe xhazi.

Gogësiti disa herë, fërkoi tëmthat dhe porositi t'i bënin gati banchën.

Sapo hyri në zyrë, tringëlliu zilja e telefonit. Pa u ulur, ngriti receptorin e tha:

— Ju pres.

Pas një gjysmë minute hyri major Popi tërë qejf.

— «Njëzetetreshi» lajmëron organizimin e grupit, zoti kolonel.

— Kaq shpejt! — ja bëri shefi duke shtrembëruar buzët.

— Siç e shikoni, zotni.

— Gëzohem t'jua zbardhë faqen. Zoti ju ndihmoftë.

Koloneli kafshoi majën e puros, por nuk e ndezi, dhe ndihmësi, që e shkrepit çakmakun aq vetëtimthi, e futi përsëri në xhep.

— Kjo dreq puro po më bën keq — u ankua. — Edhe ajo kabareja juaj ma prish qejfin. Si e duroni gjithë atë potere ju?

— Më pëlqeijnë, zotni zhurma edhe ata njerëz që u lëpihen grave.

* * *

— Ah, toger o toger, kur s'të kam këtu — pësh-përithi plaku. — Ku di ti ç'kanë ndër mend të bëjnë këta të mallëkuar! Pupu, të djegin shkollën e të na bëjnë ndonjë gjakësi në fshat!

— Jo, ore jo... Kjo s'do të bëhet kurrë, s'i lë njeri të njollojni fshatin. E, e, të poshtërve ç'u punon mendja. Po le ti, o nipçë, se ti ashtu u nise, e ashtu do të mbarosh, po ç'duan këta djajtë e tjerë. Hajde, hajde ç'më paski qënë ju! Mirë thonë: «Uji fle, po hasmi s'fle». Po ç'të keqe ju bën shkolla, more katilë, apo se u hapi sytë njerëzve?

Doli në selishtë. Dielli sapo ndriçoi mollët e spër-katura nga vesa. Ca bletë zukatnin e një gjel ja thirri këngës. Një vijë uji që përshkonte kopshtin, përdridhej si gjarpër nëpër plisat e, pasi çante përmes një sllokkonxhe, shuhej në llapshitjen e vijës tjetër, që rriddhe buzë kopshtit. Si u erdhi rrrotull mollëve, u kthyte e hyri në hausr.

Për herë të parë pas aqë ditësh, s'këmbeu fjalë me të nipin, por i la bukë e ujë e doli. Edhe tjetri s'i bëri zë.

Ndaj natë, plaku s'kish qetësi. I ra fshatit kryq e tèrthor e më në fund e gjeti togerin. Ja trëgoi të gjitha e sikur u lehtësua. Togeri e qetësoi si zakonisht. Kur u kthyte në shtëpi, ju ngrit mendja përsëri e s'i rrihej në një vend.

Një natë e freskët me një qiell të zi, ku shkëlqenin si thëngjij yj të pa numërt, u derdh dalëngadalë. Dhe në net të tilla, gjumi të pushton me krahët e tij të butë pas ditës së lodhshme.

Por plaku s'fle. Ka ditë që i është prishur gjumi. Kokën e ndjen të rëndë, goja i thahet, gjoksi i djeg e s'gjen qetësi gjékundi. Ngrihet e mban sytë në dritare. Kopshti fle e plevica sikur ka fundosur në tokë. Kall-drëmi i oborrit pak sa zbardh e një teneqe qumështi e varur, pranë portës së haurit, vezullon. Plaku i mbajti sytë te ai vezullim e vau mendjen ç'të ishte, por iu kujtua ena e qumështit që e kish vënë me dorën e vet. Nënqeshi.

Befas, atje ku vezullonte teneqeja, sikur lëvizi diçka, një gjë e zezë! Plaku shtypi hundën në xham e nguli sytë në terr. Qëndroi ca sekonda ashtu. Shpejt mbathi opingat, hodhi xhaketën e në çast u gjend në oborr. Pa teneqenë që tani zbardhë. Porta e haurit iu duk e hapur, rendi andej e qëndroi në prak. Jo, ajo ish mbyllur, ashtu siç e kish lënë.

«Po ajo hije c'ishte, mos më bënë sytë?» tha me vete.

Hyri brenda, kërkoi kandilin që e mbante varur te kanati i portës dhe bëri dritë. Flaka e kandilit u luhat e dha një dritë të mekur. Mbajti vesh e dëgjoi përtypjen e bagëtisë. Me kandil në dorë shetiti nëpër haur. Çdo gjë ishte në vendin e vet.

«Pa të hedh një sy nga nipçaja» tha me vete.

Ngriti kandilin. Drita lëvizi nëpër mure. Plaku ngriu në vend dhe kandili për pak i ra nga dora që iu drodh aq fort. U përkul e vuri dorën te bari i ngjeshur, që ishte akoma i ngrohtë. Diversanti ish zhdukur.

Mendime të çartura e pushtuan plakun e gjorë. Trupi iu rrënqeth e, pa ditur se ç'bënte, doli e qëndroi në mes të oborrit. Kandili u shua, por as ja vuri veshin e pa e zgjatur zu të vrapijë nga e shpinin këmbët. Pas pak e mori vesh se po bridhte pa drejtim. Papandehur i doli përpëra togeri:

Plaku duke gulçuar tha:

— Ka ikur!

Togeri e kapi për dore dhe e hoqi mënjanë.

— Sa paske vrapuar, more burrë, mezi merr fryshtë!

— Po a e dëgjon se ka ikur i paudhi?

Plaku mezi po përmabahej, kurse togeri vezhdoi:

— I kisha rënë erë punës e i jam qepur prapa.

Yt nip s'ka ku të vejë, ja, dhjetë hapa më tej është shëndoshë e mirë. Po të dojë të vejë gjëkund, mua prapa do të më ketë përsëri!

Plaku dëgjonte gojëhapur e, duke i përpirë fjalët e togerit, hodhi sytë përreth. Ishin pranë shtëpisë së Zeqos.

— Sa mirë, more djalë, që i paske rënë pas, se ndryshe do të humbisnim gjurmët... Shiko se mos kanë njerë mend të bëjnë gjë.

U dëgjua krisma e një porte, që u hap e nga shtëpia e Zeqos dolën tre njerëz. Plaku i shtrëngoi dorën togerit e ky i fundit e hoqi pas vetes.

Përparrë tyre kaluan Skënderi, Zequa dhe Selamiu.

Plaku pa shkëlqimin e syve të togerit e u mat të fliste, por togeri i tha me zë të ulët:

— Tani do të fillojë. Tani do të kemi punë!

E, duke i shtrënguar dorën, i fluturoi nga sytë.

Plaku mbeti i shtangur e një e nxehthë i hipit nga koka te këmbët.

* * *

— Ç'kini kështu sonte, bre burra, djalli ju ka hyrë në bark! — ankohej diversanti.

Zequa, i mbytur në djersë s'fliste dot, sikur i kishin iku fjalët, ndërsa Selamiu dridhej. Shikonin njërit-tjetrin.

— Shpejt — u kërcënuar diversanti — mos kurseni benzinë, lageni mirë edhe atë atje!

Vetë e derdhëte shishen pa kursim. Pas pak u dëgjuat përsëri:

— Tani largohuni shpejt e dilni bashkë me fshatin kur të jepet alarmi!

Fjalët e fundit ata s'i dëgjuan fare, se kishin ikur më parë. Pas disa sekondash, në mullarët e kashtës plasi flaka.

Diversanti, duke u hequr zvarrë, qeshte me ligësi, e, kur ktheu kokën nga mullarët si për të shikuar për të fundit herë, iu vranë sytë aq shumë, sa vuri dorën përpara. Dhe atëherë kur kujtonte se çdo gjë kish shkuar për bukuri, ashtu siç e kish parashikuar, e se së shpejti do të lajmëronte Popin, ndodhi ajo që s'e pandehte.

U ngrit më këmbë që të merrte vrapin, por u ndesh ballë për ballë me togerin, i cili e shtriu përdhe me një grusht të fuqishëm në stomah!

E solli në vete zbrazja e një arme, që dha alarmin! Kur e ngritën, pa me çudi Zeqon e Selaminë të lidhur dorë për dore. Pak më tej, të ndriçuar nga flaka e kashtës, pa sytë e ndezur dhe fytyrën e rreshkët të xha Dautit.

NJË DITË KORRIKU

— Kurajë, vëllezër — na jep zemër Gaziu. — Rrethimin do ta çajmë veç shtini në shenjë.

Të gjithë luftojmë. Dielli të djeg ftyrën e zverkun, gurët pëlcaşin e çahen nga plumbat. Një mitraloz po mbjell gjémën e na pret udhën si një kosë vigane. Dredhojmë e qëllojmë. Gaziu merr shenjë dhe shtie tri herë me radhë në drejtim të mitralozit dhe, si pér mrekulli, e palos shakull gjermanin.

Përparojmë diçka e zemë pozicione të reja. Por edhe këtu na godasin nga krahët, na çukisin vjedhurazi. S'di në jemi të gjithë gjallë apo ka rënë ndonjëri. Përpinqem të numëroj të shtënat, por aty pér aty më ngatërrohen me zbrazjet e armiqve. Prapa meje shtien, por s'dalloj dot sa gryka janë. Një gjë kam të qartë që kemi rënë në grackë dhe po na qëllojnë me një zjarr të madh që do të na hajë kokën! Si na zbuluan, kush na kallëzoi e si na rrethuan kaq në befasi, tani s'kam kohë të mendoj.

Në rrethana të tillë kërkon me doemos të gjesh një rrugëdalje. Truri të punon me nxitim e pulsi të rreh si tik-taku i orës. Kthen kokën t'i bësh ndonjë shenjë shokut që ke pranë ose e ndjen se është pranë, por pa ja parë mirë ftyrën, ngjesh kokën në dhe se plumbi të vërvhellen në vesh. E, sa herë që plumbi ja bën fit-fit, thua: Ja, këtu! Dhe ve dorën e vështron mos të është lyer me gjak e pastaj shtie me tèrbim.

Ja, tani, na gozhduan përsëri. Sotiri është bërrë

barikadë e pakapërxyeshme. Sot, si për çudi, mitralozi i punon fare në rregull, veç nuk di edhe sa fishekë i kanë mbetur. I thirra, por zëri m'u këput në mes. Më ngeci pushka. Heq çarkun, por më kot. Hap shulin e vështroj gëzhojen në gojë. I jap e i marr shulit, por gëzhoja s'do të lozë nga vendi.

— Arben! — thërret Sotiri.

— Këtu jam.

— Pse nuk shtie?

— Më mbeti gëzhoja brenda e s'po e nxjerr dot!

— Ptu — ja bëri ai.

Dy gjermanë m'u lëshuan.

— Ruaju, Arben, — bërtiti Sotiri përsëri.

Ç'të bëj? Kam vetëm dy bomba. Përplasa pushkën në tokë e flaka bombën. Plasja gjëmoi me buçimë të madhe, por s'bëri efekt. Ndofta s'pata fuqi ta hedh aq sa duhej. Gjermanët u kthyen e unë sa s'hëngra dheun. Zemra më dridhet. Marr pushkën në dorë e punoj shulin. I mëshoj me tërë fuqin që kam, kur gëzhoja kërcëu përpjetë e fisheku i ri hyri në gojë. «Paskam fat» — thashë dhe zura të shtie me gëzim.

Bëjmë ca hapa përpara. Pak më tej duket një përrua që i zbret malit që sipër në anën e kundërt të Shëndëllisë. Orvatem i të hidhemi andej, kur befas fërshëllen gjyle mbi kokat tonë. Re tymi pllakosën në përrua e nëpër këtë tym kapërxejmë matanë e i shmangemë zjarrit armik. Kur u ngrit tymi, kërkua shokushokun, por nga të shtatë vetat paskëshim mbetur vetëm tre: Gaziu, Sotiri dhe unë.

— Na paskan këputur nga shokët — tha Gaziu.

— Do të kenë çarë gjetkë — shtoi Sotiri — ose kanë mbetur prapa. Do ta kenë pisk! Rexhepi kishte dy ballë fishekë gjithsejt, të cilat do t'i ndante me të tjerët, kurse Qiqi akoma s'ka rregulluar as armën.

Vështrohem i njéri me tjetrin. E kuuptoj se të tre e kemi mendjen te shokët, që mbetën prapa, në lumë, nën zjarrin e rreptë të mitralozëve armiq. Gaziu diçka do të thotë, por e sjell fjalën nëpër gojë e s'e nxjerr

dot. Sotiri seç po thotë ca fjalë që s'ja marr vesh fare. Ndofta flet me vete apo mua s'më dëgjojnë mirë veshët.

Zvarritemi në përrua. Armiku na ndjek me zjarr. Qëllon me mortajë e shrapnel.

— Eh, o nemcja i djallit, por se mos kam ndër-mend ta lë lëkurën këtu, si qeni në vreshtë — thotë Gaziu.

Zëri i tij eshtë i hollë dhe i pakët si nga hera, por në këtë zë e me shqiptimin e devolliut të bën të qeshësh edhe në çastet më kritike. Dhe goja e tij s'pu-shon së nëmuri e së shari edhe me ato fjalët që s'mund të shkruhen. Sotiri s'flet fare. Eshtë lodhur tepër dhe mezi e heq mitralozin.

Një férshëllimë e mprehtë kaloi mbi grunjat ende të pakorrura e plasi mu në mes të arës. Ne i ngjitemi pérroit me duar e me këmbë; plumbat na ndjekin pas.

— Të ndahemi, shokë, — thotë Sotiri — të paktën të shpëtojë njëri... Ikni, po qëndroj vetë, ndryshe s'do t'ja dalim dot. Ikë, Gazi, edhe ti, Arben, ikni vellezër...

Gaziu na shtrëngoi duart e rrëshqiti nëpër grunjat. Unë zura vend e qëllova. Sotiri thirri edhe një herë, por, kur pa gjermanët që na ishin afruar aq te-për, zuri të shtjerë edhe vetë.

Kështu luftojmë e tèrhiqemi deri sa këmbët na shpien në një gropë të thellë me gurë e shkëmbinj. Nuk flasim dot, vështrojmë njëri-tjetrin e gulcojmë. Sotiri eshtë prishur në fytyrë. Pështyma e pértharë i zbardh në çipat e gojës, sytë i janë thelluar tepër në zgavrët dhe mjekra i dridhet sikur ta kenë mbërthyer ethet.

— Po ti qënke plagosur...

— Jo, jo, s'është gjë.

— Po ky gjak në ije?

Ai ngërdheshi fytyrën, vuri dorën në ije, kafshoi buzën e mbylli sytë. Dhimbja i pasqyrohej në fytyrën e trëtjur.

Disa çaste ra heshtja. Tatëpjetë pérroit asnjë lëvizje, as nga grunjat, kurse nga fshati plasi tymi.

— I vunë zjarrin tē poshtrit!

Befas qitja filloi përsëri. S'ngremë dot kokën. Sotiri i mbërtheu krëhrin e fundit mitralozit. Mua më kishin mbetur edhe tre fishekë e një bombë. E vështroja bombén sikur tē mos e kisha parë ndonjë herë, se pushka s'më hynte fare në sy, e përkëdhelja me gishtërinjtë që më dridheshin dhe e futa në xhep. Mendime tē shumëllojshme po ma sillnin vërdallë kokën. Sotiri, i përgjakur dhe i këputur nga lodhja, fishekët e fundit që na kishin mbetur dhe gjermanët atje poshtë...

— Ti po humb gjak, Sotir... na — i zgjata pushkën, — ke vetëm tre fishekë. Nisu sa ke akoma fuqi... Ai më shikoi me dhëmshuri e më përqafroi.

— Shpejt, Sotir!...

E kthej grykën e mitralozit. Shikoj tre gjermanë që po vinë drejt meje. Marr në shenjë, por nuk hap zjarr. Lë tē afrohen edhe pak që t'i lë në vend me një plumb.

Tani isha fill i vetëm. Prapa meje tërhiqeji Sotiri i plagosur; përpara po vinin gjermanët. Gishti më dridhej. S'dija sa fishekë kishin mbetur në karikator, por sidooftë duhej tē qëllaja në mish. Këtu duhej gjakftohtësi, kurse mua po më dridheshin duart. Mos vallë s'kisha asnë fishek e po orvatesha kot tē bëja mbrojtje?... Oh, po minutat ishin tē numëruara. Duhej qëlluar me mend, ja, atë tē parin ta mbaja me një plumb. Dhe hapa zjarr

Ushtari ra, kurse dy tē tjerët më mbulonin me plumba. Guri ku kisha ngjeshur kokën po bëhej cifla. Një plumb ma rrëmbeu kapën, flokët më ranë mbi sytë e quillur nga djersa. Mundohesha tē merrja në shenjë, po s'më lanë breshëritë. Ndërrrova vend e qëllova. Gjermanët u prapsën duke shtënë. Filloi përsëri mortaja.

Dheu po më mbulonte tē gjallë, gurët po ma shembnin shpinën. Një turbullirë po m'i vishte sytë. Kisha etje, doja ujjë. Teshat më ishin ngjitur pas trupit, sytë më përvëlonin sikur dikush tē më kishte hedhur piper.

Vështrova poshtë pérroit e pér çudi s'po e shikoja më atë ushtarın e shtrirë! Po të tjerët ku ishin?

Mblodha gjithë forcat e dola nga gropat. Tymi i zi lodronte mbi fshat dhe era e shkrumbit vinte deri tek unë. Një drithërimë më përshkoi tërë trupin. Fshati në flakë, fëmijë të tjerë do mbeteshin pa strehë... Të shkretët fëmijë! Dhe zemra më gufonte nga marazi. Por ne do të hakmerreshim, do të na i paguanin të gjitha deri më një; e shpejt, shtumë shpejt.

Korija, së cilës i jam drejtar, gjelbëron e dielli i përflakur u jep edhe më shkëlqim grunjave të verdha. Damarët e témthave më godasin me nxitim.

«Shpejt, sa më shpejt — flas me vete — mund të më qëllojnë papritur, po unë s'dua të mbetem këtu, jo, dua të jetoj e të piqem me shokët».

Nën rrezet përvëlonjëse të diellit, që u jep aq shkëlqim pyjeve dhe grunjave, marr udhë. Po zhuritem pér ujë. Një erë e lehtë dhe e vakët sikur e zbon afshin e ngrontë e të hidhur të plasjeve, po unë s'ndjej aspak freski, përkundrazi më duket se do të pëlcas nga vëpa e do të digjem pér ujë. Dalëngadalë po bie heshtja e në këtë qetësi dhe heshtje të përkohshme e dëgjoj shkoqur shushurimën e pyllit e hapat e gulçimet e mia. Kjo heshtje më duket se do të jetë e përhershme, me gjithëse më duket e çuditshme dhe e pabesueshme. Mos vallë poteret e zhurmat ishin si më parë e mua s'më dëgjonin veshët? Qëndroj e përgjoj: Vështroj tatëpjetë pérroi, grunyat, pyllin e nuk dëgjoj asnjë zhurmë e as shikoj ndonjë lëvizje. Çdo gjë hesht. Pylli është pranë, edhe pak e pastaj s'do të kem asnjë rrezik. Bëra kështu edhe njëqind hapa, kur papritur një batare automatiku më preu udhën, dhe më e keqja ishte se plumbat erdhën nga pylli, andej nga kish kaluar Sotiri. Koka më buçiste... Mos kisha ngrënë ndonjë plumb?... Pse më vinte rotull toka?

— Dorëzohu!... Je i rrëthuar, — thirri një zë i njjur.

— Dorëzohu!... — e në ato pak sekonda gjithshka

më erdhi rrrotull. M'u fanepsën shokët një nga një të gjithë. Ja Sotiri, pranë një zjarri të madh, kish vënë në hell një milor. Gaziu ngitje zjarrin e hapte prushin duke kënduar shtruar... Mos i kishin vrarë e tani më kish ardhur radha mua?

Atë çast një zë i çuditshëm, që s'e kisha dëgjuar kurrë ndonjëherë, doli nga brenda trupit e më buçiti në veshë:

«Komunistët vdesin!... Nuk dorëzohen!...»

Shtërngoj gishtin pas këmbëzës së armës; mitralozi ulërin e ndërkohë që qyta po shkund supin, truri po më kthjellohet dalëngadalë.

Ballistët nuk e kthyen zjarrin. Atëhere e humba durimin fare. U ngrita më këmbë e u sula mbi ta. Ata s'po shtinin. Shikova lëvizjet e tyre dhe e kuptova se po më merrnin krahët. Donin të më kapnin të gjallë!

Pas disa hapash gjunjët m'u prenë, rashë përdhe si plumb, mora në shenjë dhe hoqa këmbëzën. Dëgjova vtmë një «çak» e asgjë më tepër. Në karikator s'kishte mbetur asnjë fishek!

Kaq ngushtë s'e kisha parë ndonjëherë veten. Tani e humba davanë! Po... tani s'do të ngrihesha më. Shtërngova tëmthat me dorë e ndjeva gjakun që rrihte me forcë të madhe. Djersë të ftohta më kishin qullur nga koka deri në këmbë. «Oh, po unë s'dua të vdes, jo, dua të luftoj e të hakmerrem! Bomba, që më ka mbetur, është ngushëllimi i fundit, shpresë e fundit. Me këtë bombë të shtrenjtë duhet të bëj mrekullira. Ah, sikur të kish veshë e të më dëgjonte, sikur të kish gojë e të më fliste ky barot e kjo kapsullë!...» thashë me vete.

E shtërngova në dorë e prita çastin. E ndjeja si ngrohej bomba në dorën time. Pëllëmba e qullur e lagu kapakun e kuq të bombës e unë e vështroja të djersitur dhe e ndjeja të ngrohtë si trupin tim. Të qëlloja... Po a mund të fitoja gjë?.. ata ishin shumë; mjaftonte të mbetej një i gjallë e pastaj të më qepte me nge. Dhe të vdisja nga dora e një tradhëtari, duke e parë kur të

më qëllonte... Po sikur të më hidhnin hekurat e të më shpinin zvarë në fshat? Jo, ishte turp, turp i madh. Këtë s'duhej ta bëja. Më mirë të vrisja veten, ja... ta përplasja bombën te këmbët e mia e pastaj le të bënин ç'të donin me kufomën time. Po, asgjë tjetër, vetëm kështu, vetëm kjo i takonte një partizani.

— Dorëzou, more klysh bushtre, — thirri përsëri ai zëri i parë.

— Eja, eja se po dorëzohem — bërtita, dhe zëri që nxora m'u duk se s'ish imi.

Tani s'mendoja asgjë. E dija se do të vdisja shpejt, ja, për një minutë, ndofta për një sekondë po, do të vdisja!

Ballistët shtien mbi mua, por, siç duket, s'duan të më vrasin. Plumbat më fërshëllejnë mbi kokë, ngulen në dhe përpara meje, anash, por asnë s'më prek në mish. Duket, kanë vendosur të më kapin të gjallë, të tallen me mua... Po ahere pse s'vinin, ç'prisin akoma? Ja, njëri po hiqej zvarë... «Po eja, more «trim» i dheut, nga unë ke frikë? Unë s'kam asnë fishek... po të tremb gryka e ftohtë e kësaj armës mece» thashë me vete.

Më vinte të qeshja me zë e ta pështyja në fytyrë këtë frikacak. Ja edhe një tjetër, po ky qenkej më burracak, ky s'pushokish së shtëni. I drejtova grykën e mitralozit dhe mora shenjë. Në këtë çast krisën pushkë. Breshërima e një automatiku të padukshëm e qepi paq ballistik. Plumbat ja çepkatën teshat e copat e stofit fluturonin në erë. Ai klithi, lëshoi armën, u ngrit më gjunjë e u rrokullis duke u përpëlitur.

Diçka po ndodh!... një mrekulli! Toka më hodhi përpjetë, rrëshqita majtas, po pa arritur të bëj dy çape, rashë përmbyss e ndjeva një të therur të fortë në kupën e gjurit. Gjak i zi rridhte nga mishi i shpuar.

Ballistët i pashtë edhe një herë tek po shtinin mbi mua, por unë e kisha ndërruar vendin e plumbat po thërmonin gurin e dheun të pozicionit tim të parë.

U ngrita me mundim, pushtova drurin e një ahu,

të parin që më doli përpara, e mora frymë thellë. Ndjeja këmbën se po më mpihej, etja më kish pushtuar të tèrin e sikur po ma thante gjakun e mishin. Lidha plagën me gjysëm e këmishës që e çora pa e zhveshur e mbajta vesh. Krismat dëgjoheshin thellë në pyll. Shokët ishin vënë në ndjekje të ballistëve e në nxitim e sipër s'më kishin vënë re. Ta marrë djalli!

* * *

Dielli ka rënë mbi kreshtat e maleve. Në perëndim e në lindje po zbret muzgu. Hijet e drurëve janë zgjatur tepër e pleksen njëra me tjetrën në lirishte. Flladi i mbrëmjes përkund gjethet e drurëve e ato bëjnë një shushurimë të lehtë e monotone. Plaga më djeg e më dhëmb. Herë-herë më merren mendtë e më vjen liksht, por e di se kjo vjen nga pagjumësia, lodhja, uria, etja dhe gjaku që po humb, të cilat më pllakosën të gjitha përnjëherësh. Por vuajtja më e madhe qenka etja. Një pikë ujë mbas do të më jepte fuqi që të bëja njëqind hapa më tej pa mu veshur sytë. E ujë s'kish, po edhe sikur të gjeja gjékund, s'duhej të pija, në asnjë mënyrë jo! Këtë e di se për një të plagosur është e rrrezikshme. Dhe unë duhej ta zotëroja veten. Tani që isha gjallë!.. Oh sa e pabesueshme... Unë gjallë? Unë që vendosa të vritja veten. Mos kish qenë një èndërr? Megjithatë isha gjallë, gjallë, me pjë mitraloz pa fiskekë, me një bombë e një vrimë plumbi në këmbë.

Rrezet e fundit të diellit bien si gjëlpëra në lirish-te. Nëpër fletët e kalbura rrëshqiti një hardhucë frikamane me bark të bardhë e kurriz të blerët. Një flutur rrahu krahët e bëri poشتë e lart mbi kryet e mi. Qëndroi një çast te tyta e mitralozit, pastaj rrahu krahët e verdha me pikla të kuqe e u zhduk në një drejtëtim të pacaktuar.

I rashë pyllit sa gjatë gjërë, duke ecur çalë-çalë

e duke duruar dhembkat e hidhura. Doja, ujë, aq sa tē njomja buzët. Eca kështu me mundim gjer sa, më në fund, më zuri syri një rrip bari tē njomë. Pak më tej, në rrënjet e një llajthie, ish një burim i vogël i fshehur nën fletët e kalbura. Mbi tē miza tē vogla e tē panumërtat fluturonin poshtë e lart pa pushim. Uji cërriste lehtë. U ula, hapa fletët e kalbura e ngjesha buzët.

Uji aq i dëshirueshëm, i ftohtë dhe i pastër si kristal më dha tē dredhura në trup. Spërkata fytyrën, zverkun, gjoksin, ngula gojën te burimi dhe gëlltitë një gllënqkë, vetëm një.

Në pyll ka rënë heshtja e rëndë mbrëmësore. Nata po bie ngadalë, e butë, e freskët e tē ndjell gjumë. Gjunjët s'i thyej dot, jam fare i kapitur, por s'dua tē ulem se do tē më marrë gjumi. Qëllimi im i vetëm është që tē bashkohem me shokët. Ata sigurisht po më kërkonin. Po, a mund tē ecja? Këmba s'më bindej fare e sa herë që shkelja aq herë rënkoja. Të paktën isha gjallë, jetoja.

Me këto mendime u rropata poshtë e lart deri sa nata e zezë mbuloi pyllin. Kapitja po më nënshtronte, po dremitja më këmbë. Të më frynin bija e, tek po ecja, s'dija në isha në rrugë apo jo. Shtigjet e pyllit ishin tē shumta; druvarët kishin çelur rrugët e tyre, udhëtarët po ashtu, dhe unë s'di në çfarë shtigjesh rraha.

Megjithëqë e kisha marrë pak veten, këmbën nuk e ndjeja fare timen. U ngrita me kujdes, duke u mbësh-tetur te mitralozi e rëndoja mbi këmbë. Oh, ç'dhimbje e hidhur, sikur më thyenin kockën, por duhej duruar, duhej tē ecja e tē gjeja shokët... Ata po më kërkonin.

Hëna qëndron mbi mua e më ndrit rrugën. Shtegu më nxjerr në një lirishte tjetër. Kaloj lirishten e befas bie në një tatëpjetë shullë, që zbret thikë. Po tē mos isha ndalur, do tē isha rrézuar. E mat me sy, me menjë këtë rrugë tē thepisur dhe e shoh se nuk e ha dot. Poshtë shullërit duken kodra e brigje që u ngajnjë tumbave tē dheut tē vorrezave. Duhet tē gjej rrugë tjetër,

le të jetë më e gjatë, por që të mund të eci me një këmbë të saktë. Duke çarë përsëri në pyll, llogaris me mend se po të mbaj këtë ritëm të ecuri, duke bërë edhe dy-tre pushime të shkurtëra, në mëngjez duhet të sos në Bradvicë.

Tek eci e vështroj konturet e drurëve të zez, befas stepem në vend. Më bëjnë sytë, apo... Dy hije lëvizën përpara syve të mi të kapitur. Ngul sytë në atë drejtëm, ku u fanitën ato figura njerëzish e pak nga pak bindem se pesëdhjetë-gjashtëdhjetë hapa më tej dy njerëz kanë zënë shtegun!

Zemra më godet fort. Ç'të jenë vallë? Partizanë apo?. Fshihem pas trungut e përgjoj. Ata s'lëvizin, duken si të qepur njëri me tjetrin e të ngrrirë në vend. S'e shquaj dot në u vështroj fytyrën apo shpinënë, sepse drita e hënës s'të ndihmon fare në këtë pyll të harlisur. Njëri lëvizi, tjetri i shkoi pas dhe, pasi bënë ca hapa, u ulën.

Më shkrepi në kokë të marr vesh ç'janë. Ndofta kjo eshtë një marrëzi, por kërshteria dhe nevoja për të parë njëri më shtynë instinktivisht drejt tyre. «Po sikur të jetë ndonjë roje armike të më diktojë?... Bah! s'është e mundur; armiku s'hyn kaq thellë në zonën tonë. Duhet të jenë partizanë» mendoja, po ky mendim sikur më jepte pak nga ato forcat që po më humbisnin nga çasti në çast. Oh, sikur të ishin partizanë!...

Futa mitralozin në një dëllinjë e nisa t'u avitem. Eh, sa vështirë e kisha! Këmba më dhimbte fort e kisha frikë mos bërtisja nga dhimbjet. Buzët po i saka-toja së kafshuari, por s'kisha ç'të bëja, duhej të mundohesha edhe ca. Mbështetur do të ishte mundimi i fundit. Herë pas here shtija dorën në xhep e prekja bombën, shokun tim të vetëm. Më dukej e ftohtë, sikur metali i saj ta kishte thithur tërë të ftohtin e natës. E përkëdhela me gishta dhe e shtrëngojë derisa metali merrte ngrohtësinë e trupit tim. Djersa më kullonte në trup e në fytyrë, kisha etje të madhe.

Të panjohurit bisedojnë, por veshi s'më kap. asnë

fjalë. Qëndroj një copë herë kështu deri sa më në fund dëgjoj diçka:

— Po, po...

— Po gdhihet e ata kushedi nga harbojnë!

Trupi po më shkrinte tek dëgjoja këta dy zëra të njohur. Tërë mendimet m'u fashiten, siç fashiten e shtrohen tallazet pas stuhisë. Më dukej sikur po rrëshqisja ngadalë e butë në gjethishten e kalbur, duke u shkëputur më në fund nga ato dallgë që më përplasën sa andej këtej e që më rrahën pa mëshirë. Qëndrova një çast ashtu duke ndjerë të rrahurat e zemrës së gëzuar e thirra:

— Shokë!

Partizanët u hodhën përpjetë e drejtuan armët.

— Ndal, parullën — bërtiti Koçoja.

— Koço !...

— Mos luaj, parullën!

— S'kam parullë.

«Çëk», u dëgjua sigureca e armës.

— Mos shtini, jam unë... Arbeni!

Kur zgjohem, dita ka hapur fare. Zërat që dëgjoj rrëth e rrötull, janë të ëmbël e të qeshur. Të gjithë këta zëra i njoh e i dua. Ata më mbushin me gëzim e më japid forcë.

— U ngjall i vdekuri — dëgjoj zërin e Lytos.

Koçoja qesh e më përfshin për qafe. S'kam fjalë, sikur ma kanë shkulur gjuhën. Lytua pret më këmbë me një misur qumësht, që lëshon avull. Në zjarr kërcasin e treten karthijat erëkëndshme, afshi i të cilave më ndjell përsëri gjumë.

— Hajde, mbushi zorrët de! — e më futi buzën e misurit në gojë.

Gërrqet e para m'u dukën të hidhura si zeher, por pastaj shija më erdhi dalëngadalë.

— Shpëtuan të gjithë? — pyeta.

— S'dimë më tepër se ti — thotë Koçoja duke më zgjidhur plagën.

— Ngadalë, bre!

Por ai e shkuli fashën e ngjitur pas mishit. Sytë më lëshuan lot dhe mbështeta kokën te supi i Lytos.

— Po-Sotiri, Gaziu?

— S'i kemi parë.

— As Rexhepin.

— Asnjë, Arben, ti je i pari.

Puhia mëngjezore të ledhaton fytyrën dhe freskia e saj paralajmëron se së shpejti do të lindë dielli.

Partizanët po grumbullohen. Përqafime e zëra gazzmorë ndihen kudo. Lytua buçet me zérin e tij të fortë, iu rreh shpatullat të porsaardhurve e u ndan bukë e djathë. Të plagosurve u jep qumësht. Dikush më thërrst. Eshtë Gaziu i gjatë e i hajthém që bërtet me atë zérin e hollë si prej gruaje:

— Arben... o Arben.

Përqafohemi e puthemi. Ai më vështron e tund kokën në atë mënyrën e tij hem tallës e hem keqardhëse:

— Bobo si të paskan grirë, bre!...

Ja edhe Rexhepi me Nuriu.

— Po Sotiri ku është?

Gaziu bëri me' kokë prapa meje. Kthehem andej dhe përqafohem me Sotirin, por infermieri nuk na lë të çmallemi me njëri-tjetrin, mbasi nisi shpejt e shpejt të na mjekojë plagët.

PASQYRE LËNDE

	Faqe
1. Dy mësueset	3
2. Shpati i «mallëkuar»	17
3. Atë e vrau ndërgjegjia	31
4. Tornitorja	42
5. Në kodrat e prapanikut	53
6. Shokë lufte	68
7. Ditë stuhie	92
8. Dështimi	105
9. Një ditë Korriku	135